



Eurizon Manager Selection Fund

Një FCP në Luksemburg

Prospekt | 1 shtator 2023

eurizoncapital.com

Përmbajtja

Informacion për investitorët potencialë	2	Politika e shpërndarjes	28
Përshkrimet e fondit	4	Menaxhimi dhe operacionet e biznesit	36
MS 10	5	Publikimi parakontraktor i SFDR	41
MS 20	7	Eurizon Manager Selection Fund - MS 10	42
MS 40	9	Eurizon Manager Selection Fund - MS 20	48
MS 70	10	Eurizon Manager Selection Fund - MS 40	54
Përshkrimet e rreziqeve	11	Eurizon Manager Selection Fund - MS 70	60
Politikat e kreditit	17	Shtojcë e prospektit të Fondeve Eurizon	
Politika e investimit të qëndrueshëm dhe Integrimi i		Manager Selection Fund për investitorët në	
kritereve ESG	17	Republikën e Shqipërisë	66
Kompetencat dhe kufizimet e përgjithshme të			
investimit	19		
Investimi në fonde	28		

Informacion për investitorët potencialë

Të gjitha investimet përfshijnë rrezik

Ashtu siç ndodh me shumicën e investimeve, performanca e ardhshme e këtyre fondeve mund të dallojë nga performanca e shkuar. Nuk ka garanci se një fond do të përbushë objektivat e tij apo se do të arrijë një nivel të caktuar performance.

Investimet në fonde nuk janë depozita bankare. Vlera e investimit mund të rritet ose të ulët dhe ekziston mundësia që ju t'i humbni paratë e investuara ose një pjesë të tyre. Edhe nivelet e të ardhurave mund të rriten ose të ulen (në përqindje ose në vlerë absolute). Asnjë fond në këtë prospekt nuk është projektuar si një plan i plotë investimi dhe jo të gjitha fondet janë të përshtatshme për të gjithë investitorët.

Përpara se të investoni në një fond, duhet të kuptoni rreziqet, kostot dhe kushtet e investimit, si dhe nivelin e përputhjes së këtyre karakteristikave me rrethanat tuaja financiare dhe tolerancën ndaj rrezikut.

Si një investitor potencial, është përgjegjësia juaj që të keni njohuri dhe të zbatoni të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke përfshirë kufizimet që lidhen me kursin e këmbimit, si dhe të jeni në dijeni të pasojave tatimore (FCP nuk do të jetë përgjegjës për këto pasoja në asnjë rrethanë). Ju rekomandojmë që, përpara investimit, të konsultoheni me një konsulent investimesh, konsulent ligjor dhe konsulent tatimor.

Çdo diferencë ndërmjet monedhave të titujve të fondit, monedhave bazë të fondit ose monedhave të një kategorie të kuotave dhe monedhës vendase, mund t'ju ekspozojë ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Nëse monedha vendase është e ndryshme nga monedha e kategorisë së kuotave tuaja, kthimi që do të merrni si investitor mund të jetë shumë i ndryshëm nga kthimi i kësaj kategorie.

Kush mund të investojë në këto fonde

Shpërndarja e këtij prospekti, ofrimi i këtyre kuotave për shitje, ose investimi në këto kuota është i ligjshëm vetëm në rastet kur kuotat janë të regjistruara për shitje publike ose kur shitja nuk është e ndaluar nga rregullorja ose legjislacioni kombëtar. Ky prospekt dhe çdo dokument tjetër që lidhet me FCP-në nuk përbën një ofertë ose kërkesë në asnjë juridiksion ose për asnjë investitor, në rastet kur nuk lejohet me ligj ose kur personi që bën ofertën ose kërkesën nuk është i kualifikuar për këtë.

Këto kuota dhe FCP-ja nuk janë të regjistruara në Komisionin e Titujve dhe Kursit të Këmbimit në SHBA ose në një subjekt tjetër në Shtetet e Bashkuara, qoftë federal ose i një lloji tjetër. Për rrjedhojë, nëse shoqëria e menaxhimit nuk është e bindur se shitja nuk përbën shkelje të ligjeve për titujt në SHBA, këto kuota nuk do të shiten në SHBA dhe nuk do të jenë të disponueshme ose nuk do të sjellin përfitim për personat në Shtetet e Bashkuara.

Ky version i prospektit nuk mund të përdoret ose të shpërndahet në Hong-Kong, përveç rastit kur është i shoqëruar nga shtojca përkatëse për këtë vend. Ky prospekt nuk është shqyrtuar nga asnjë autoritet rregullator në Hong-Kong.

Për më shumë informacion mbi kufizimet në pronësinë e njësisë, na kontaktoni (shih kutinë më poshtë).

Informacionet ku duhet të bazoheni

Gjatë marrjes së vendimit për të investuar ose jo në një fond, duhet të shqyrtoni (dhe të lexoni plotësisht) prospektin më të fundit, si dhe Dokumentet përkatëse me informacion kryesor për investitorët (KID) dhe raportet më të fundit financiare, të cilat konsiderohen të gjitha si pjesë e prospektit. Të gjitha këto dokumente janë të disponueshme në internet në eurizoncapital.com. Duke nënshkruar në kuotat e një prej këtyre fondeve, ju konsideroheni se pranoni kushtet e parashikuara në këto dokumente.

Së bashku, të gjithë këto dokumente përmbajnë informacionin e vetëm të miratuar lidhur me fondet dhe me FCP-në. Personat që ofrojnë informacion tjetër ose në një mënyrë tjetër, ose që marrin vendime investimi bazuar në to, i ndërmarrin këto veprime nën përgjegjësinë e tyre dhe e mbartin vetë rrezikun. Bordi nuk është përgjegjës për asnjë deklaratë ose informacion mbi fondet ose FCP-në që nuk është pjesë e këtyre dokumenteve, dhe investitorët e marrin vetë përsipër rrezikun nëse bazohen në këto deklarata dhe informacione. Informacioni në këtë prospekt ose çdo dokument mbi FCP-në ose fondet mund të ketë pësuar ndryshime që nga data e publikimit. Në rast se ka mospërputhje në përkthimet e këtij prospekti, të rregulloreve të financimit ose të raporteve financiare, atëherë do të mbizotërojë versioni në gjuhën angleze, përveç rastit kur shoqëria e menaxhimit ose depozitari vendosin ndryshe.

TË DHËNAT E KONTAKTIT

Eurizon Capital S.A.
28, Bd. de Kockelscheuer
L-1821 Luxembourg
eurizoncapital.com

Përshkrimet e fondit

Të gjitha fondet e përshkruara në këtë prospekt janë pjesë e FCP-së, i cili funksionon si një strukturë ombrellë për to. FCP ekziston për t'u ofruar investitorëve akses në menaxhimin profesional të investimeve përmes një sërë fondesh, të cilat kanë si synim të balancojnë rritjen dhe ruajtjen e kapitalit të zotëruesve të kuotave, duke ofruar gjithashtu likuiditet të lartë të njësive të fondit dhe duke aplikuar diversifikim të qëndrueshëm të rrezikut.

Sipas ligjit, çdo fond lejohet të investojë siç përshkruhet në "Kompetencat dhe kufizimet e përgjithshme të investimit", si dhe duhet të respektojë kufizimet e përcaktuara në të njëjtin seksion. Megjithatë, çdo fond ka politikën e tij të investimeve, e cila, në përgjithësi, është më e kufizuar se masat e lejuara me ligj. Një fond mund të përdorë investime dhe teknika që nuk janë parashikuar në politikën e tij të investimit, në një masë të kufizuar, për sa kohë që kjo është në përputhje me ligjin dhe rregulloren, si dhe me objektivin e investimit të portofolit. Gjithashtu, çdo fond mund të devijojë nga politika e tij e investimit për të trajtuar kushte të pazakonta të tregut ose ngjarje të mëdha të paparashikueshme. Përshkrimet e objektivave specifike të investimit, investimet kryesore dhe karakteristikat e tjera kyçe të çdo fondi fillojnë në faqen në vijim.

Shoqëria e menaxhimit ka përgjegjësi të plotë për veprimtaritë e biznesit dhe aktivitetet e investimit të FCP-së, duke përfshirë edhe aktivitetet e investimit të të gjitha fondeve. Shoqëria e menaxhimit mund të delegojë disa prej funksioneve të saj tek ofrues të ndryshëm shërbimesh, si p.sh. menaxhimin, shpërndarjen e investimeve dhe administrimin në nivel qendror. Shoqëria e menaxhimit ka të drejtën e miratimit mbikëqyrës dhe të ushtrimit të kontrollit ndaj delegatëve të saj.

Në seksionin e fundit të këtij prospekti jepen më shumë informacione rreth FCP-së, shoqërisë së menaxhimit dhe ofruesve të shërbimit, "Management and Business Operations".

Për më shumë informacione mbi tarifatat dhe shpenzimet që mund t'ju duhet të paguani lidhur me investimet, konsultoni pikat në vijim:

- Tarifatat maksimale për blerjen, shkëmbimin dhe shitjen e shumicës së kuotave: ky seksion.
- Tarifatat vjetore maksimale të zbritura nga investimi juaj: ky seksion.
- Shpenzimet aktuale më të fundit: KID e zbatueshme ose raporti FCP më i fundit i zotëruesit të kuotave.

- Tarifatat për konvertimin e monedhave, për transaksionet bankare dhe për konsulencën mbi investimin: konsulenti juaj financiar, agjenti i transfertave ose ofrues të tjerë të shërbimeve, sipas rastit.

Termet me kuptime specifike

Termet e mëposhtëm kanë kuptimet në vijim në këtë prospekt.

Ligji 2010 Ligji i Luksemburgut i datës 17 dhjetor 2010 mbi Sipërmarrjet për investime kolektive, i ndryshuar.

monedha bazë Monedha në të cilën një fond bën kontabilitetin për fondin e tij dhe ruan NAV-në e tij kryesore.

bordi Bordi i Drejtorëve i shoqërisë administruese.

ditë pune Çdo ditë që është një ditë e plotë pune për bankat në Luksemburg.

tregjet në zhvillim Çdo vend ekonomia e të cilit është më pak e zhvilluar sipas Bankës Botërore, Kombeve të Bashkuara ose një organizate të lidhur.

FCP Eurizon Manager Selection Fund.

raportet financiare Raporti vjetor i FCP-së, së bashku me çdo raport gjysmë-vjetor që është lëshuar që nga raporti vjetor më i fundit.

fond Me përjashtim të rasteve kur tregohet ndryshe, çdo fond për të cilin FCP shërben si një UCITS ombrellë.

qeveri Çdo qeveri, agjenci qeveritare, entitet mbikombëtar ose ndërkombëtar publik, autoritet lokal ose organizatë e sponsorizuar nga qeveria.

ndërmjetës Çdo ndërmjetës, agjent shpërndarës ose ndërmjetës tjetër me të cilin distributori ka një marrëveshje për të shpërndarë njësitë.

KID Dokumenti kyç i informacionit.

rregulloret e menaxhimit Rregulloret e menaxhimit të FCP.

NAV Vlera neto e aktiveve për njësi; vlera e një njësie të një fondi.

SFDR Rregullorja (BE) 2019/2088 mbi dhënien e informacioneve shpjeguese të lidhura me qëndrueshmërinë në sektorin e shërbimeve financiare.

prospekti Ky dokument.

Person amerikan Çdo banor i Shteteve të Bashkuara ose ndonjë shoqate ose korporate e organizuar sipas ligjeve të Shteteve të Bashkuara ose të ndonjë prej shteteve, territoreve ose zotërimeve të saj.

ne, neve FCP, duke vepruar nëpërmjet shoqërisë administruese ose nëpërmjet çdo ofruesi shërbimi të përshkruar në këtë prospekt, përveç audituesit dhe çdo shpërndarësi.

ju Çdo zotërues i njësisë së kaluar, aktual ose i mundshëm, ose një agjent për të njëjtin gjë.

Shkurtimet e monedhave

AUD	Dollar australian	GBP	Paundi britanik
BRL	Reali brazilian	HUF	Forinti hungarez
CHF	Franga zviceriane	JPY	Jeni japonez
CNH	Renminbi kinez në det të hapur	PLN	Zlota polake
CNY	Renminbi kinez në breg	RMB	Renminbi në det të hapur/në breg
EUR	Euro	USD	Dollari amerikan

MS 10

Objektivi dhe politika e investimeve

Objektivi Për të rritur në mënyrë të moderuar vlerën e investimit tuaj me kalimin e kohës.

Indeksi referencë 45% JP Morgan Economic dhe Monetary Union (EMU) Index + 25% FTSE MTS Italy BOT – Ex-Bank of Italy + 10% JP Morgan Emerging Markets Bond Index Global Diversified e mbrojtur në EUR + 10% ICE BofAML BB-B Global High Yield European Issuers Constrained Index e mbrojtur në EUR + 10% MSCI World Index (kthimi total neto). Për krijimin e portofolit dhe matjen e performancës.

Politika e investimit Fondi investon kryesisht në obligacione qeveritare dhe të korporatave të shprehura në euro dhe, në një masë më të vogël, në aksione. Këto investime mund të jenë nga çdo vend i botës, duke përfshirë nga tregjet në zhvillim, dhe disa prej tyre mund të jenë nën kategorinë investuese. Fondi kryesisht investon përmes fondeve, por gjithashtu mund të investojë drejtpërdrejt ose përmes derivateve.

Konkretisht, fondi investon të paktën 51% të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera. Fondi investon në borxh dhe instrumente të lidhura me borxhin, duke përfshirë instrumentet e tregut të parasë, dhe në kapitale dhe instrumente të lidhura me kapitalin, duke përfshirë obligacionet e konvertueshme.

Fondi mund të investojë në kategoritë e mëposhtme të aktiveve deri në përqindjet e treguara të totalit të aktiveve neto:

- instrumente borxhi nën kategorinë investuese ose të pavlerësuar 49%
- tituj kapitali dhe instrumente të lidhura me tituj e kapitalit: 15%, minimumi 5% (afërsisht 10% mesatarisht)

Derivatitë dhe teknikat Fondi mund të përdorë derivativë për reduktimin e rreziqeve (mbrojtje) dhe të kostove, si dhe për të rritur ekspozimin e investimit.

Fondi synon të përdorë vetëm derivativë bazë (shihni "How the Funds Use Instruments and Techniques").

Përdorimi i TRS-ve E pritshme, 0% e totalit të aktiveve neto; maksimumi, 0%.

Marrëveshjet e riblerjes (repo)/marrëveshjet e anasjella të riblerjes (repo e anasjellte) E pritshme, 0%; maksimumi, 0%.

Strategjia Në administrimin aktiv të fondit, menaxheri i investimeve përdor analizën makroekonomike së bashku me analizën sasiore dhe cilësore për të rregulluar në mënyrë dinamike përzjerjen e aktiveve të portofolit dhe ekspozimin gjeografik dhe për të zgjedhur investimet (qasja nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart). Përqindja e titujve që përbëjnë fondin dhe për rrjedhojë kthimi i tij, mund të kenë ndryshime të vogla me ato të indeksit referencë.

Qasja ndaj qëndrueshmërisë Fondi promovon (E) karakteristika mjedisore dhe/ose (S) sociale dhe investon në asete duke ndjekur praktikatat e qeverisjes së mirë (G) në përputhje me nenin 8 të Rregullores për Publikimin e Financave të Qëndrueshme ("SFDR").

Menaxheri i investimeve i përdor kriteret mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) si një element thelbësor të strategjisë së tij. Ai përjashton letrat me vlerë nga emetuesit ose sektorët me një profil të ulët ESG ose që janë të përfshirë me armë kontroverse ose që nxjerrin 25% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga aktivitetet e minierave ose prodhimit të energjisë elektrike të lidhura me qymyrin termik ose 10% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga nxjerrja e rërës së naftës, dhe ndërton një

portofol që investon të paktën 70% të totalit të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera të kategorizuara si SFDR Neni 8 ose Neni 9.

Për më shumë informacion, shihni "Publikimin parakontraktor të SFDR" dhe seksionin "Politika e Investimeve të Qëndrueshme dhe Integrimi i kriterëve ESG" përfshirë kufizimet metodologjike kryesorë, si të dhënat e paplota, të pasakta ose të padisponueshme të palëve të treta dhe shkoni te

<https://www.eurizoncapital.com/pages/sustainability.aspx>.

Publikimi i taksonomisë Investimet në themel të këtij produkti financiar nuk marrin në konsideratë kriteret e BE-së për aktivitetet ekonomike të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

Monedha bazë EUR.

Menaxheri i investimeve Eurizon Capital SGR S.p.A.

Rreziqet kryesore

Shihni "Risk Descriptions" për më shumë informacion.

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e zakonshme të tregut

- Orientimi i indeksit referencë
- Obligacionet e konvertueshme
- Kredi; + nën shkallën e investimit
- Monedha
- Derivatitë
- Tregjet në zhvillim dhe ato kufitare
- Kapitali
- Mbrojtja
- Norma e interesit
- Fondi i investimeve
- Menaxhimi
- Tregu
- Investimi i qëndrueshëm

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e pazakonta të tregut ose me ngjarje të tjera të paparashikueshme

- Kundërpala dhe kolaterali
- Paaftësia paguese
- Likuiditeti
- Operacional
- Praktikatat standarde

Metoda e menaxhimit të rrezikut Angazhimi.

Planifikimi i investimit tuaj

Disponueshmëria e produktit Fondi është i disponueshëm për investitorët mjedisorë dhe investitorët me njohuri bazë, me ose pa këshillim.

Profili i investitorit Investitorë që i kuptojnë rreziqet e fondit dhe planifikojnë të investojnë në periudha afatmesme.

Fondi mund të tërheqë investitorë të cilët:

- po kërkojnë një investim që kombinon të ardhurat dhe rritjen, si dhe parapëlqejnë investimet e qëndrueshme,
- janë të interesuar për ekspozimin ndaj përzjerjes së aktiveve të diversifikuar, qoftë për një investim bazë ose për qëllime diversifikimi

Përpunimi i kërkesave Kërkesat për blerjen, shkëmbimin ose shitjen e njësive të fondit që merren dhe pranohen nga agjenti i transferimit deri në orën 16:00 CET të çdo ditë që është një ditë pune në Luksemburg përpunohen zakonisht ditën pasuese të punës.

Pagesa kryhet jo më vonë se 3 ditë pune pas pranimit të një kërkesë.

Ngjarjet që lidhen me fondin

3/7/2006 Të emtuara si SMS Sanpaolo Manager Selection 10.

14/7/2009 Të riemëruara në Eurizon Manager Selection Fund – MS 10.

Kategoritë bazë të kuotave

Kategor- ia	Monedha	Investimi minimal	Vlera minimale e zotëruar	Maks. Tarifat e tregtimit		Tarifat vjetore	
				Hyrje	Dalje	Menaxhimi	Tarifat maksimale të administrimit
R	EUR	500	-	1,50%	-	1,20%	0,25%
Z	EUR	3 milionë	3 milionë	-	-	0,35%	0,25%

Shihni "Fund Fees and Costs" për një shpjegim më të plotë të tarifave të mësipërme. Për të parë listën aktuale dhe të plotë të kategorive të kuotave të disponueshme, vizitoni eurizoncapital.com.

Objektivi dhe politika e investimeve

Objektivi Për të rritur në mënyrë të moderuar vlerën e investimit tuaj me kalimin e kohës.

Indeksi referencë 35% JP Morgan Economic dhe Monetary Union (EMU) Index + 25% FTSE MTS Italy BOT – Ex-Bank of Italy + 20% MSCI World Index (kthimi total neto) + 10% ICE BofAML BB-B Global High Yield European Issuers Constrained Index e mbuluar në EUR + 10% JP Morgan Emerging Markets Bond Index Global Diversified e mbuluar në EUR. *Për krijimin e portofolit dhe matjen e performancës.*

Politika e investimit Fondi investon kryesisht në obligacione qeveritare dhe të korporatave të shprehura në euro dhe, në një masë më të vogël, në aksione. Këto investime mund të jenë nga çdo vend i botës, duke përfshirë nga tregjet në zhvillim, dhe disa prej tyre mund të jenë nën kategorinë investuese. Fondi kryesisht investon përmes fondeve, por gjithashtu mund të investojë drejtpërdrejt ose përmes derivateve.

Konkretisht, fondi investon të paktën 51% të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera. Fondi investon në borxh dhe instrumente të lidhura me borxhin, duke përfshirë instrumentet e tregut të parasë, dhe në kapitale dhe instrumente të lidhura me kapitalin, përfshirë obligacionet e konvertueshme.

Fondi mund të investojë në kategoritë e mëposhtme të aktiveve deri në përqindjet e treguara të totalit të aktiveve neto:

- instrumente borxhi nën kategorinë investuese ose të pavlerësuar 49%
- tituj kapitali dhe instrumente të lidhura me tituj e kapitalit: 30%, minimumi 10% (afërsisht 20% mesatarisht)

Derivatvët dhe teknikat Fondi mund të përdorë derivativë për reduktimin e rreziqeve (mbrojtje) dhe të kostove, si dhe për të rritur ekspozimin e investimit.

Fondi synon të përdorë vetëm derivativë bazë (shihni "How the Funds Use Instruments and Techniques").

Përdorimi i TRS-ve E pritshme, 0% e totalit të aktiveve neto; maksimumi, 0%.

Marrëveshjet e riblerjes (repo)/marrëveshjet e anasjella të riblerjes (repo e anasjellte) E pritshme, 0%; maksimumi, 0%.

Strategjia Në administrimin aktiv të fondit, menaxheri i investimeve përdor analizën makroekonomike së bashku me analizën sasiore dhe cilësore për të rregulluar në mënyrë dinamike përzjerjen e aktiveve të portofolit dhe ekspozimin gjeografik dhe për të zgjedhur investimet (qasja nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart). Përqindja e titujve që përbëjnë fondin dhe për rrjedhojë kthimi i tij, mund të kenë ndryshime të vogla me ato të indeksit referencë.

Qasja ndaj qëndrueshmërisë Fondi promovon (E) karakteristika mjedisore dhe/ose (S) sociale dhe investon në asete duke ndjekur praktikatat e qeverisjes së mirë (G) në përputhje me nenin 8 të Rregullores për Publikimin e Financave të Qëndrueshme ("SFDR").

Menaxheri i investimeve i përdor kriteret mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) si një element thelbësor të strategjisë së tij. Ai përjashton letrat me vlerë nga emetuesit ose sektorët me një profil të ulët ESG ose që janë të përfshirë me armë kontroverse ose që nxjerrin 25% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga aktivitetet e minierave ose prodhimit të energjisë elektrike të lidhura me qymyrin termik ose 10% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga nxjerrja e rërës së naftës, dhe ndërton një

portofol që investon të paktën 70% të totalit të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera të kategorizuara si SFDR Neni 8 ose Neni 9.

Për më shumë informacion, shihni "Publikimin parakontraktor të SFDR" dhe seksionin "Politika e Investimeve të Qëndrueshme dhe Integrimi i kriterëve ESG" përfshirë kufizimet metodologjike kryesorë, si të dhënat e paplota, të pasakta ose të padisponueshme të palëve të treta dhe shkoni te

<https://www.eurizoncapital.com/pages/sustainability.aspx>.

Publikimi i taksonomisë Investimet në themel të këtij produkti financiar nuk marrin në konsideratë kriteret e BE-së për aktivitetet ekonomike të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

Monedha bazë EUR.

Menaxheri i investimeve Eurizon Capital SGR S.p.A.

Rreziqet kryesore

Shihni "Risk Descriptions" për më shumë informacion.

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e zakonshme të tregut

- Orientimi i indeksit referencë
- Obligacionet e konvertueshme
- Kredi; + nën shkallën e investimit
- Monedha
- Derivatvët
- Tregjet në zhvillim dhe ato kufitare
- Kapitali
- Mbrojtja
- Norma e interesit
- Fondi i investimeve
- Menaxhimi
- Tregu
- Investimi i qëndrueshëm

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e pazakonta të tregut ose me ngjarje të tjera të paparashikueshme

- Kundërpala dhe kolaterali
- Paaftësia paguese
- Likuiditeti
- Operacional
- Praktikatat standarde

Metoda e menaxhimit të rrezikut Angazhimi.

Planifikimi i investimit tuaj

Disponueshmëria e produktit Fondi është i disponueshëm për investitorët dhe investitorët me njohuri bazë, me ose pa këshillim.

Profili i investitorit Investitorë që i kuptojnë rreziqet e fondit dhe planifikojnë të investojnë në periudha afatmesme.

Fondi mund të tërheqë investitorë të cilët:

- po kërkojnë një investim që kombinon të ardhurat dhe rritjen, si dhe parapëlqejnë investimet e qëndrueshme,
- janë të interesuar për ekspozimin ndaj një përzjerje aktiveve të larmishme, qoftë për një investim bazë ose për qëllime diversifikimi

Përpunimi i kërkesave Kërkesat për blerjen, shkëmbimin ose shitjen e njësive të fondit që merren dhe pranohen nga agjenti i transferimit deri në orën 16:00 CET të çdo ditë që është një ditë pune në Luksemburg përpunohen zakonisht ditën pasuese të punës.

Pagesa kryhet jo më vonë se 3 ditë pune pas pranimit të një kërkesë.

Ngjarjet që lidhen me fondin

3/7/2006 E emetuar si SMS Sanpaolo Manager Selection 20.

14/7/2009 E riemërtuar si Eurizon Manager Selection Fund – MS 20.

Kategoritë bazë të kuotave

Kategor- ia	Monedha	Investimi minimal	Vlera minimale e zotëruar	Maks. Tarifat e tregtimit		Tarifat vjetore	
				Hyrje	Dalje	Menaxhimi	Tarifat maksimale të administrimit
R	EUR	500	-	1,50%	-	1,40%	0,25%
Z	EUR	3 milionë	3 milionë	-	-	0,40%	0,25%

Shihni "Fund Fees and Costs" për një shpjegim më të plotë të tarifave të mësipërme. Për të parë listën aktuale dhe të plotë të kategorive të kuotave të disponueshme, vizitoni eurizoncapital.com.

MS 40

Objektivi dhe politika e investimeve

Objektivi Të rrisë vlerën e investimit tuaj me kalimin e kohës.

Indeksi referencë 40% JP Morgan Economic dhe Monetary Union (EMU) Index + 40% MSCI World Index (kthimi total neto) + 20% FTSE MTS Italy BOT – Ex-Bank of Italy. Për krijimin e portofolit dhe matjen e performancës.

Politika e investimit Fondi investon kryesisht, në proporcion të balancuar, në aksione dhe në obligacione qeveritare dhe të korporatave të shprehura në euro. Këto investime mund të jenë nga kudo në botë dhe disa prej tyre mund të jenë nën nivelin e investimit. Fondi kryesisht investon përmes fondeve, por gjithashtu mund të investojë drejtpërdrejt ose përmes derivateve.

Konkretisht, fondi investon të paktën 51% të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera. Fondi investon në borxh dhe instrumente të lidhura me borxhin, duke përfshirë instrumentet e tregut të parasë, dhe në kapitale dhe instrumente të lidhura me kapitalin, përfshirë obligacionet e konvertueshme.

Fondi mund të investojë në kategoritë e mëposhtme të aktiveve deri në përqindjet e treguara të totalit të aktiveve neto:

- tituj kapitali dhe instrumente të lidhura me tituj e kapitalit: 50%, minimumi 30% (afërsisht 40% mesatarisht)
- instrumente borxhi nën kategorinë investuese ose të pavlerësuar 49%

Derivatvët dhe teknikat Fondi mund të përdorë derivativë për reduktimin e rreziqeve (mbrojtje) dhe të kostove, si dhe për të rritur ekspozimin e investimit.

Fondi synon të përdorë vetëm derivativë bazë (shihni "How the Funds Use Instruments and Techniques").

Përdorimi i TRS-ve E pritshme, 0% e totalit të aktiveve neto; maksimumi, 0%.

Marrëveshjet e riblerjes (repo)/marrëveshjet e anasjella të riblerjes (repo e anasjelltë) E pritshme, 0%; maksimumi, 0%.

Strategjia Në administrimin aktiv të fondit, menaxheri i investimeve përdor analizën makroekonomike së bashku me analizën sasiore dhe cilësore për të rregulluar në mënyrë dinamike përzierjen e aktiveve të portofolit dhe ekspozimin gjeografik dhe për të zgjedhur investimet (qasja nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart). Përqindja e titujve që përbëjnë fondin dhe për rrjedhojë kthimi i tij, mund të kenë ndryshime të vogla me ato të indeksit referencë.

Qasja ndaj qëndrueshmërisë Fondi promovon (E) karakteristikat mjedisore dhe/ose (S) sociale dhe investon në asete duke ndjekur praktikatat e qeverisjes së mirë (G) në përputhje me nenin 8 të Rregullores për Publikimin e Financave të Qëndrueshme ("SFDR").

Menaxheri i investimeve i përdor kriteret mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) si një element thelbësor të strategjisë së tij. Ai përjashton letrat me vlerë nga emetuesit ose sektorët me një profil të ulët ESG ose që janë të përfshirë me armë kontroverze ose që nxjerrin 25% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga aktivitetet e minierave ose prodhimit të energjisë elektrike të lidhura me qymyrin termik ose 10% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga nxjerrja e rërës së naftës, dhe ndërton një portofol që investon të paktën 70% të totalit të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera të kategorizuara si SFDR Neni 8 ose Neni 9.

Kategoritë bazë të kuotave

Kategor- ia	Monedha	Investimi minimal	Vlera minimale e zotëruar	Maks. Tarifat e tregtimit		Tarifat vjetore	
				Hyrje	Dalje	Menaxhimi	Tarifat maksimale të administrimit
R	EUR	500	-	1,50%	-	1,50%	0,25%
Z	EUR	3 milionë	3 milionë	-	-	0,45%	0,25%

Shihni "Fund Fees and Costs" për një shpjegim më të plotë të tarifave të mësipërme. Për të parë listën aktuale dhe të plotë të kategorive të kuotave të disponueshme, vizitoni eurizoncapital.com.

Për më shumë informacion, shihni "Publikimin parakontraktor të SFDR" dhe seksionin "Politika e Investimeve të Qëndrueshme dhe Integrimi i kriterëve ESG" përfshirë kufizimet metodologjike kryesore, si të dhënat e paplota, të pasakta ose të padisponueshme të palëve të treta dhe shkoni te

<https://www.eurizoncapital.com/pages/sustainability.aspx>.

Publikimi i taksonomisë Investimet në themel të këtij produkti financiar nuk marrin në konsideratë kriteret e BE-së për aktivitetet ekonomike të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

Monedha bazë EUR.

Menaxheri i investimeve Eurizon Capital SGR S.p.A.

Rreziqet kryesore

Shihni "Risk Descriptions" për më shumë informacion.

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e zakonshme të tregut

- Orientimi i indeksit referencë
- Obligacionet e konvertueshme
- Kredi; + nën shkallën e investimit
- Monedha
- Derivatvët
- Kapitali
- Mbrojtja
- Norma e interesit
- Fondi i investimeve
- Menaxhimi
- Tregu
- Investimi i qëndrueshëm

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e pazakonta të tregut ose me ngjarje të tjera të paparashikueshme

- Kundërpala dhe kolaterali
- Paaftësia paguese
- Likuiditeti
- Operacional
- Praktikatat standarde

Metoda e menaxhimit të rrezikut Angazhimi.

Planifikimi i investimit tuaj

Disponueshmëria e produktit Fondi është i disponueshëm për investitorët profesionistë dhe investitorët me njohuri bazë, me ose pa këshillim.

Profili i investitorit Investitorë që i kuptojnë rreziqet e fondit dhe planifikojnë të investojnë në periudha afatmesme.

Fondi mund të tërheqë investitorë të cilët:

- po kërkojnë një investim që kombinon të ardhurat dhe rritjen, si dhe parapëlqejnë investimet e qëndrueshme,
- janë të interesuar për ekspozimin ndaj një përzierje aktiveve të larmishme, qoftë për një investim bazë ose për qëllime diversifikimi

Përpunimi i kërkesave Kërkesat për blerjen, shkëmbimin ose shitjen e njësive të fondit që merren dhe pranohen nga agjenti i transferimit deri në orën 16:00 CET të çdo ditë që është një ditë pune në Luksemburg përpunohen zakonisht ditën pasuese të punës.

Pagesa kryhet jo më vonë se 3 ditë pune pas pranimit të një kërkesë.

Ngjarjet që lidhen me fondin

3/7/2006 E emetuar si SMS Sanpaolo Manager Selection 40.

14/7/2009 E riemërtuar si Eurizon Manager Selection Fund – MS 40.

MS 70

Objektivi dhe politika e investimeve

Objektivi Të rrisë vlerën e investimit tuaj me kalimin e kohës.

Indeksi referencë 70% MSCI World Index (kthimi total neto) + 20% JP Morgan Economic dhe Monetary Union (EMU) Index + 10% FTSE MTS Italy BOT – Ex-Bank of Italy. Për krijimin e portofolit dhe matjen e performancës.

Politika e investimit Fondi investon kryesisht në aksione dhe, në një masë më të vogël, në obligacione qeveritare dhe të korporatave. Këto investime mund të jenë nga kudo në botë dhe disa prej tyre mund të jenë nën nivelin e investimit. Fondi kryesisht investon përmes fondeve, por gjithashtu mund të investojë drejtpërdrejt ose përmes derivateve.

Konkretisht, fondi investon të paktën 51% të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera. Fondi investon në tituj kapitali dhe instrumente të lidhura me titujt e kapitalit, përfshirë obligacionet e konvertueshme, dhe në borxhe dhe instrumente të lidhura me borxhin, duke përfshirë instrumentet e tregut të parasë.

Fondi mund të investojë në kategoritë e mëposhtme të aktiveve deri në përqindjet e treguara të totalit të aktiveve neto:

- tituj kapitali dhe instrumente të lidhura me titujt e kapitalit: 85%, minimumi 55% (afërsisht 70% mesatarisht)
- instrumente borxhi nën kategorinë investuese ose të pavlerësuar 49%

Derivatitë dhe teknikat Fondi mund të përdorë derivativë për reduktimin e rreziqeve (mbrojtje) dhe të kostove, si dhe për të rritur ekspozimin e investimit.

Fondi synon të përdorë vetëm derivativë bazë (shihni "How the Funds Use Instruments and Techniques").

Përdorimi i TRS-ve E pritshme, 0% e totalit të aktiveve neto; maksimumi, 0%.

Marrëveshjet e riblerjes (repo) Marrëveshjet e anasjella të riblerjes (repo e anasjellte) E pritshme, 0%; maksimumi, 0%.

Strategjia Në administrimin aktiv të fondit, menaxheri i investimeve përdor analizën makroekonomike së bashku me analizën sasiore dhe cilësore për të rregulluar në mënyrë dinamike përzierjen e aktiveve të portofolit dhe ekspozimin gjeografik dhe për të zgjedhur investimet (qasja nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart). Përqindja e titujve që përbëjnë fondin dhe për rrjedhojë kthimi i tij, mund të kenë ndryshime të vogla me ato të indeksit referencë.

Qasja ndaj qëndrueshmërisë Fondi promovon (E) karakteristikat mjedisore dhe/ose (S) sociale dhe investon në asete duke ndjekur praktikatat e qeverisjes së mirë (G) në përputhje me nenin 8 të Rregullores për Publikimin e Financave të Qëndrueshme ("SFDR").

Menaxheri i investimeve i përdor kriteret mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG) si një element thelbësor të strategjisë së tij. Ai përjashton letrat me vlerë nga emetuesit ose sektorët me një profil të ulët ESG ose që janë të përfshirë me armë kontroverze ose që nxjerrin 25% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga aktivitetet e minierave ose prodhimit të energjisë elektrike të lidhura me qymyrin termik ose 10% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga nxjerrja e rërës së naftës, dhe ndërton një portofol që investon të paktën 70% të totalit të aktiveve neto në UCITS ose UCIs të tjera të kategorizuara si SFDR Neni 8 ose Neni 9.

Kategoritë bazë të kuotave

Kategor- ia	Monedha	Investimi minimal	Vlera minimale e zotëruar	Maks. Tarifatat e tregtimit		Tarifat vjetore	
				Hyrje	Dalje	Menaxhimi	Tarifatat maksimale të administrimit
R	EUR	500	-	1,50%	-	1,60%	0,25%
Z	EUR	3 milionë	3 milionë	-	-	0,55%	0,25%

Shihni "Fund Fees and Costs" për një shpjegim më të plotë të tarifave të mësipërme. Për të parë listën aktuale dhe të plotë të kategorive të kuotave të disponueshme, vizitoni eurizoncapital.com.

Për më shumë informacion, shihni "Publikimin parakontraktor të SFDR" dhe seksionin "Politika e Investimeve të Qëndrueshme dhe Integrimi i kriterëve ESG" përfshirë kufizimet metodologjike kryesore, si të dhënat e paplota, të pasakta ose të padisponueshme të palëve të treta dhe shkoni te

<https://www.eurizoncapital.com/pages/sustainability.aspx>.

Publikimi i taksonomisë Investimet në themel të këtij produkti financiar nuk marrin në konsideratë kriteret e BE-së për aktivitetet ekonomike të qëndrueshme nga aspekti mjedisor.

Monedha bazë EUR.

Menaxheri i investimeve Eurizon Capital SGR S.p.A.

Rreziqet kryesore

Shihni "Risk Descriptions" për më shumë informacion.

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e zakonshme të tregut

- Orientimi i indeksit referencë
- Obligacionet e konvertueshme
- Kredi; + nën shkallën e investimit
- Monedha
- Derivatitë
- Kapitali
- Mbrojtja
- Norma e interesit
- Fondi i investimeve
- Menaxhimi
- Tregu
- Investimi i qëndrueshëm

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e pazakonta të tregut ose me ngjarje të tjera të paparashikueshme

- Kundërpala dhe kolaterali
- Paaftësia paguese
- Likuiditeti
- Operacional
- Praktikatat standarde

Metoda e menaxhimit të rrezikut Angazhimi.

Planifikimi i investimit tuaj

Disponueshmëria e produktit Fondi është i disponueshëm për investitorët profesionistë dhe investitorët me njohuri bazë, me ose pa këshillim.

Profili i investitorit Investitorët që i kuptojnë rreziqet e fondit dhe planifikojnë të investojnë në periudha afatgjata.

Fondi mund të tërheqë investitorë të cilët:

- kërkojnë një investim të orientuar drejt rritjes dhe parapëlqejnë investimet e qëndrueshme
- janë të interesuar për ekspozimin ndaj një përzierje aktiveve të larmishme, qoftë për një investim bazë ose për qëllime diversifikimi

Përpunimi i kërkesave Kërkesat për blerjen, shkëmbimin ose shitjen e njësive të fondit që merren dhe pranohen nga agjenti i transferimit deri në orën 16:00 CET të çdo ditë që është një ditë pune në Luksemburg përpunohen zakonisht ditën pasuese të punës.

Pagesa kryhet jo më vonë se 3 ditë pune pas pranimit të një kërkesë.

Ngjarjet që lidhen me fondin

3/7/2006 Të emetuara si SMS Sanpaolo Manager Selection 70.

14/7/2009 E riemërtuar si Eurizon Manager Selection Fund – MS 70.

Përshkrimet e rreziqeve

Të gjitha investimet përfshijnë rrezik. Rreziqet e disa prej këtyre fondeve mund të jenë relativisht të larta.

Përshkrimet e mëposhtme të rreziqeve përkohë me faktorët kryesorë të rrezikut të renditur për çdo fond. Një fond mund të preket nga rreziqe të tjera përtej atyre të renditur ose të përshkruar këtu, dhe këto përshkrime të rreziqeve nuk synohen si shteruese. Çdo rrezik është përshkruar si në rastin e një fondi individual.

Secili prej këtyre rreziqeve mund të bëjë që një fond të humbasë para, të arrijë kthime më të ulëta krahasuar me investime të ngjashme ose me një indeks referencë, të pësojë luhatshmëri të lartë (rritje dhe rënie të NAV-së), ose të mos përmbushë objektivin e tij gjatë një periudhe të caktuar kohore.

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e zakonshme të tregut

Në përgjithësi, rreziqet e përfshira në këtë seksion janë të pranishme në një masë të konsiderueshme në kushtet e zakonshme të tregut, por kanë tendencën që të jenë gjithashtu të pranishme dhe më të fuqishme në kushte të pazakonta të tregut.

Rreziku i ABS-ve/MBS-ve Titujt e mbështetur në kredi hipotekare dhe titujt e mbështetur në aktive (MBS-të dhe ABS-të), si dhe llojet e tjera të titujve të borxhit të kolateralizuar, mbartin zakonisht rreziqe të parapagimit dhe shtyrjes së parapagimit, si dhe mund të mbartin rrezik likuiditeti mbi nivelin mesatar.

MBS-të (një kategori që përfshin detyrime hipotekare të kolateralizuara ose CMO) dhe ABS-të përfaqësojnë një interes në një grup instrumentesh borxhi, si p.sh. të arkëtueshmet nga kartat e kreditit, kreditë për automjete, kreditë studentore, marrja me qira e pajisjeve, kreditë për banesa dhe kreditë mbi kapitalin për shtëpi.

Gjithashtu, MBS-të dhe ABS-të kanë prirjen të kenë një cilësi më të ulët krediti krahasuar me shumë lloje të tjera të titujve të borxhit. Nëse borxhet që janë në themel të një MBS-je ose ABS-je nuk paguhen ose bëhen të paarkëtueshme, titujt e bazuar në këto borxhe do të humbasin një pjesë ose të gjithë vlerën e tyre.

Rreziku i orientimit të indeksit referencë Një fond që menaxhohet duke iu referuar një indeksi referencë mund të ketë performancë më të ulët se indeksi i tij referencë gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe mund të mos marrë asnjë masë për t'u mbrojtur nga humbjet në rastin e rënies së performancës së indeksit referencë.

Indekset e tregut, të cilat zakonisht përdoren si indekse referencë, përllogariten nga subjekte të pavarura pa marrë në konsideratë se si mund të ndikojnë në performancën e fondit. Ofruesit e indeksit nuk japin garanci se përllogaritjet e tyre për indeksin janë të sakta dhe nuk marrin asnjë përgjegjësi për humbjet e investitorëve në një investim që ndjek një prej indekseve të tyre. Nëse një ofrues nuk arrin të ruajë vazhdimësinë e një indeksi ose humbet regjistrimin apo nuk arrin të regjistrohet në ESMA si ofrues i një indeksi referencë, atëherë fondi mund të likuidohet nëse nuk mund të gjendet një zëvendësues i përshtatshëm.

Rreziku i CDO-ve/CLO-ve Këto titujt janë të vështirë për t'u vlerësuar me saktësi për shkak të strukturës së tyre komplekse, sjellja e tyre në kushte të ndryshme tregu mund të jetë e paparashikueshme dhe ato mund të cenohen nga një rënie e vlerës së aktiveve bazë. Transhet/segmentet e poshtme të CDO-ve dhe CLO-ve janë të predispozuar ndaj një rreziku shumë më të lartë se transhetet e sipërme të të njëjtëve titujt.

Rreziku i obligacioneve "CoCo" Titujt e konvertueshëm të kushtëzuar (obligacionet "CoCo") janë relativisht të patestuar, emetuesit e tyre mund të anulojnë ose modifikojnë sipas dëshirës pagesat e planifikuara të të ardhurave, janë më të cenueshëm ndaj humbjeve se titujt e kapitalit, mbartin rrezikun e shtyrjes së parapagimit dhe mund të jenë tejet të luhatshme.

Obligacionet "CoCo" mbartin rreziqet në vijim, ndër të tjera:

- Rreziku i nivelit të nxitjes: Obligacionet "CoCo" emetohen me nivel aktivizimi, për shembull, nëse aktivet bazë likuide të emetuesit bien nën 5%. Nëse arrihet niveli i aktivizimit, obligacionet "CoCo" konvertohen automatikisht në kapital, i cili mund të ketë fare pak ose aspak vlerë. Aktivizimi mund të arrihet edhe përmes një humbjeje të kapitalit (numëruesi) ose një rritjeje të aktiveve të ponderuara me rrezik (emëruesi).
- Anulimi i kuponit: Në disa obligacione "CoCo", emetuesi mund të anulojë pagesat e kuponit në çdo kohë, për çfarëdo arsyeje dhe për një periudhë kohore të papërcaktuar. Pagesat e anuluarat nuk akumulohen. Anulimi mund të krijojë rrezikun e vlerësimit.
- Rreziku i përmbyesjes së strukturës së kapitalit: Një obligacion "CoCo" mund të ketë prioritet të ulët jo vetëm krahasuar me instrumentet e tjera të borxhit, por edhe me ato të kapitalit, çka do të thotë se në rrethana të caktuara (si p.sh. reduktimi i principalit me nivel të lartë aktivizimi), një obligacion "CoCo" do të jetë ndër titujt e parë të emetuesit që do të pësojë humbje.
- Rreziku i zgjatjes së thirrjeve: Duke qenë se obligacionet "CoCo" janë të strukturuar si hua të vazhdueshme, principali mund të shlyhet në datën e maturimit, në çdo moment të mëvonshëm ose asnjëherë.
- Rreziku i panjohur: Nuk dihet se si do të sillen obligacionet "CoCo" në një mjedis të tensionuar. Për shembull, tregu mund ta konsiderojë një nivel aktivizimi ose një pezullim kuponit nga një emetues i vetëm si një ngjarje sistematike që shkakton ndryshime çmimi, luhatshmëri ose rrezik likuiditeti në disa ose në të gjitha kategoritë e aktivitetit.
- Rreziku i rendimentit/vlerësimit: Edhe pse obligacionet "CoCo" kanë tendencën të ofrojnë kthime të kënaqshme, çdo vlerësim i rrezikut të tyre duhet të përfshijë jo vetëm vlerësimet e kreditit të tyre (të cilat mund të jenë nën kategorinë investuese) por edhe rreziqet e tjera që lidhen me obligacionet "CoCo", si rreziku i konvertimit, i anulimit të kuponit dhe i likuiditetit. Nuk është e qartë se deri në çfarë mase janë vlerësuar me saktësi rreziqet e obligacioneve "CoCo" nga investitorët.

Rreziku i mallrave Mallrat kanë tendencën të jenë tejet të luhatshme dhe mund të ndikohen në mënyrë joproporcionale nga ngjarjet e lidhura me politikën, ekonominë, motin, tregtinë, bujqësinë dhe terrorizmin, si dhe nga ndryshimet në kostot e energjisë dhe të transportit.

Rreziku i përqendrimit Nëse fondi investon një sasi të madhe të aktiveve të tij në një numër të kufizuar industrish, sektorësh ose emetuesish, apo brenda një zone gjeografike të kufizuar, ai mund të ketë më tepër rrezik krahasuar me një fond që investon më gjerësisht.

Fokusimi te një shoqëri, industri, sektor, vend, rajon, një lloj i caktuar aksionesh, një lloj i caktuar ekonomie etj., e bën fondin më të ndjeshëm ndaj faktorëve që përcaktojnë vlerën e tregut në fushën përkatëse të fokusit. Këta faktorë mund të përfshijnë kushtet ekonomike, financiare ose kushtet e tregut, si dhe kushtet sociale, politike, ekonomike, mjedisore apo kushte të tjera. Rezultati mund të jetë rritja e luhatshmërisë dhe rritja e rrezikut të humbjes.

Rreziku i letrave me vlerë të konvertueshme Duke qenë se titujt e konvertueshëm janë të strukturuar si obligacione të cilat, zakonisht, mund ose duhet të shlyhen me një sasi të caktuar të kuotave të kapitalit dhe jo me para, ata mbartin rreziqe të kapitalit, kreditit dhe mosshlyerjes që janë tipike për obligacionet

Rreziku shtetëror – Kinë Të drejtat ligjore të investitorëve në Kinë janë të pasigurta, ndërhyrja e qeverisë është diçka e zakonshme dhe e paparashikuar, disa prej sistemeve kryesore të tregtimit dhe ruajtjes janë të paverifikuara, dhe të gjitha llojet

e investimeve kanë gjasa të kenë luhatshtëmëri relativisht të lartë, si dhe rreziqe më të mëdha të lidhura me likuiditetin dhe kundërpalën.

Në Kinë, nuk është e sigurt nëse një gjykatë do ta mbronte të drejtën e fondit lidhur me titujt që ai mund të blejë përmes programeve “Stock Connect”, tregut ndërbankar të obligacioneve në Kinë ose përmes metodave të tjera, rregulloret e të cilave janë të paturuara dhe objekt i ndryshimeve të vazhdueshme. Struktura e këtyre skemave nuk kërkon llogaridhënie të plotë të disa prej subjekteve përbërëse dhe i lë investitorëve, si p.sh. një fondi, shumë pak hapësirë për të ndërmarrë veprime ligjore në Kinë. Për më tepër, bursat e titujve ose autoritetet kineze mund të tatonjë ose të kufizojnë fitimet afatshkurtra, të tërheqin aksionet e pranueshme, të përcaktojnë ose ndryshojnë kuotat (vëllimet maksimale të tregtimit, qoftë në nivel investitori ose në nivel tregu) ose mund të bllokojnë, limitojnë, kufizojnë apo vonojnë tregtimin, duke penguar ose parandaluar fondin që të zbatojë strategjitë e synuara.

Programet “Shanghai-Hong Kong Stock Connect” dhe “Shenzhen-Hong Kong Stock Connect”. Stock Connect është një projekt i përbashkët i Hong Kong Exchanges and Clearing Limited (HKEX), China Securities Depository and Clearing Corporation Limited (ChinaClear), Shanghai Stock Exchange and the Shenzhen Stock Exchange. Hong Kong Securities Clearing Company Limited (HKSCC), një shtëpi klingeru që nga ana tjetër operohet nga HKEX, vepron si e nominuar për investitorët që hyjnë në Stock Connect Securities.

Kreditorët e të emeruarit ose kujdestarit mund të pohojnë se aktivet në llogaritë e mbajtura për fondet janë në fakt aktive të të emeruarit ose të kujdestarit. Nëse gjykata e mbështet këtë pohim, kreditorët e të emeruarit ose kujdestarit mund të kërkojnë pagesë nga aktivet e fondit përkatës. HKSCC, në cilësinë e të emëruarit, nuk garanton pronësinë e titujve në “Stock Connect” që mbahen përmes saj dhe nuk ka asnjë detyrim që të ushtrijë të drejtat e pronësisë ose të drejtat e tjera që lidhen me pronësinë, në emër të pronarëve përfitues (si p.sh. fondet). Rrjedhimisht, pronësia në këto tituj ose të drejtat që lidhen me to (si p.sh. pjesëmarrja në veprimet e korporatës ose mbledhjet e aksionarëve), nuk mund të garantohen.

Nëse FCP-ja ose një fond pëson humbje që vijnë nga performanca ose paaftësia paguese e HKSCC-së, FCP-ja nuk do të kishte rekurs të drejtpërdrejtë ligjor kundër HKSCC-së, sepse ligji kinez nuk njih asnjë marrëdhënie të drejtpërdrejtë ligjore ndërmjet HKSCC-së dhe FCP-së ose depozitarit.

Nëse ChinaClear do të falimentonte, HKSCC do të kishte detyrime kontraktuale të kufizuara për të ndihmuar pjesëmarrësit që kanë pretendime. Përpjekjet e një fondi për të rikuperuar aktivet e humbura mund të përfshijnë vonesa dhe shpenzime të konsiderueshme dhe mund të mos jenë të suksesshme.

Tregu ndërbankar i obligacioneve në Kinë. CIBM është një treg mbi banak që ofron një mënyrë për investitorët e jashtëm (si p. sh. fondi) që të blejnë obligacione korporative dhe qeveritare kineze. CIBM mund të ketë vëllime të ulëta tregtare dhe marzhe të mëdha ndërmjet çmimit më të lartë dhe më të ulët të blerjes, duke i bërë obligacionet relativisht më pak likuide dhe më të shtrenjta.

Bond Connect. “Bond Connect” synon të rrisë efikasitetin dhe fleksibilitetin e investimit në tregun ndërbankar të obligacioneve në Kinë. Megjithatë Bond Connect heq kuotën e investimeve të CIBM dhe nevojën për një agjent të shlyerjes së obligacioneve, investimet e bëra përmes Bond Connect mund të jenë subjekt i paqëndrueshmërisë së lartë të çmimeve dhe mungesës së mundshme të likuiditetit për shkak të vëllimit të ulët të tregtimit të letrave me vlerë të caktuara të borxhit. Marzhet e mëdha midis çmimit më të lartë dhe më të ulët të blerjes, të cilat e vështirësojnë shitjen e obligacioneve me fitim, përbëjnë gjithashtu një rrezik, krahas rrezikut të kundërpalës.

Renminbi i tregtuar brenda dhe jashtë vendit. Në Kinë, qeveria mban dy valuta të veçanta: renminbi i brendshëm (CNY), i cili duhet të mbetet brenda për brenda Kinës dhe zakonisht nuk mund të zotërohet nga të huajt, dhe renminbi i jashtëm (CNH), i cili mund të zotërohet nga çdo investitor. Kursi i këmbimit ndërmjet tyre dhe niveli i lejuar i shkëmbimeve valutore që përfshijnë CNH menaxhohen nga qeveria, bazuar në një kombinim të aspekteve të tregut dhe politikave. Kjo padyshim që krijon rrezik të kursit të këmbimit në monedhën e një kombi, si dhe rrezik likuiditeti, duke qenë se konvertimi i CNY në CNH dhe i CNH në monedha të tjera mund të kufizohet, ashtu siç mund të ndodhë edhe me largimin e një monedhe të caktuar nga Kina ose Hong-Kongu.

Rreziku shtetëror – Rusi Në Rusi, rreziqet e lidhura me kujdestarinë dhe kundërpalët janë më të larta se në vendet e zhvilluara.

Institucionet kujdestare ruse zbatojnë rregullat e tyre, kanë shumë më pak përgjegjësi dhe llogaridhënie ndaj investitorëve, mund të kenë rregullim të dobët ose mund të jenë të ekspozuara ndaj mashtrimit, neglizhencës ose gabimit. Tregjet e titujve në këto vende mund të vuajnë gjithashtu nga mungesa e efikasitetit dhe likuiditetit, çka mund të përkeqësojë luhatshtëmërinë e çmimeve dhe shtrembërimet e tregut.

Rreziku i obligacioneve të mbuluara Krahas mbartjes së rrezikut të kreditit, të mosshlyerjes dhe normave të interesit, obligacionet e mbuluara mund të jenë më pak likuide se shumë lloje të tjera obligacionesh, dhe kolaterali i vendosur mënjanë për të siguruar principalin e obligacionit mund të pësojë rënie të vlerës.

Duke qenë se paaftësia paguese e një emetuesi do të rregullohet zakonisht nga ligjet e vendit të themelimit të emetuesit, këto ligje mund të ofrojnë më pak mbrojtje se, për shembull, ligji i Luksemburgut. Luhatshtëria e çmimeve të një obligacioni të mbuluar do të ndikohet nga tiparet specifike të emetimit, si normat fikse/të luhatshme, mundësia e riblerjes opsionale nga emetuesi ose çmimi i emetimit, duke përfshirë një zbritje ose prim të konsiderueshëm. Nëse tregu dytësor për një obligacion të mbuluar është i kufizuar, emetimi përkatës mund të ketë rrezik likuiditeti.

Rreziku i kreditit Një obligacion ose instrument i tregut monetar nga çdo lloj emetuesi mund të pësojë rënie çmimi dhe të bëhet më i luhatshtëm dhe më pak likuid nëse ka rënie të vlerësimit të kreditit të titullit ose të gjendjes financiare të emetuesit, apo nëse tregu beson se mund të ndodhë një rënie e tillë. Sa më e ulët të jetë cilësia e kreditit të borxhit dhe sa më i lartë ekspozimi i fondit ndaj obligacioneve nën kategorinë investuese, aq më i lartë rreziku.

Obligacionet nën kategorinë investuese. Këta tituj konsiderohen spekulativë. Krahasuar me obligacionet e kategorisë investuese, çmimet dhe normat e obligacioneve nën kategorinë investuese janë më të luhatshme dhe më të ndjeshme ndaj ngjarjeve ekonomike, janë më pak likuide dhe mbartin rrezik më të lartë të paaftësisë paguese.

Titujt e shoqërive në vështirësi financiare dhe në paaftësi paguese. Edhe pse këta tituj mund të ofrojnë kthime të larta, ata kanë cilësinë më të ulët të kreditit, janë tejet spekulativë, mund të vlerësohen ose shiten me shumë vështirësi dhe shpeshherë përfshijnë situata komplekse dhe të pazakonta, si dhe veprime ligjore madhore (si p.sh. falimentimi ose likuidimi i emetuesit), rezultati i të cilave është tejet i pasigurt.

Borxhi sovran. Borxhi i lëshuar nga qeveritë dhe subjektet shtetërore ose të kontrolluara mund të jetë subjekt i shumë rreziqeve, veçanërisht në rastet kur qeveria është e varur nga pagesat ose zgjerimet e kredisë nga burime të jashtme, nuk është në gjendje të ndërmarrë reformat e nevojshme sistemike ose të kontrollojë opinionin vendas ose është jashtëzakonisht ndjeshme ndaj ndryshimeve në opinionet gjeopolitike ose ekonomike.

Edhe nëse një emetues qeveritar është në gjendje të shlyejë borxhin e tij, opsionet e investitorëve mund të jenë të pakta nëse ai vendos të vonojë, reduktojë ose anulojë detyrimet e tij, pasi rruga kryesore për të kërkuar shlyerjen e pagesës janë gjykatat e vetë emetuesit sovran.

Detyrimet e borxhit të kolateralizuar. Këta tituj kombinojnë, në mënyrë të përqendruar, rreziqet e kreditit të obligacioneve nën kategorinë investuese, rreziqet e parapagimit dhe shtyrjes së parapagimit të ABS-ve dhe MBS-ve dhe rreziqet e levës financiare që lidhen me derivativët.

Duke qenë se titujt ndajnë rreziqet dhe përfitimet e grupit bazë të investimeve në tranche ose segmente, tranшетë me rrezik më të lartë mund të humbasin krejtësisht vlerën edhe nëse nuk paguhet një pjesë relativisht e vogël e kredive hipotekare në themel të tyre.

Rreziku i kreditit i lidhur me aspektet mjedisore. Efektet negative të çështjeve mjedisore, si ndryshimet klimatike dhe katastrofat natyrore, mund të dëmtojnë gjendjen financiare të një emetuesi obligacionesh dhe mund të kufizojnë aftësinë e tij për të shlyer një borxh.

Rreziku i kursit të këmbimit Nëse fondi mban aktive të shprehura në monedha të tjera krahas asaj bazë, ndryshimet në normat e kursit të këmbimit mund të ulin fitimet apo të ardhurat nga investimi ose mund të rrisin humbjet nga investimi, në mënyrë të konsiderueshme në disa raste.

Kurset e këmbimit mund të ndryshojnë me shpejtësi dhe në mënyrë të paparashikueshme dhe mund të jetë e vështirë për një fond që të anulohet në kohën e duhur ekspozimin ndaj një monedhe të caktuar për të shmangur humbjet. Ndryshimet në kurset e këmbimit mund të ndikohen nga faktorë të tillë si bilanci tregtar eksport-import, tendencat ekonomike dhe politike, ndërhyrjet qeveritare dhe spekulimi i investitorit.

Ndërhyrja nga një bankë qendrore, si p.sh. blerja ose shitja agresive e monedhave, ndryshimet në normat e interesit, kufizimet mbi lëvizjet e kapitalit ose heqja e kursit fikse të një monedhe ndaj një tjetre, mund të shkaktojë ndryshime të papritura ose afatgjata në kurset relative të monedhave.

Rreziku i derivativëve Ndryshime të vogla në vlerën e një aktivi në të cilin mbështetet një derivativ mund të shkaktojë ndryshime të mëdha në vlerën e këtij të fundit, duke i bërë në përgjithësi derivativët tejet të luhatshëm dhe duke e ekspozuar fondin ndaj humbjeve që mund të jenë shumë më të mëdha se kosto e derivativit.

Derivatvët janë subjekt i rreziqeve të aktiveve në të cilët ata mbështeten, zakonisht në forma të ndryshme dhe tejet të aplikuar, si dhe mbartin rreziqet e tyre. Disa prej rreziqeve kryesore të derivativëve janë:

- çmimi dhe luhatshmëria e disa derivativëve, në veçanti e swap-ëve të mosshlyerjes së kredisë dhe e detyrimeve të borxhit të kolateralizuar, mund të devijojnë nga çmimi ose luhatshmëria e referencave në themel të tyre, në disa raste në mënyrë të konsiderueshme dhe të paparashikuar
- në kushte të vështira tregu, mund të jetë e pamundur ose e pabaralizueshme të nxirren urdhra që mund të kufizojnë ose kompenzojnë ekspozimin në treg ose humbjet financiare të krijuara nga disa derivativë
- derivativët përfshijnë kosto të cilat përndryshe nuk do t'i shkaktoheshin fondit
- mund të jetë e vështirë të parashikohet se si mund të sillen një derivativ në kushte të caktuara tregu; ky rrezik është më i madh për derivativët më të rinj ose të llojeve më komplekse
- ndryshimet në ligjet për tatimet, kontabilitetin ose titujt mund të shkaktojnë rënieën e vlerës së një derivativi ose mund të detyrojnë fondin të mbyllë një pozicion derivativi në rrethana të pafavorshme
- disa derivativë, në veçanti kontratat "future", opsionet, swap-ët e kthimit total, kontratat për diferencat dhe disa kontrata të detyrimeve të kushtëzuara, mund të përfshijnë marzhe për huamarrje, çka do të thotë se fondi mund të jetë i detyruar të zgjedhë ndërmjet likuidimit të titujve për të përmbushur

thirrjen për marzh ose të pranojë humbje në një pozicion, i cili, nëse do të mbahej më gjatë, mund të kishte sjellë një humbje ose fitim më të vogël

Derivatvët e tregtuar në bursë Tregtimi i këtyre derivativëve ose i aktiveve në themel të tyre mund të pezullohet ose të jetë objekt i kufizimeve. Gjithashtu, ekziston rreziku që shlyerja e këtyre derivativëve përmes një sistemi transferimi të mos ndodhë në kohën ose mënyrën e parashikuar.

Derivatvët mbi banak – të pakleruara Duke qenë se derivativët mbi banak janë në thelb marrëveshje private ndërmjet një fondi dhe një ose disa kundërpalëve, ata janë më pak të rregulluar se titujt e tregtuar në tregje. Ata mbartin gjithashtu rreziqe më të mëdha të kundërpalës dhe likuiditetit, dhe përcaktimi i çmimit të tyre është më subjektiv. Nëse një kundërpalë resht së ofruari një derivativ, i cili ishte planifikuar për t'u përdorur nga një fond, atëherë ky fond mund të mos jetë në gjendje të gjejë një derivativ të ngjashëm diku tjetër dhe mund të humbasë një mundësi fitimi ose mund të ekspozohet në mënyrë të papritur ndaj rreziqeve ose humbjeve, duke përfshirë humbjet nga një pozicion derivativi për të cilin nuk ishte në gjendje të blinte një derivativ kompensues.

Duke qenë se zakonisht është jopraktike për FCP-në që të ndajë transaksionet e derivativëve mbi banak ndërmjet një game të gjerë kundërpalësh, atëherë një rënie e gjendjes financiare të një kundërpale mund të shkaktojë humbje të konsiderueshme. Nga ana tjetër, nëse një fond pëson rënie të gjendjes financiare ose nuk arrin të përmbushë një detyrim, kundërpalët mund të mos jenë më të gatshme të bëjnë biznes me FCP-në, çka mund t'i shkaktojë FCP-së pamundësi për të operuar në mënyrë efektive dhe konkurruese.

Derivatvët mbi banak – të kleruara Duke qenë se këta derivativë janë të kleruar në një platformë tregtimi, rreziqet e tyre të likuiditetit janë të ngjashme me ato të derivativëve të tregtuar në bursë. Megjithatë, ata mbartin një rrezik të kundërpalës të ngjashëm me atë të derivativëve mbi banak të pakleruar.

Rreziqet e tregjeve në zhvillim dhe atyre kufitare Tregjet në zhvillim dhe ato kufitare janë më pak të qëndrueshme dhe më të luhatshme se tregjet e zhvilluara. Ato përfshijnë rreziqe më të larta, veçanërisht rrezik të tregut, të kreditit, të titujve jolikuidë, ligjor, të kujdestarisë dhe të kursit të këmbimit, dhe ka më shumë gjasa të përballtet me rreziqe, të cilat në tregjet në zhvillim kanë lidhje me kushtet e pazakonta të tregut.

Ndër arsytet për këtë nivel më të lartë rreziku përfshihen:

- paqëndrueshmëria politike, ekonomike ose sociale
- ekonomitë të cilat mbështeten gjerësisht në industri ose partnerë tregtarë të caktuar
- inflacioni i pakontrolluar
- tarifatat e larta ose të paparashikueshme ose format e tjera të proteksionizmit
- kuotat, rregulloret, ligjet, kufizimet mbi sjelljen e parave nga juridiksione të huaja, ose praktikatat e tjera që vendosin në disavantazh investitorët e huaj (si p.sh. fondi)
- ndryshimet në ligje ose pamundësia për të zbatuar ligjet ose rregulloret, për të mundësuar mekanizma të drejtë ose funksionale për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose ndjekjen e rekurseve, ose për të njohur të drejtat e investitorëve ashtu si në tregjet e zhvilluara.
- tarifatat, kostot e tregtimit dhe tatimet e tepërta ose konfiskimi përfundimtar i aktiveve
- rezervat e pamjaftueshme për të mbuluar rastet e paafetësisë paguese të emetuesit ose kundërpalës
- informacioni i paplotë, çorientues ose i pasaktë mbi titujt dhe emetuesit e tyre
- praktikatat e kontabilitetit, të auditimit dhe të raportimit financiar pa standarde ose nën standardet e kërkuara
- tregje të vogla dhe me vëllime të ulëta tregtimi, të cilat rrjedhimisht mund të jenë të cenueshme ndaj rrezikut të likuiditetit dhe manipulimit të çmimeve të tregut

- mbylljet e tregut dhe vonesat arbitrare
- infrastrukturë tregu e nënzhvilluar, e cila nuk është në gjendje të përballojë pikun e vëllimeve të tregtimit
- mashtrimi, korrupsioni dhe gabimet

Në disa vende, tregjet e titujve mund të vuajnë gjithashtu nga mungesa e efikasitetit dhe likuiditetit, çka mund të përkeqësojë luhatshmërinë e çmimeve dhe shtrembërimet e tregut.

Nëse tregjet në zhvillim janë në zona kohore të ndryshme nga ajo e Luksemburgut, fondi mund të mos jetë në gjendje të reagojë në kohën e duhur ndaj lëvizjeve të çmimeve që ndodhin në oraret kur fondi nuk është i hapur për aktivitet.

Për qëllime të rrezikut, kategoria e tregjeve në zhvillim përfshin tregjet që janë më pak të zhvilluara, si shumica e vendeve në Azi, Afrikë, Amerikën e Jugut dhe Evropën Lindore, si dhe vendet si Kina, Rusia dhe India, të cilat kanë ekonomi të suksesshme por mund të mos ofrojnë nivelet më të larta të mbrojtjes së investitorëve.

Rreziku i titujve të kapitalit Titujt e kapitalit mund të humbasin vlerë me shpejtësi, dhe zakonisht përfshijnë rreziqe tregu më të mëdha (shpeshherë shumë më të mëdha) se obligacionet apo instrumentet e tregut monetar.

Nëse një shoqëri nis procedurën e falimentimit ose një ristrukturim të ngjashëm financiar, titujt e saj të kapitalit mund të humbasin të gjithë vlerën e tyre ose një pjesë të mirë të saj.

Çmimi i një titulli kapitali varion sipas ofertës dhe kërkesës, si dhe pritshmërive të tregut mbi rentabilitetin e ardhshëm të shoqërisë, i cili mund të ndikohet nga faktorë të tillë si kërkesa konsumatore, inovacionet e produkteve, veprimtaritë e konkurrentëve, fakti nëse një shoqëri zgjedh të trajtojë faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes (ESG) apo mënyra se si zgjedh t'i trajtojë ato.

Shembuj të praktikave të qëndrueshmërisë përfshijnë zbutjen e efekteve të ngjarjeve ekstreme të motit, uljen e ndikimeve mjedisore, përmirësimin e kushteve të punës, nxitjen e mosdiskriminimit në vendin e punës dhe zbatimin e një qeverisjeje të fortë dhe transparente.

Rreziku i mbrojtjes Tentativat për të reduktuar ose eliminuar rreziqe të caktuara mund të mos sjellin rezultatin e synuar. Edhe nëse funksionojnë siç duhet, në përgjithësi, krahas eliminimit të rreziqeve të humbjes, ato do të eliminojnë edhe potencialet për fitime.

Fondi mund të përdorë mbrojtje brenda fondit të tij dhe lidhur me kategori të synuara të kuotave, për të mbrojtur këtë kategori nga rreziku i kursit të këmbimit. Mbrojtja përfshin kosto të cilat reduktojnë performancën e investimit. Për rrjedhojë, për çdo kategori kuotash që përfshin mbrojtje si në nivel fondit ashtu dhe në nivel të kategorisë së kuotave, mund të ekzistojnë dy nivele mbrojtjeje, disa prej të cilave mund të mos sjellin përfitim (për shembull, në nivel fondit, një fond mund të mbrojë në euro aktivet e shprehura në SGD, ndërsa një njësi e kuotave të mbrojtura në SGD të këtij fondi do të anulonte mbrojtjen e mësipërme).

Rreziqet që lidhen me mbrojtjen e kategorive të kuotave nga luhatjet e kursit të këmbimit (si p.sh. rreziku i kundërpalës) mund të prekin investitorët e kategorive të tjera të kuotave. Për një listë të fondeve me kategoritë e kuotave që mund të përjetojnë rrezik ngjitjeje, shkoni te eurizoncapital.com.

Rreziku i titujve jolikuidë Disa tituj, nga natyra, mund të jetë e vështirë që të vlerësohen ose të shiten në kohën dhe me çmimin e dëshiruar, veçanërisht në sasi të papërcaktuara.

Këtu mund të përfshihen titujt që konsiderohen përgjithësisht si jolikuidë, si p.sh. titujt e palistuar, titujt e Rregullit 144A dhe titujt që janë pjesë e një emetimi në sasi të vogël, titujt që nuk tregtohen shpesh ose që tregtohen në tregje të cilët janë relativisht të vegjël ose kanë periudha të gjata pagese. Gjithashtu, kostot e likuidimit të titujve jolikuidë janë shpeshherë më të larta.

Rreziku i titujve të lidhur me inflacionin Nëse inflacioni bie ose mbetet në nivele të ulëta, do të bien ose do të mbeten të ulëta edhe normat e titujve afatshkurtër të lidhur me inflacionin.

Rreziku i normës së interesit Në përgjithësi, kur rriten normat e interesit, bien vlerat e obligacioneve. Në përgjithësi, sa më e madhe të jetë kohëzgjatja e një investimi në obligacione, aq më i madh është rreziku.

Për depozitat bankare dhe për instrumentet e tregut monetar dhe investimet e tjera me maturim afatshkurtër, rreziku i normës së interesit lëviz në drejtim të kundërt. Rënia e normave të interesit parashikohet se mund të shkaktojë rënie të kthimeve të investimit.

Rreziku i fondeve të investimit Në të gjitha fondet e investimeve, investimi në fond përfshin disa rreziqe me të cilat një investitor nuk do të përballojë nëse do të investonte drejtpërdrejt në tregje:

- veprimet e investitorëve të tjerë, në veçanti flukset dalëse monetare të papritura dhe në nivele të larta, mund të ndikojnë në menaxhimin e rregullt të fondit dhe mund të shkaktojnë rënie të NAV-së së tij
- investitori nuk mund të përcaktojë ose të ndikojë në mënyrën sesi investohen paratë ndërkohë që është pjesë e fondit
- fondi është objekt i ligjeve dhe rregulloreve të ndryshme të investimit që kufizojnë përdorimin e titujve dhe teknikave të caktuara të investimit që mund të përmirësojnë performancën; nëse fondi vendos të regjistrohet në juridiksione që aplikojnë kufizime më të ngushta, ky vendim mund të kufizojë më tej veprimtaritë e tij të investimit
- duke qenë se fondi e ka bazën në Luksemburg, mund të mos zbatohen mbrojtjet që do të ofroheshin nga rregullatorët të tjerë (duke përfshirë ato të rregullatorit kombëtar, në rastin e investitorëve jashtë Luksemburgut)
- ndryshimet e rregulloreve në mbarë botën dhe rritja e shqyrtimit të imtësishëm rregullator të shërbimeve financiare mund të çojë në rregullore të reja ose ndryshime të tjera që mund të kufizojnë mundësitë ose të rrisin kostot e FCP-së
- duke qenë se kuotat e fondit nuk tregtohen në tregje publike, në përgjithësi, mundësia e vetme për likuidimin e kuotave është riblerja, e cila është objekt i politikave të riblerjes të përcaktuara nga fondi
- për shkak të mënyrës së llogaritjes së tarifave të performancës, në disa raste ekziston mundësia që një investitor të paguajë një tarifë performancë edhe pse performanca e tyre aktuale është negative
- fondi mund të pezullojë riblerjet e kuotave të tij për ndonjë nga arsytet e përshkruara në "Të drejtat që ne ruajmë" në dokumentin "Investimi në fonde"
- blerja dhe shitja e investimeve të një fondi mund të mos jetë optimale për sa i përket efikasitetit tatarim të një investitori të caktuar
- në masën që fondi investon në UCITS / UCIs të tjera, do të ketë më pak njohuri të drejtpërdrejta dhe asnjë kontroll mbi vendimet e menaxherëve të investimeve të UCITS / UCIs, mund të shkaktojë një shtresë të dytë tarifash (që do të ndikojë negativisht më tej çdo fitim nga investimi), dhe mund të përballon me rrezikun e likuiditetit në përpjekjen për të zbutur investimin e tij në një UCITS/UCI
- FCP-ja mund të mos jetë në gjendje që t'ja faturojë plotësisht përgjegjësinë një ofruesi shërbimesh për humbjet ose mundësitë e humbura si pasojë e veprimeve të tij
- mund të jetë jopraktike ose e pamundur për kategori të ndryshme kuotash që të izolohen plotësisht kostot dhe rreziqet e tyre nga kategoritë e tjera të kuotave, duke përfshirë rrezikun që kreditorët e një kategorie kuotash të një fondi të mund të tentojnë të konfiskojnë aktivet e një kategorie tjetër me qëllim shlyerjen e një detyrimi
- nëse FCP-ja bën biznes me filialet e Eurizon Capital S.A. dhe këto filiale (si dhe filialet e ofruesve të tjerë të shërbimeve) bëjnë biznes me njëra-tjetrën për llogari të FCP-së, atëherë mund të lindin konflikte interesi (megjithatë, për të zbutur këto rreziqe, të gjitha marrëveshjet e biznesit duhet

të realizohen në mënyrë të pavarur dhe pa influencë dhe të gjitha subjektet dhe individët e lidhur me to u nënshtrohen politikave të rrepta të trajtimit të barabartë që ndalojnë përfitim nga informacioni i brendshëm dhe favorizimin)

Kur një fond investon në një tjetër SIKTT/SIK të tjera, këto rreziqe i mbart fondi dhe rrjedhimisht, në mënyrë të tërthortë, edhe mbajtësit e kuotave.

Rreziku i levës financiare Ekspozimi i lartë neto i fondit ndaj investimeve të caktuara mund të rrisë luhatshmërinë e çmimit të kuotave të tij.

Nëse fondi përdor derivativë ose huadhënien e titujve për të rritur ekspozimin e tij neto në një treg, normë, shportë titujsh ose në një burim tjetër financiar referencë, atëherë luhatjet e çmimeve të burimit referencë do të amplifikohen në nivel fondi.

Rreziku i menaxhimit Menaxherët e investimeve të fondit mund të gabojnë në analizën e tregut apo të tendencave ekonomike, në zgjedhjen ose projektimin e modeleve softuerike që përdorin, në alokimin e aktiveve apo në vendime të tjera që lidhen me mënyrën se si do të investohen aktivet e fondit.

Këtu përfshihen projeksionet lidhur me industrinë, tregun, tendencat ekonomike, demografike apo tendencat e tjera, si dhe lidhur me kohën e vendimeve të investimit dhe me fokusin përkatës në investime të ndryshme. Krahas mundësive të humbura për rritjen e performancës së investimit, vendimet e pasuksesshme të menaxhimit mund të përfshijnë kosto të konsiderueshme, si kostot e kalimit në një strategji të re apo përbërje të re të fondit.

Strategjitë që përfshijnë tregtim aktiv (i cili përkufizohet zakonisht si qarkullim më i lartë se 100% në vit) mund të pësojnë kosto të larta tregtimi dhe gjithashtu mund të gjenerojnë një nivel të lartë fitimesh kapitale afatshkurtra, për të cilat mbajtësit e kuotave mund të taten.

Fondet e krijuara së fundmi mund të përdorin strategji ose teknika të paverifikuara dhe mund të jetë e vështirë për investitorët që t'i vlerësojnë për shkak të mungesës së historikut të operimit. Për më tepër, luhatshmëria dhe kthimet e një fondi të ri mund të ndryshojnë pasi një rritje në aktivet e tij kërkon përmirësim të strategjisë dhe metodave.

Rreziku i tregut Çmimet dhe kthimet e shumë titujve mund të ndryshojnë shpesh, ndonjëherë në mënyrë të konsiderueshme, si dhe mund të pësojnë rënie, bazuar në një sërë faktorësh.

Shembuj të këtyre faktorëve përfshijnë:

- zhvillimet politike dhe ekonomike
- politikën qeveritare
- ndryshimet në teknologji dhe në praktikat e biznesit
- ndryshimet demografike, kulturore dhe të popullsisë
- katastrofat natyrore ose ato të shkaktuara nga njeriu
- tendencat atmosferike dhe klimatike
- zbulimet shkencore ose analitike
- kostot dhe disponueshmëria e energjisë, mallrave dhe burimeve natyrore

Efektet e rrezikut të tregut mund të jenë të menjëhershme ose graduale, afatshkurtra ose afatgjata, të kufizuara ose të gjera.

Rreziku i parapagimit dhe i shtyrjes së parapagimit Çdo sjellje e papritur në normat e interesit mund të dëmtojë performancën e titujve të borxhit të thirrshëm (titujt, emetuesit e të cilëve kanë të drejtë të paguajnë principalin e titullit përpara datës së maturimit).

Kur normat e interesit bien, emetuesit prirën që t'i shlyejnë këta tituj dhe të emetojnë tituj të rinj me norma më të ulët interesi. Kur ndodh diçka e tillë, fondi mund të mos ketë alternativë tjetër përveçse të riinvestojë paratë nga këta tituj të parapaguar, me një normë më të ulët interesi ("rreziku i parapagimit")

Në të njëjtën kohë, kur rriten normat e interesit, huamarrësit prirën që të mos i parapagujnë kreditë e tyre hipotekare me interes të ulët. Kjo mund ta detyrojë fondin që të marrë kthime në nivelin e tregut derisa të bien normat e interesit ose derisa

të maturohen titujt ("rreziku i shtyrjes së parapagimit"). Gjithashtu, kjo mund të nënkuptojë se fondi duhet të shesë titujt me humbje ose duhet të heqë dorë nga mundësia për të bërë investime të tjera që mund të kishin performancë më të mirë.

Çmimet dhe kthimet e titujve të kërkueshëm zakonisht pasqyrojnë supozimin se do të paguhet në një pikë të caktuar përpara maturimit. Nëse ky parapagim ndodh, në përgjithësi, fondi nuk do të vuajë efekte negative. Megjithatë, nëse parapagimi ndodh shumë më herët ose më vonë seç parashikohet, atëherë kjo mund të nënkuptojë se fondi praktikisht ka mbipaguar për titujt.

Këta faktorë mund të ndikojnë gjithashtu në kohëzgjatjen e fondit, duke rritur ose ulur ndjeshmërinë ndaj normave të interesit në mënyra të padëshiruara. Në disa rrethana, nëse normat nuk rriten ose ulen kur është parashikuar, atëherë kjo mund të shkaktojë rreziqe të parapagimit ose të shtyrjes së parapagimit.

Rreziku i investimit në pasuri të paluajtshme Trustet e investimeve në pasuri të paluajtshme (REIT) investojnë drejtpërdrejt në pasuri të paluajtshme materiale ose në biznese të lidhura me to, kanë tendencën të kenë luhatshmëri mbi mesatare, dhe mund të dëmtohen nga çdo faktor që ul vlerën e një zone ose prone individuale apo nga rreziqet që lidhen me kreditë hipotekare.

Konkretisht, investimet në pasuri të paluajtshme ose në biznese apo tituj të lidhur me to (duke përfshirë interesat në kreditë hipotekare) mund të dëmtohen nga katastrofat natyrore, rëniet ekonomike, mbindërtimi, ndryshimet zonale, rritjet e taksave, tendencat e popullsisë ose të stilit të jetesës, dështimet e menaxhimit, vështirësia në tërheqjen e qiramarrësve ose në mbledhjen e pagesave, ndotja mjedisore dhe faktorë të tjerë që mund të ndikojnë në vlerën e tregut ose fluksin monetar të investimit, duke përfshirë moskualifikimin e një REIT-je për të transferuar të ardhurat pa u tatuar.

REIT-të e kapitalit preken më së shumti drejtpërdrejt nga faktorët e pasurive të paluajtshme, ndërsa REIT-të e pasurive të paluajtshme janë më të cenueshme nga rreziku i normës së interesit dhe i kreditit (zakonisht nga rëniet në aftësinë paguese të mbajtësve të kredive hipotekare).

Shumë REIT janë në fakt korporata të vogla dhe mbartin rrezikun që lidhet me investimin në titujt e kapitalit të shoqërive me kapital të ulët dhe mesatar. Disa kanë një nivel të lartë të levës financiare, çka rrit luhatshmërinë. Vlera e titujve të lidhur me pasuritë e paluajtshme nuk ndjek detyrimisht vlerën e aktiveve në themel të tyre.

Rreziku i pozicionit në shitje Marrja e një pozicioni në shitje (një pozicion vlera e të cilit lëviz në drejtim të kundërt me vlerën e vetë titullit) përmes derivativëve krijon humbje kur rritet vlera e titullit mbi të cilin mbështetet derivativi. Përdorimi i pozicioneve në shitje mund të rrisë si rrezikun e humbjes ashtu dhe rrezikun e luhatshmërisë.

Humbjet potenciale nga përdorimi i pozicionit në shitje janë teorikisht të pakufizuara, pasi nuk ka asnjë kufizim se deri ku mund të rritet çmimi i një titulli, ndërsa humbja nga një investim "cash" në një titull nuk mund të tejkalojë shumën e investuar.

Shitja e investimeve që nuk zotërohen nga shitësi mund të jetë objekt i ndryshimeve në rregullore, çka mund të krijojë humbje ose pamundësi për të vazhduar përdorimin e pozicioneve në shitje sipas qëllimit apo mund të kufizojë totalisht përdorimin e tyre.

Rreziku i investimit në tituj kapitali të shoqërive me kapital të ulët dhe mesatar Titujt e kapitalit të shoqërive me kapital të ulët dhe mesatar mund të jenë më të luhatshëm dhe më pak likuidë se titujt e kapitalit të shoqërive më të mëdha.

Kompanitë me kapital të vogël dhe të mesëm shpesh kanë më pak burime financiare, histori më të shkurtra operimi dhe linja biznesi më pak të larmishme, dhe si rezultat mund të jenë në rrezik më të madh të pengesave afatgjata ose të përhershme të biznesit. Ofertat fillestare publike (IPO-të) mund të kenë

luhatshmëri të lartë dhe mund të jetë e vështirë që të vlerësohen për shkak të mungesës së historikut të tregtimit dhe rrjedhimisht, të informacionit publik.

Rreziku i titujve “sukuk” Krahas rreziqeve tipike që kanë titujt e ngjashëm të borxhit, titujt “sukuk” mund të jenë më të luhatshme, më pak likuide, mund të përfshijnë kosto më të larta dhe në disa raste mund të mbartin rrezik më të lartë krediti.

Tregu për titujt “sukuk” (tituj të ngjashëm me borxhin, të cilët janë të strukturuar si tituj kapitali për të qenë në pajtim me kufizimet myslimane mbi interesin) është relativisht i ri dhe i vogël, çka do të thotë se rreziku i likuiditetit dhe luhatshmërisë mund të jetë më i lartë krahasuar me titujt jo “sukuk”.

Edhe pse titujt “sukuk” të mbështetur në aktive akordojnë të drejta pronësie në një aktiv bazë, duke ofruar kështu mundësi për investitorët në rast se emetuesi nuk arrin të bëjë pagesat e premtuara, titujt “sukuk” të bazuar në aktive nuk akordojnë të drejta të tilla pronësie dhe për rrjedhojë konsiderohen se kanë rrezik më të lartë krediti.

Rreziku i investimit të qëndrueshëm Një fond që përdor kriteret e qëndrueshmërisë mund të mos ketë performancë të ulët ndaj tregut ose fondeve të tjera që investojnë në aktive të ngjashme, por nuk zbatojnë kriteret e qëndrueshmërisë. Përdorimi i kriterëve të qëndrueshme mund të bëjë që fondi të humbasë mundësitë për të blerë tituj që dëshmohej se kanë kthime më të larta ose luhatshmëri më të ulët, si dhe mund të ndikojë në kohën e marrjes së vendimeve për blerje/shitje, të cilat nuk janë optimale.

Investimi i qëndrueshëm bazohet, deri në një masë të caktuar, në aspektet jofinanciare, të cilat mund të kenë efekte të tërthorta mbi rentabilitetin, si dhe mund të jetë spekulativ. Analiza e fondit mbi vlerësimet e qëndrueshmërisë mund të ketë mangësi ose informacioni mbi të cilin është bazuar analiza mund të jetë i paplotë, i pasaktë ose çorientues. Gjithashtu, është e mundur që fondi të jetë i ekspozuar në mënyrë të tërthortë ndaj emetuesve që nuk përbushin standardet e tij të qëndrueshmërisë.

Shumë kompani në fushën e qëndrueshmërisë janë relativisht të vogla dhe për këtë arsye kanë rrezik të kapitalit të vet të vogël dhe të mesëm, dhe shumë mbështeten në teknologjitë në zhvillim ose modelet e biznesit që mund të kenë një rrezik mbi mesataren e dështimit. Rreziku i tatimit Disa vende tashmë interesin, dividendët ose fitimet kapitale nga disa investime në vendin e tyre. Çdo vend mund të ndryshojë ligjet ose marrëveshjet e tij tatimore në mënyra që ndikojnë te fondi ose te mbajtësit e kuotave të tij.

Ndryshimet tatimore mund të jenë prapavepruese dhe mund të prekin investitorët që nuk kanë investime të drejtpërdrejta në vend. Për shembull, nëse Kina do të ndryshonte klasifikimin e saj tatimor të FCP ose një entiteti të lidhur, të modifikonte ose të mos respektonte një traktat tatimor ose të eliminonte stimujt tatimorë, ajo mund të rriste taksat e duhura për investimet kineze ose madje të rezultonte në një taksë prej 10% (ose më shumë) mbi të ardhurat që FCP merr nga të gjitha burimet në mbarë botën, duke përfshirë ato fonde që nuk mbajnë asnjë investim kinez.

Rreziqet që lidhen zakonisht me kushtet e pazakonta të tregut ose me ngjarje të tjera të paparashikueshme

Në përgjithësi, rreziqet e përfshira në këtë seksion nuk janë të pranishme, në një masë të konsiderueshme, në kushte të zakonshme tregu (por mund të jenë të pranishme në një shkallë të kufizuar). Megjithatë, gjatë kushteve të pazakonta të tregut, këto rreziqe mund të jenë ndër ato më të rënda.

Rreziku i kundërpalës dhe i kolateralit Çdo subjekt me të cilin fondi bën biznes, duke përfshirë ata me të cilët fondi realizon transaksionet e financimit përmes titujve, si dhe subjekte të tjera që kanë kujdestari të përkohshme apo afatgjatë të aktiveve të fondit, mund të mos jenë më të gatshme ose në gjendje të përbushin detyrimet ndaj fondit.

Nëse një kundërpalë, duke përfshirë një depozitar, falimenton, fondi mund të humbasë një pjesë ose të gjitha paratë e tij dhe mund të përballet me vonesa në marrjen mbrapsht të titujve ose mjeteve monetare që ishin në zotërim të kundërpalës. Kjo mund të nënkuptojë se fondi nuk është në gjendje të shesë titujt ose të marrë të ardhura prej tyre gjatë periudhës kur kërkon të ushtrojë të drejtat e tij, proces ky i cili ka gjasa të krijojë kosto shtesë. Për më tepër, vlera e titujve mund të bjerë gjatë periudhës së vonesës.

Duke qenë se depozitat në para nuk janë objekt i ndarjes së aktiveve nga depozitari ose nga një nënkujdestar i caktuar nga depozitari, ato do të ekspozoheshin ndaj një rreziku më të lartë, krahasuar me aktivet e tjera, në rastin e falimentimit të depozitarit ose të nënkujdestarit.

Marrëveshjet me kundërpalët mund të preken nga rreziku i likuiditetit dhe rreziku operacional, dhe secili prej tyre mund të shkaktojë humbje apo të kufizojë aftësinë e fondit për të zbatuar kërkesat për riblerje.

Duke qenë se kundërpalët nuk janë përgjegjëse për humbjet e shkaktuara nga një “ngjarje e forcës madhore” (si p.sh. një katastrofë e rëndë natyrore ose e shkaktuar nga njeriu, protestë, akt terrorist ose luftë), një ngjarje e tillë mund të shkaktojë humbje të konsiderueshme lidhur me marrëveshjet kontraktuale që përfshijnë fondin.

Vlera e kolateralit mund të mos mbulojë vlerën e plotë të një transaksioni dhe mund të mos mbulojë asnjë prej tarifave ose kthimeve që i detyrohen fondit. Nëse një kolateral i mbajtur nga fondi si mbrojtje kundër rrezikut të kundërpalës (duke përfshirë aktivet në të cilat është investuar kolateral në mjete monetare) pëson rënie të vlerës, ai mund të mos e mbrojë plotësisht fondin ndaj humbjeve. Vështirësitë në shitjen e kolateralit mund të vonojnë ose kufizojnë aftësinë e fondit për të zbatuar kërkesat për riblerje. Në rastin e huadhënies së titujve ose transaksioneve të riblerjes, kolaterali i mbajtur mund të gjenerojë më pak të ardhura se sa aktivet e transferuara te kundërpala. Edhe pse fondi përdor marrëveshjet të standardit të industrisë për të gjithë kolateralin, në disa juridiksione mund të jetë e vështirë ose e pamundur që të zbatohen këto marrëveshje sipas legjislacionit të brendshëm.

Rreziku i financimit të titujve Marrëveshjet e huadhënies, riblerjes dhe riblerjes së anasjelltë të titujve dhe këmbimet swaps totale të kthimit i nënshtrohen të gjitha rreziqeve të sipërpërmendura të kundërpatisë dhe kolateralit, duke përfshirë rreziqet e likuiditetit dhe operacionale të përmendur më sipër dhe të përshkruar nën këta emra në këtë prospekt. Rreziqet operacionale shtesë përfshijnë vonesat në shlyerjen e transaksioneve, të cilat mund të ndikojnë në likuiditetin dhe vlerësimet e aktiveve të fondit. Rreziqet shtesë të likuiditetit të marrëveshjeve të riblerjes përfshijnë mundësinë që fondi të mos jetë në gjendje t'i ripaguajë kundërpalës të ardhurat në kohën e duhur. Rreziqet e financimit përmes titujve mund të shkaktojnë cilëndo prej pasojave të padëshiruara të identifikuar në hyrjen e këtij seksioni mbi rreziqet.

Rreziku i paaftësisë paguese Emetuesit e disa obligacioneve mund të mos jenë të gjendje të bëjnë pagesa që lidhen me obligacionet e tyre.

Rreziku i likuiditetit Mund të jetë e vështirë që një titull të vlerësohet ose të shitet në kohën dhe me çmimin e dëshiruar.

Rreziku i likuiditetit mund të ndikojë në vlerën e fondit dhe mund të bëjë që fondi të pezullojë transaksionet me kuotat e tij.

Rreziku operacional Operacionet e fondit mund të jenë objekt i gabimeve njerëzore, proceseve ose qeverisjes së gabuar, defekteve teknologjike, duke përfshirë pamundësinë për të parandaluar ose identifikuar sulmet kibernetike, vjedhjes së të dhënave, sabotazhit ose incidenteve të tjera elektronike.

Rreziqet operacionale mund ta bëjnë fondin objekt të gabimeve që ndikojnë në vlerësimin, përcaktimin e çmimeve, kontabilizimin, raportimin tatimor, raportimin financiar, kujdestarinë dhe tregtimin, ndër të tjera. Rreziqet operacionale

mund të mos zbulohen për periudha të gjata kohore. Edhe nëse ato zbulohen, mund të rezultojë i pamundur rikuperimi me shpejtësi ose marrja e kompensimit të duhur nga përgjegjësit.

Metodat e përdorura nga kriminelët kibernetikë evoluojnë me shpejtësi dhe mbrojtja e besueshme mund të mos jetë gjithmonë e disponueshme. Nëse të dhënat e FCP-së ruhen ose transmetohen në sistemet e disa subjekteve dhe përdoret teknologjia e disa shitësve, atëherë rritet cenueshmëria e FCP-së nga rreziku kibernetik. Rezultatet e mundshme të shkeljeve kibernetike ose aksesit të papërshtatshëm përfshijnë humbjen

Politikat e kreditit

Shoqëria e menaxhimit vlerëson cilësinë e kreditit sipas referencave dhe metodave të përshkruara më poshtë.

Për obligacionet, vlerësimet e kreditit analizohen në nivel titulli ose emetuesi, dhe në momentin e blerjes së titujve. Fondet mund të mbajnë tituj vlerësimi i të cilëve ka pësuar rënie.

Për obligacionet dhe instrumentet e tregut monetar, shoqëria e menaxhimit përdor vetëm agjencitë e vlerësimit të kreditit të themeluara në Bashkimin Evropian dhe të regjistruara në përputhje me rregulloren evropiane 462/2013. Shoqëria e menaxhimit nuk mbështetet ekskluzivisht ose automatikisht mbi vlerësimet e kreditit të dhëna nga agjencitë e vlerësimit të kreditit.

Politika e investimit të qëndrueshëm dhe Integrimi i kriterëve ESG

Në nivel FCP-je

Bordi i FCP-së beson se ai duhet t'u shërbejë interesave të mbajtësve të kuotave duke ofruar zgjidhje investimi që ofrojnë performancë konkurruese afatgjatë. Angazhimi i fortë i "Eurizon Capital" në investimin e qëndrueshëm është një pjesë thelbësore e kësaj detyre. Investimi i qëndrueshëm përfshin marrjen e vendimeve më të mirëinformuara lidhur me investimin, trajtimin e çështjeve dhe dilemave të qëndrueshmërisë, duke përfshirë rreziqet përkatëse, dhe ushtrimin e ndikimit të shoqëritë e portofolit të fondit me qëllim që të kontribuojnë në një rezultat pozitiv.

Përveçse kur përcaktohet ndryshe në "Përshkrimet e fondit", të gjitha fondet janë objekt i politikës sonë të investimit të qëndrueshëm (me përjashtim të investimeve në derivativë dhe fonde nga ofruet të ndryshëm nga Eurizon Capital).

Për të qenë në përputhje me politikën e qëndrueshmërisë së "Eurizon Capital", fondet menaxhohen bazuar në integrimin e faktorëve mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes së korporatës (ESG), të cilat janë në linjë me Parimet e mbështetura nga OKB për Investimin e Përgjegjshëm.

e të dhënave personale të investitorëve, të informacionit pronësor mbi menaxhimin e fondit, ndërhyrje rregullatore dhe dëmtime të tilla të veprimtarive ose të reputacionit që mund të shkaktojnë implikime financiare për investitorët.

Rreziku i praktikave standarde Praktikave të menaxhimit të investimeve të cilat kanë funksionuar mirë në të kaluarën ose që konsiderohen si mënyra të pranuar të trajtimit të kushteve të caktuara mund të rezultojnë joefikase.

Obligacionet e kategorisë investuese (AAA/Aaa deri në BBB-/Baa3) Titujt ose emetuesit që përfaqësojnë pozicione të konsiderueshme: vlerësimet e agjencisë së kreditit dhe/ose një vlerësim i brendshëm nga shoqëria e menaxhimit.

Titujt ose emetuesit që përfaqësojnë pozicione më të vogla: vlerësimi i kreditit nga të paktën një agjenci.

Obligacionet nën kategorinë investuese (BB+/Ba1 ose më të ulët) Të gjithë titujt dhe emetuesit: vlerësimet e agjencisë së kreditit, nëse ka, në të kundërt, një vlerësim i brendshëm nga shoqëria e menaxhimit.

Kjo do të thotë se faktorët ESG merren në konsideratë në mënyrë gjithëpërfshirëse, së bashku me faktorët financiarë, dhe menaxhohen nga një perspektivë rrezik-kthim.

Përzgjedhja e aktiveve nga fondet mbështetet kryesisht në të dhënat e palëve të treta. Këto të dhëna mund të jenë të paplota, të pasakta ose të padisponueshme dhe, për rrjedhojë, ekziston rreziku që menaxheri i investimeve ta vlerësojë në mënyrë të gabuar një titull ose emetues. Fondet ushtrojnë në mënyrë aktive të drejtat e pronësisë, përmes dialogut, votimit dhe bashkëpunimit, për të krijuar vlerë afatgjatë. Fondet përdorin mbikëqyrjen si një instrument për të identifikuar rreziqet ESG dhe për të përjashtuar apo kufizuar investimet në disa sektorë ose emetues.

Eurizon Capital promovon transparencën duke ndarë informacione rreth qasjes së tij, duke raportuar mbi progresin dhe duke inkurajuar një dialog të hapur me investitorët dhe palët e tjera të interesuara.

Për më shumë informacion rreth politikës së qëndrueshmërisë së Eurozon Capital, shkoni te

eurizoncapital.com/pages/eurizon-responsibility-and-sustainability.aspx.

Në nivel fondi

Ky informacion duhet të lexohet së bashku me politikën e investimit në "Përshkrimet e Fondeve". **Përfshirja e sektorit**
Të gjitha fondet përjashtojnë emetuesit që janë të përfshirë drejtpërdrejt në prodhimin e armëve të diskutueshme ose që nxjerrin 25% ose më shumë nga të ardhurat e tyre nga aktivitetet minerare ose të prodhimit të energjisë elektrike të lidhura me qymyrin termik ose 10% ose më shumë të të ardhurave të tyre nga nxjerrja e rërës së naftës. Shembuj të armëve të kontroverse përfshijnë minat tokësore, municionet thërrmuese, uraniumin e varfëruar dhe armët bërthamore, biologjike dhe kimike. Përfshirja e sektorit të qymyrit termik nuk është i zbatueshëm në rastin e emetimeve të bonove të gjelbra, që synojnë financimin e tranzicionit energjetik dhe luftën ndaj grohjes globale.

Përfshirja e emetuesit Të gjitha fondet përjashtojnë emetuesit me klasifikimet më të ulëta të ESG (siç përcaktohet nga MSCI ESG Research) nëse profili i tyre ESG nuk arrin të përmirësohet pas procesit të fondit për të kërkuar një përmirësim të tillë përmes angazhimit me menaxhimin dhe votimin e aksioneve.

Manager Selection integration: Të gjitha fondet investojnë të paktën 70% të totalit të aktiveve të tyre neto në UCITS ose UCIs të tjera që promovojnë karakteristika mjedisore ose sociale ose një kombinim të këtyre karakteristikave (produktet e nenit 8 të SFDR) ose ndjekin objektiva investimi të qëndrueshëm (produktet e nenit 9 të SFDR), duke përfshirë UCITS ose UCIs të tjera të menaxhuara ose të kontrolluara nga Eurizon Capital S.A. ose një kompani tjetër e lidhur.

Për më shumë informacion rreth komponentëve të qasjes ESG, shkoni te eurizoncapital.com/pages/sustainability.aspx.

Kompetencat dhe kufizimet e përgjithshme të investimit

Çdo fond, dhe vetë FCP-ja, duhet të zbatojnë të gjitha ligjet dhe rregulloret e zbatueshme në BE dhe Luksemburg, si dhe qarkoret, udhëzimet dhe kërkesat e tjera të caktuara. Ky seksion paraqet, në formë tabele, kërkesat për administrimin e fondeve të ligjit të vitit 2010 (ligji kryesor që rregullon funksionimin e një UCITS) si dhe kërkesat e vendosura nga Autoriteti Evropian i Titujve dhe Tregjet (ESMA) për monitorimin dhe menaxhimin e rrezikut. Në rast të ndonjë mospërputhjeje, vetë ligji, në origjinalin frëngjisht, do të mbizotëronte ose mbi rregulloret e menaxhimit ose mbi prospektin (me rregulloret e menaxhimit që kanë përparësi ndaj prospektit).

Nëse zbulohet ndonjë shkelje e ligjit të vitit 2010 nga një fond, menaxheri i investimeve duhet të vendosë respektimin e politikave përkatëse si prioritet në tregtimin e titujve dhe vendimet e menaxhimit të investimeve, duke marrë gjithashtu parasysh interesat e mbajtësve të kuotave.

Përveçse kur specifikohet, të gjitha përqindjet dhe kufizimet zbatohen për çdo fond në mënyrë individuale, dhe të gjitha përqindjet e aktiveve maten si përqindje e totalit të aktiveve neto (duke përfshirë mjetet monetare).

Aktivitet, teknikat dhe transaksionet e lejuara

Tabela e mëposhtme përshkruan se çfarë është e lejueshme për çdo UCITS. Fondet mund të vendosin kufizime më të rrepta, në një mënyrë apo një tjetër, bazuar në objektivat dhe politikat e tyre të investimit. Mënyra se si një fond përdor aktivitet, teknikat ose transaksionet duhet të jetë në përputhje me politikat dhe kufizimet e tij të investimit.

Asnjë fond nuk mund të blejë aktive që shoqërohen me përgjegjësi të pakufizuar, të nënshkruajë tituj të emetuesve të tjerë (përveçse nëse mund të konsiderohet se e bën diçka të tillë gjatë veprimtarisë së shitjes së titujve të fondit), ose të lëshojë garanci apo të drejta të tjera për të nënshkruar për kuotat e tyre.

Letrat me vlerë / Transaksionet	Kërkesat	Përdorimi nga fondet	
1. Titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut monetar	Duhet të jenë të listuar ose të tregtohen në një bursë zyrtare në një shtet të kualifikueshëm ose në një treg të rregulluar në një shtet të kualifikueshëm (një treg që funksionon rregullisht, është i njohur dhe i hapur për publikun).	Titujt e emtuar rishtazi duhet të përfshijnë në kushtet e emetimit një angazhim për të aplikuar për listimin e tyre zyrtar në një treg të rregulluar dhe miratimi i këtij aplikimi duhet të merret brenda 12 muajsh nga emetimi.	Gjerësisht i përdorur. Përdorimi material përshkruhet në "Përshkrimin e Fondeve".
2. Instrumentet e tregut monetar që nuk përmbushin kërkesat në rreshtin 1	Duhet t'u nënshtrohen (në nivel titujsh ose emetuesi) rregulloreve që kanë si synim të mbrojnë investitorët dhe kursimet, si dhe duhet të përmbushin një nga kriteret në vijim: <ul style="list-style-type: none"> të emetohen ose garantohen nga një autoritet qendror, rajonal ose vendor, ose nga një bankë qendrore në një shtet anëtar të BE-së, Banka Qendrore Evropiane, Banka Evropiane e Investimeve, BE-ja, një organ publik ndërkombëtar në të cilin bën pjesë të paktën një shtet anëtar i BE-së, një komb sovran ose një shtet anëtar i një federate të emetohen nga një sipërmarrje, titujt e së cilës kualifikohen sipas rreshtit 1 (me përjashtim të titujve të emtuar rishtazi) të emetohen ose garantohen nga një institucion që është objekt dhe vepron në përputhje me rregullat e mbikëqyrjes së kujdesshme të BE-së ose me rregulla të tjera që konsiderohen të paktën po aq të repta nga CSSF 	Mund të kualifikohen edhe nëse emetuesi bën pjesë në një kategori të miratuar nga CSSF, është objekt i masave për mbrojtjen e investitorit, të cilat janë të barasvlershme me ato të përshkruara në të majtë dhe përmbushin një nga kriteret në vijim: <ul style="list-style-type: none"> të jenë emtuar nga një shoqëri me kapital dhe rezerva prej të paktën 10 milionë euro, e cila i publikon llogaritë e saj vjetore në përputhje me Direktivën 2013/34/BE të jenë emtuar nga një subjekt i dedikuar për financimin e një grupi shoqërorish, nga të cilat të paktën njëra është e listuar publikisht të jenë emtuar nga një subjekt i dedikuar për financimin e mjeteve të titullimit, të cilat përfitojnë nga një linjë likuiditeti bankar 	Gjerësisht i përdorur. Përdorimi material përshkruhet në "Përshkrimin e Fondeve".
3. Titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut monetar që nuk përmbushin kërkesat në rreshtat 1 dhe 2	<ul style="list-style-type: none"> Të kufizuara në 10% të aktiveve të fondit. 		Çdo përdorim që ka gjasa të krijojë rrezik material është përshkruar në "Fund Descriptions".
4. Kuotat e SIKTT-ve ose SIK-ve të tjera që nuk janë të lidhura me FCP-në*	Duhet të ketë kufizime në aktet statutoare për të mos investuar më shumë se 10% të aktiveve në SIKTT ose SIK të tjera. Nëse investimi i synuar është një "UCI tjetër", ai duhet të bëjë të gjitha sa vijon: <ul style="list-style-type: none"> të investojë në investime të lejuara nga SIKTT të jetë i autorizuar nga një shtet anëtar i BE-së ose nga një shtet, i cili konsiderohet nga CSSF se ka ligje të barasvlershme mbi mbikëqyrjen, si dhe të garantohet bashkëpunim i përshtatshëm ndërmjet autoriteteve 	<ul style="list-style-type: none"> të publikojë raporte vjetore dhe gjashtëmuajore që mundësojnë vlerësimin e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe veprimtarive gjatë periudhës së raportimit t'i ofrojë investitorit mbrojtje të barasvlershme me ato të SIKTT-së, në veçanti për sa i përket rregullave mbi ndarjen e aktiveve, huamarrjen, pambuluar 	Çdo përdorim që tejkalon 10% të aktiveve të fondit ose që ka gjasa të krijojë rrezik material është paraqitur në "Fund Descriptions". Tarifat totale vjetore të menaxhimit të fondeve dhe UCITS-ve/UCI-ve të tjera mund të jenë deri në 2.5%. Çdo rabat i marrë nga SIKTT/SIK të tjera bazë i rimbursohet plotësisht fondit.

Letrat me vlerë / Transaksionet	Kërkesat	Përdorimi nga fondet
5. Kuotat e SIKTT-ve ose SIK-ve të tjera që janë të lidhura me FCP-në*	Duhet të plotësojë të gjitha kërkesat në rreshtin 4. Raporti vjetor i FCP-së duhet të përcaktojë tarifën totale vjetore të menaxhimit dhe këshillimit, të cilat i janë ngarkuar fondit dhe SIKTT-së/SIK-ve të tjera në të cilat ka investuar fondi gjatë periudhës përkatëse.	UCITS/ UCI-ja tjetër nuk mund t'i ngarkojë një fondi asnjë tarifë për abonimin ose shlyerjen e kuotave. Njësoj si rreshti 4, tarifën vjetore të menaxhimit dhe këshillimit të aplikuar nga çdo UCITS/UCI i lidhur i kthehen plotësisht fondit. Mund të përfaqësojë deri në 100% të aktiveve të fondit.
6. Kuotat e fondeve të tjera të FCP-së	Duhet të plotësojë të gjitha kërkesat në rreshtat 4 dhe 5. Fondi i synuar nuk duhet të lejohet të investojë, në total, më shumë se 10% të aktiveve të tij në UCITS/UCIs. Nga ana tjetër, fondi i synuar nuk mund të investojë në fondin blerës (pronësi e ndërsjellë).	Fondi blerës heq dorë nga të gjitha të drejtat e votës që përkojnë me aksionet e fondit të synuar që blen. Aksionet nuk llogariten si aktive të fondit blerës për qëllime të pragjeve minimale të aktiveve të vendosura nga ligji i 2010-ës. Njësoj si rreshtat 4 dhe 5. Vini re se asnjë fond nuk ngarkohet me tarifa vjetore për menaxhim ose këshillim nga asnjë fond tjetër.
7. Pasuritë e paluajtshme dhe mallrat, duke përfshirë metalet e çmuara	Ndalohet pronësia e drejtpërdrejtë e mallrave ose e certifikatave që i përfaqësojnë ato. Ekspozimi i investimit lejohet vetëm në mënyrë të tërthortë përmes aktiveve, teknikave dhe transaksioneve të lejuara sipas ligjit të vitit 2010. Treguesit financiarë të përdorur për të arritur ekspozim ndaj mallrave përmes instrumenteve derivative financiare janë në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 9 të Rregullores "Grand-Ducal" të datës 8 shkurt 2008.	Ndalohet pronësia e drejtpërdrejtë e pasurive të paluajtshme ose e pasurive të tjera të trupëzuara. Çdo përdorim që mund të krijojë rrezik material shpалoset në "Përshkrimet e Fondit". Blerjet e drejtpërdrejta të pasurive të paluajtshme ose të pronave të prekshme nuk kanë gjasa.
8. Depozitat në institucionet e kreditit	Duhet të jetë i ripagueshëm ose i tërheqshëm sipas kërkesës dhe çdo datë maturimi duhet të jetë jo më shumë se 12 muaj në të ardhmen.	Institucionet e kreditit duhet të kenë një seli të regjistruar në një shtet anëtar të BE-së ose, në të kundërt, të jenë objekt i rregullave të mbikëqyrjes së kujdesshme që konsiderohen nga CSSF të paktën po aq të rrepta sa rregullat e BE-së. Zakonisht përdoret nga të gjitha fondet.
9. Aktivet likuide	Të kufizuara në maksimumi 20% në kushtet e zakonshme të tregu dhe në depozitat pa afat. Ky kufi mund të shkelet në kushte jashtëzakonisht të pafavorshme të tregut dhe në rastet kur një shkelje e tillë justifikohet duke mbajtur parasysh interesat e investitorëve.	Të përdorura gjerësisht nga të gjitha fondet dhe mund të përdoren gjerësisht për qëllime të përkohshme mbrojtjeje.
10. Derivatet dhe instrumentet ekuivalente të shlyera me para <i>Shih gjithashtu "Si i përdorin fondet instrumentet dhe teknikat" në faqen 17</i>	Aktivët bazë duhet të jenë ato të përshkruara në rreshtat 1, 2, 4, 5, 6 dhe 8 ose duhet të jenë tregues financiarë (në përputhje me nenin 9 të Rregullores "Grand-Ducal" të datës 8 shkurt 2008), norma interesi, kurse këmbimi ose monedha në përputhje me objektivat dhe politikat e fondit. Çdo përdorim duhet të identifikohet në mënyrë të përshtatshme nga procesi i menaxhimit të rrezikut i përshkruar në seksionin e mëposhtëm "Menaxhimi dhe monitorimi i rrezikut të derivativëve".	Derivatet mbi banak duhet të përmbushin të gjitha kriteret e mëposhtme: • të jenë objekt i vlerësimeve ditore të pavarura të besueshme dhe të verifikueshme • të mund të shiten, likuidohen ose mbyllen në çdo kohë nga një transaksion kompensues në vlerën e tyre të drejtë, me iniciativën e FCP-së • të jenë të kundërpalëve të cilat janë institucione që i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme dhe që i përkasin kategorive të miratuara nga CSSF Përdorimi material përshkruhet në "Përshkrimin e Fondeve".

Letrat me vlerë / Transaksionet	Kërkesat	Përdorimi nga fondet	
<p>11. Huadhënia e titujve, marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjellta të riblerjes</p> <p><i>Shih gjithashtu "Si i përdorin fondet instrumentet dhe teknikat" në faqen 17</i></p>	<p>Duhet të përdoren vetëm për menaxhimin efikas të portofolit.</p> <p>Volumi i transaksioneve nuk duhet të ndikojë në zbatimin e politikës së investimit të fondit apo në aftësinë e tij për të realizuar riblerjet. Përmes huadhënies së titujve dhe transaksioneve të riblerjes, fondi duhet të garantojë se ka mjaftueshëm aktive për të realizuar transaksionin.</p> <p>Të gjitha kundërpalët duhet t'u nënshtrohen rregullave të mbikëqyrjes së kujdesshme të BE-së ose rregullave që konsiderohen të paktën po aq të rrepta nga CSSF.</p> <p>Një fond mund të jap hua tituj:</p> <ul style="list-style-type: none"> • drejtpërdrejt te një kundërpalë • përmes një sistemi huadhënieje të organizuar nga një institucion financiar i specializuar në këtë lloj transaksioni • përmes një sistemi të standardizuar huadhënieje të organizuar nga një institucion i njohur kleringu 	<p>Për çdo transaksion, fondi duhet të marrë dhe të mbajë kolateral, i cili është të paktën i barasvlershëm, në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së transaksioneve, me vlerën e plotë aktuale të titujve të huazuar.</p> <p>Gjatë kohëzgjatjes së një kontrate riblerjeje, fondi nuk mund të shesë letrat me vlerë që janë objekt i kontratës, qoftë para se të jetë ushtruar e drejta e riblerjes së këtyre titujve nga ana e kundërpalës ose para skadimit të afatit të riblerjes.</p> <p>Megjithatë, fondi duhet të ketë të drejtën të ndërpresë cilindo nga këto transaksione në çdo kohë dhe të tërheqë titujt që janë dhënë hua ose janë objekt i marrëveshjes së riblerjes.</p> <p>FCP nuk mund të japë ose të garantojë asnjë lloj tjetër huaje për një palë të tretë.</p>	<p>Përdorimi material përshkruhet në "Përshkrimin e Fondeve". Aktualisht, asnjë fond nuk synon të përdorë huadhënien e titujve.</p>
<p>12. Huamarrja</p>	<p>FCP nuk lejohet të marrë hua në parim, përveç nëse është në baza të përkohshme dhe nuk përfaqëson më shumë se 10% të aktiveve të fondit.</p>	<p>Megjithatë, FCP mund të sigurojë valutë të huaj me anë të huave back-to-back.</p>	<p>Aktualisht, asnjë fond nuk synon të marrë hua nga bankat.</p>
<p>13. Ekspozimi i shkurtër</p>	<p>Ndalohen shitjet e shkurtra të drejtpërdrejta.</p>	<p>Pozicionet e shkurtra mund të sigurohen vetëm në mënyrë indirekte, nëpërmjet derivateve.</p>	<p>Çdo përdorim që ka gjasa të krijojë rrezik material është përshkruar në "Fund Descriptions".</p>

* Mund të përfshijë fonde të tregtuara në bursë (ETF). Një SIKTT ose një SIK tjetër konsiderohet se është e lidhur me FCP-në nëse të dyja menaxhohen ose kontrollohen nga e njëjta shoqëri menaxhimi ose nga një filial tjetër i shoqërisë së menaxhimit.

Kërkesat për diversifikimin

Për të garantuar diversifikimin, një fond nuk mund të investojë më tepër se një sasi të caktuar të aktiveve të tij në një emetues, siç përcaktohet më poshtë. Këto rregulla për diversifikimin nuk zbatohen gjatë 6 muajve të parë të veprimtarisë së një fondi, megjithatë fondi duhet të respektojë parimin e shpërndarjes së rrezikut.

Për qëllime të kësaj tablele, shoqëritë që ndajnë llogari të konsoliduara (pavarësisht nëse janë në përputhje me Direktivën 83/349/KEE ose me rregullat e njohura ndërkombëtarisht) konsiderohen si një emetues i vetëm. Kufizimet në përqindje, të paraqitura në ndarjet vertikale në qendër të tabelës, tregojnë investimin total maksimal në një emetues të vetëm për të gjitha rreshtat.

Investimi/ekspozimi maksimal, i shprehur si % e aktiveve të fondit

Kategoria e titujve	Në një emetues të vetëm	Në total	Tjetër	Përfshirjet
A. Titujt e transferueshëm dhe instrumentet e tregut monetar të emetuara ose të garantuara nga një komb sovran, një autoritet publik kombëtar i BE-së ose një organ publik ndërkombëtar në të cilin bën pjesë një ose disa shtete anëtare të BE-së.	35%			<p>Një fond mund të investojë deri në 100% të aktiveve të tij në një emetues të vetëm nëse investon në përputhje me parimin e përhapjes së rrezikut dhe kur plotëson të gjitha kriteret e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> investon në të paktën 6 emetime të ndryshme nuk investon më tepër se 30% në një emetim të vetëm titujt janë emetuar nga një shtet anëtar i BE-së, autoritetet ose agjencitë e tij lokale, një shtet anëtar i OECD ose i G20, Singapori ose nga një organ publik ndërkombëtar të cilit i përket një ose më shumë shtete anëtare të BE-së. <p>Përfshirja e përshkruar për rreshtin C vlen edhe për këtë rresht.</p>
B. Obligacionet e emetuara nga një institucion krediti, i cili e ka selinë e regjistruar në një shtet anëtar të BE-së dhe i cili, sipas ligjit, i nënshtrohet mbikëqyrjes së veçantë publike, të planifikuar për të mbrojtur mbajtësit e obligacioneve*.	25%		80% në çdo emetues në obligacionet e të cilit një fond ka investuar më shumë se 5% të aktiveve.	
C. Çdo titull i transferueshëm dhe instrument i tregut monetar, me përjashtim të atyre të përshkruar në rreshtat A dhe B më sipër.	10%	35%	20% në tituj të transferueshëm dhe instrumente të tregut monetar brenda të njëjtit grup. 40% në total, në tërësinë e emetuesve ku një fond ka investuar më tepër se 5% të aktiveve të tij (nuk përfshin depozitat dhe kontratat e derivativëve mbi banak me institucionet financiare që i nënshtrohen mbikëqyrjes së kujdesshme dhe titujt e paraqitur në rreshtat A dhe B).	Për sa i përket fondeve që ndjekin indeksin, kufizimi prej 10% rritet deri në 20% në rastin e një fondi të publikuar dhe mjaftueshëm të diversifikuar, i cili është i përshatshëm si një indeks referencë për tregun e tij dhe është i njohur nga CSSF. Kufizimi prej 20% rritet deri në 35% (por vetëm për një emetues) në kushte të jashtëzakonshme të tregut, si p.sh. kur titulli dominon ndjeshëm në tregun e rregulluar ku tregtohet.
D. Depozitat në institucionet e kreditit.	20%	20%		
E. Derivatët mbi banak me një kundërpalë që është një institucion krediti, siç përcaktohet në rreshtin 8 më sipër (tabela e parë në këtë seksion).	Ekspozimi maksimal 10% (kombinim i derivativëve mbi banak me teknika efikase të menaxhimit të portofolit)			
F. Derivatët mbi banak me një kundërpalë tjetër.	Ekspozimi maksimal 5%			

Kategoria e titujve	Në një emetues të vetëm	Në total	Tjetër	Përfshirjet
G. Kuotat e SIKTT-së ose SIK-ve, siç përcaktohet në rreshtat 4 dhe 5 më sipër (tabela e parë në këtë seksion).	<p>Në rast se nuk ka një deklaratë specifike në objektivin dhe politikën e fondit, 10% në një ose disa SIKTT ose SIK të tjera.</p> <p>Në rast se ka një deklaratë specifike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 20% në një çdo SIKTT ose SIK • 30% në total në të gjitha SIK-të e ndryshme nga SIKTT • 100% në total në të gjitha SIKTT-të 		<p>Fondet e synuara të një strukture ombrellë, aktivet dhe pasivet e së cilës janë të ndara, konsiderohen si një SIKTT e veçantë ose si SIK tjetër.</p> <p>Aktivët e mbajtura nga SIKTT ose nga SIK të tjera nuk merren në konsideratë për qëllime të pajtueshmërisë me rreshtat A - F të kësaj table.</p>	

* Gjithashtu, këto obligacione duhet të investojnë të gjitha shumat që krijohen nga emetimi në aktive të cilat, gjatë jetëgjatësisë së obligacioneve, janë në gjendje të mbulojnë të gjitha pretendimet që lidhen me obligacionet dhe të cilat, në rastin e falimentimit të emetuesit, do të përdoren me prioritet për të rimbursuar principalin dhe interesin e akumuluar.

Kufizimet mbi përqendrimin e pronësisë

Këto kufizime synojnë të mbrojnë FCP-në ose një fond nga rreziqet që mund të lindin (ndaj vetë fondit ose ndaj një emetuesi) nëse ai do të zotëronte një përqindje të konsiderueshme të një titulli ose emetuesi të caktuar. Nuk është e nevojshme që një fond të zbatojë kufizimet e investimit të përshkruara më poshtë në rastet kur ushtron të drejtat e nënshkrimit që lidhen me tituj të transferueshëm ose instrumente të tregut monetar të cilat janë pjesë përbërëse e aktiveve të tij, për sa kohë që çdo shkelje rezultuese e kufizimeve të investimit korrigjohet sipas përshkrimit në hyrjen e seksionit "Kompetencat dhe kufizimet e përgjithshme të investimit".

Kategoria e titujve	Pronësia maksimale, e shprehur si % e vlerës totale të titujve të emetuar	
Titujt që mbartin të drejtë vote	Më pak seç do t'i mundësonte FFP-së të ushtronte ndikim të konsiderueshëm mbi menaxhimin e një emetuesi	<p>Këto vlera kufi mund të mos merren parasysh në momentin e blerjes, nëse në atë kohë nuk mund të përlllogaritet shuma bruto e obligacioneve apo e instrumenteve të tregut monetar, ose shuma neto e instrumenteve të emetuara.</p> <p>Këto rregulla nuk zbatohen për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • titujt të përshkruara në rreshtin A të tabelës më poshtë • aksionet e një kompanie jashtë BE-së që investon kryesisht në vendin e saj dhe përfaqëson të vetmen mënyrë për të investuar në atë vend në përputhje me Ligjin e 2010 • blerjet ose riblerjet e aksioneve të filialeve që ofrojnë menaxhim, këshillim ose marketing në vendin e tyre, kur bëhen si një mënyrë për të kryer transaksione për mbajtësit e njësisë të FCP në përputhje me Ligjin e 2010
Titujt pa të drejtë vote të çdo emetuesi	10%	
Titujt e borxhit të çdo emetuesi	10%	
Titujt e tregut të parasë të çdo emetuesi	10%	
Kuotat e çdo nënfondi të një UCITS ombrellë ose UCI	25%	

Menaxhimi dhe monitorimi i rrezikut global

Shoqëria e menaxhimit përdor një proces të menaxhimit të rrezikut, i cili është miratuar dhe mbikëqyret nga bordi i saj, për të monitoruar dhe vlerësuar në çdo moment profilin e përgjithshëm të rrezikut të secilit fond, nga investimi i drejtpërdrejtë, derivativët, teknikat, kolaterali dhe të gjitha burimet e tjera. Vlerësimet e ekspozimit global përlllogariten çdo ditë tregtimi (pavarësisht nëse fondi përlllogarit një NAV për atë ditë), dhe përfshijnë një sërë faktorësh, duke përfshirë mbulimin për detyrimet potenciale të krijuara nga pozicionet derivative, rrezikun e kundërpalës, lëvizjet e parashikueshme të tregut dhe kohën e disponueshme për likuidimin e titujve.

Derivativët e integruar në tituj të transferueshëm ose në instrumente të tregut monetar konsiderohen si derivativë të mbajtur nga fondi dhe çdo ekspozim ndaj titujve të transferueshëm ose instrumenteve të tregut monetar të përfuara përmes derivativëve (me përjashtim të disa derivativëve të caktuar të bazuar në indeks) konsiderohet si investim në këto tituj ose instrumente.

Qasjet e monitorimit të rrezikut Ekzistojnë 3 qasje kryesore të matjes së rrezikut: qasja e angazhimit dhe 2 format e vlerës në rrezik (VaR), VaR absolute dhe VaR relative. Këto qasje janë përshkruar më poshtë dhe qasja që përdor çdo fond është identifikuar në "Fund Descriptions". Shoqëria e menaxhimit zgjedh qasjen që do të përdorë një fond bazuar në politikën dhe strategjinë e tij të investimit.

Qasja	Përshkrimi
Vlera absolute në rrezik (VaR absolute)	Fondi kërkon të llogarisë humbjen potenciale maksimale që mund të pësojë nga rreziku i tregut brenda një muaji (20 ditë tregtimi), në kushte të zakonshme të tregut. Përlllogaritja bazohet në 12 muajt e fundit (250 ditë pune) të performancës së fondit, dhe kërkon që, në 99% të kohës, skenari më negativ i fondit të mos tejkalojë një rënie prej 20% në vlerën neto të aktiveve.
Vlera relative në rrezik (VaR relative)	Njësoj si VaR absolute, vetëm se në këtë rast vlera e skenarit më negativ përlllogarit se sa më e ulët është performanca e fondit krahasuar me një indeks referencë të caktuar. VaR e fondit nuk mund të jetë mbi 200% më e lartë se VaR e indeksit referencë.

Qasja	Përshkrimi
Angazhimi	Fondi përllogarit ekspozimin e tij global duke marrë në konsideratë vlerën e tregut të një pozicioni ekuivalent në aktivin bazë ose vlerën nocionale të derivativit, sipas rastit. Kjo i mundëson fondit që të reduktojë ekspozimin global duke marrë në konsideratë efektin e pozicioneve mbrojtëse ose kompensuese. Prandaj, disa lloje të transaksioneve pa rrezik, transaksione pa levë dhe shkëmbimeve swap pa levë nuk përfshihen në llogaritje. Një fond që përdor këtë qasje duhet të garantojë se ekspozimi i përgjithshëm në treg të mos tejkalojë 210% të totalit të aktiveve (100% nga investimi i drejtpërdrejtë, 100% nga derivativët dhe 10% nga huamarrjet).

Efekt i levës bruto Çdo fond që përdor një qasje VaR duhet të llogarisë gjithashtu nivelin e parashikuar të efektit të levës bruto, i cili përcaktohet në "Fund Descriptions". Efekti i parashikuar i levës për një fond është një tregues i përgjithshëm dhe jo një kufi rregullator; herë pas here, efekti real i levës mund të tejkalojë nivelin e parashikuar. Megjithatë, përdorimi i derivativëve do të mbetet në përputhje me objektivin e investimit të fondit, me politikën e tij të investimit dhe profilin e rrezikut dhe do të jetë në përputhje me vlerën kufi të VaR.

Efekt i levës bruto është një matës i levës financiare të krijuar nga përdorimi i përgjithshëm i derivativëve dhe nga çdo instrument ose teknikë e përdorur për menaxhimin efikas të portofolit. Ai llogaritet si "shuma e vlerave nocionale" (ekspozimi i të gjithë derivativëve, pa i trajtuar pozicionet e kundërta sikur kompensojnë njëra tjetrën) dhe përfshin portofolin e fondit. Duke qenë se kjo llogaritje nuk merr në konsideratë as ndjeshmërinë ndaj lëvizjeve të tregut dhe as faktin nëse një derivativ po rrit apo zvogëlon rrezikun e përgjithshëm të fondit, ajo mund të mos përfaqësojë nivelin real të rrezikut të investimit të një fondi.

Mënyra e përdorimit të instrumenteve dhe teknikave nga fondet

Kuadri ligjor dhe rregullator

Një fond mund të përdorë instrumentet dhe teknikat në vijim për qëllime të menaxhimit efikas të fondit (siç përkrahur me poshtë) në përputhje me ligjin e vitit 2010, Direktivën për SIKTT, Rregulloren "Grand Ducal" të datës 8 shkurt 2008, Qarkoret 08/356 dhe 14/592 të CSSF, Udhëzimin 14/937 të ESMA, Rregulloren (BE) 2015/2365 "Për transaksionet e financimit përmes titujve (SFT)", si dhe çdo ligj dhe rregullore në fuqi. Përdorimi i çdo fondi nuk duhet të rrisë profilin e tij të rrezikut përtej nivelit që do të ekzistonte pa një përdorim të tillë.

Rreziqet e lidhura me instrumentet dhe teknikat janë përshkruar në "Risk Descriptions". Rreziqet kryesore janë rreziku i derivativëve (që lidhet vetëm me derivativët), rreziku i kundërpalës (që përfshin rrezikun e ruajtjes dhe të kolateralit), rrezikun e levës financiare, rrezikun e likuiditetit, rrezikun operacional dhe seksionin mbi konfliktin e interesit që jepet në përshkrimin e rrezikut të fondit të investimeve.

Derivativët që mund të përdorë fondet

Një derivativ është një kontratë financiare, vlera e së cilës varet nga performanca e një ose disa aktiveve referencë (si p.sh. një titull ose një shportë titujsh, një indeks ose normë interesi).

Në vijim jepen derivativët e përdorur më gjerësisht nga fondet (kjo listë nuk është detyruesisht shteruese):

Derivativët bazë – mund të përdoren nga çdo fond, në përputhje me politikën e tij të investimit

- kontratat financiare "future", si p.sh. ato mbi normat e interesit, indeksat ose monedhat
- opsionet, si p.sh. opsionet mbi titujt e kapitalit, indeksat (duke përfshirë indeksat e mallrave), obligacionet ose monedhat dhe mbi kontratat "future"
- të drejtat dhe garancitë
- kontratat e ardhshme "forward", si p.sh. kontratat e këmbimit valutor
- swaps (kontratat ku dy palë shkëmbejnë kthimet nga dy aktive të ndryshme referencë, të tilla si shkëmbimet e këmbimit valutor ose swaps të normave të interesit dhe këmbimet në shporta të aksioneve, por NUK përfshijnë kthimin total, credit default, indeksin e mallrave, luhatshmërinë ose këmbimet swaps të mospërputhjes
- derivativët e kredive, si p.sh. swap-et e rrezikut të mosshlyerjes së kredisë, ose CDS-të (kontrata në të cilat një palë merr një tarifë nga kundërpala dhe në këmbim bie dakord se, në rast falimentimi, paafësie paguese ose të një ngjarjeje tjetër të mosshlyerjes së kredisë, do të bëjë pagesa për kundërpalën me qëllim mbulimin e humbjeve të kësaj të fundit)

Derivativë shtesë – çdo synim për përdorimin e tyre do të paraqitet në "Përshkrimin e Fondeve"

- derivativët financiarë të strukturuar, të tillë si titujt të lidhura me kredinë dhe kapitalin
- swaps të kthimit total, ose TRS (transaksion në të cilin njëra palë kryen pagesa bazuar në një normë fikse ose të ndryshueshme ndaj palës tjetër, e cila transferon performancën totale ekonomike, duke përfshirë të ardhurat nga interesi dhe tarifat, fitimet dhe humbjet nga lëvizjet e çmimeve dhe humbjet e kredisë, të një detyrimi referencë, të tillë si një kapital, obligacion ose indeks); kjo kategori përfshin kontratat për diferencë (CFD)

Zakonisht, kontratat "future" tregtohen në bursë. Në përgjithësi, të gjitha llojet e derivativëve të tjerë janë OTC (pra tregtohen mbi banak, çka do të thotë se në fakt janë kontrata private ndërmjet një fondi dhe një kundërpale).

TRS-të mund të jenë të financuara ose të pafinancuara (me ose pa pagesë paradhënie). Aktivet, ndaj të cilave do të fitohet ekspozimi, mund të përfshijnë tituj dhe tituj të lidhur me kapitalin neto, borxhin dhe instrumentet e lidhura me borxhin dhe indeksat financiarë dhe përbërësit e tyre, sipas politikës së investimit të fondit.

Një fond i autorizuar për përdorimin e TRS-ve i përdor ato përkohësisht dhe pavarësisht kushteve specifike të tregut që mund të shfaqen.

TRS-të përdoren kryesisht për zbatimin e komponentëve të strategjisë së investimit që synojnë rritjen e kthimeve që mund të arrihen vetëm përmes derivativëve, si p.sh. ekspozimi i shkurtër në shoqëri të caktuara. TRS-të mund të përdoren gjithashtu për zbatimin e elementëve të strategjisë së investimit që synojnë menaxhimin efikas të portofolit, si p.sh. arritja e një ekspozimi të gjatë kosto-efektiv. Përqindja e TRS e përdorur duhet të mbetet afër nivelit të pritshëm përkatës të treguar në "Përshkrimet e Fondeve". Për momentin, fondet nuk do të hyjnë në transaksione TRS.

Për sa i përket derivativëve të lidhur me indeksin, ofruesi i indeksit përcakton shpeshësinë e ribalancimit dhe nuk ka kosto për fondin përkatës kur ribalancohet vetë indeksi.

Arsyet e përdorimit të derivativëve nga fondet

Një fond mund t'i përdorë derivativët për cilindo prej qëllimeve në vijim, në përputhje me objektivin dhe politikën e tij, siç përkrahur në "Fund Descriptions".

Mbrojtja Mbrojtja nënkupton marrjen e një pozicioni në treg që është në drejtim të kundërt dhe nuk ka vlerë më të madhe se pozicioni i krijuar nga investimet e tjera të fondit, me qëllim reduktimin ose eliminimin e ekspozimit ndaj luhatjeve të çmimit ose faktorëve të caktuar që kontribuojnë në këto luhatje.

- Mbrojtja nga kredia** Realizohet zakonisht duke përdorur swap-et e rrezikut të mosshlyerjes së kredisë. Objektivi është mbrojtja ndaj rrezikut të mosshlyerjes së kredisë. Këtu përfshihet blerja ose shitja e mbrojtjes ndaj rreziqeve të

aktiveve ose emetuesve specifike, si dhe mbrojtja e tërthortë (marrja e një pozicioni të kundërt në një investim tjetër, i cili ka gjasa të sillet në mënyrë të ngjashme me pozicionin që po mbrohet).

- **Mbrojtja nga luhatjet e kursit të këmbimit** Realizohet zakonisht duke përdorur kontratat "forward" të këmbimit valutë. Objektivi është mbrojtja ndaj rrezikut të kursit të këmbimit. Kjo mund të realizohet në nivel fondi dhe, me kuotat H, në nivelin e një kategorie kuotash. Të gjitha mbrojtjet nga luhatjet e kursit të këmbimit duhet të përfshijnë monedha që janë pjesë e indeksit referencë të fondit ose që janë në përputhje me objektivat dhe politikat e tij. Kur një fond mban aktive të shprehura në disa monedha, ai mund të mos japë mbrojtje ndaj monedhave që përfaqësojnë pjesë të vogla të aktiveve ose për të cilat mbrojtja është joekonomike ose jo e mundur. Një fond mund të angazhohet në:
 - mbrojtje të drejtpërdrejtë (e njëjta monedhë, pozicioni i kundërt)
 - mbrojtje të kryqëzuar (ulja e ekspozimit ndaj një monedhe duke rritur ekspozimin ndaj një tjetre, duke mbajtur të pandryshuar ekspozimin neto ndaj monedhës bazë), kur një mbrojtje e tillë ofron një mundësi efikase për të arritur ekspozimet e dëshiruara
 - mbrojtje të tërthortë (marrja e një pozicioni të kundërt në një monedhë tjetër që konsiderohet se ka gjasa të sillet në mënyrë të ngjashme me monedhën bazë).
 - mbrojtje paraprirëse (marrja e një pozicioni mbrojtës për t'i paraprirë një ekspozimi që parashikohet të rritet si rezultat i një investimi të planifikuar ose i një ngjarjeje tjetër)
- **Mbrojtja nga kohëzgjatja** Realizohet zakonisht duke përdorur swap-et, opsionet swap ose kontratat "future" të normës së interesit. Objektivi është të synojë të ulë ekspozimin ndaj ndryshimeve të normës së obligacioneve me maturim afatgjatë. Mbrojtja nga kohëzgjatja mund të realizohet vetëm në nivel fondi.
- **Mbrojtja nga çmimi** Realizohet zakonisht duke përdorur opsione mbi indekset (konkretisht, duke shitur një opsion blerjeje ose duke blerë një opsion shitjeje). Në përgjithësi, përdorimi është i kufizuar në situatat kur nuk ka korrelacion të mjaftueshëm ndërmjet përbërjes ose performancës së indeksit dhe asaj të fondit. Objektivi është mbrojtja nga luhatjet e vlerës së tregut të një pozicioni.
- **Mbrojtja nga norma e interesit** Realizohet zakonisht duke përdorur kontratat "future" dhe "swap" të normës së interesit, duke shitur opsione blerjeje mbi normat e interesit ose duke blerë opsione shitjeje mbi normat e interesit. Objektivi është të menaxhohet rreziku i normës së interesit.

Ekspozimi i investimit Një fond mund të përdorë çdo derivativ të lejueshëm për të arritur ekspozim ndaj aktiveve të lejuara, veçanërisht kur investimi i drejtpërdrejtë është joefikas ose i pamundur.

Efekt i levës financiare Një fond mund të përdorë çdo derivativ të lejueshëm për të rritur ekspozimin total të investimit të tij përtej nivelit që do të mund të arrihej përmes investimit të drejtpërdrejtë. Zakonisht, leva financiare rrit luhatshmërinë e fondit.

Menaxhimi efikas i portofolit Reduktimi i rreziqeve ose kostove ose gjenerimi i kapitalit ose të ardhurave shtesë.

Instrumentet dhe teknikat që mund të përdorë fondi

Një fond mund të përdorë instrumentet dhe teknikat në vijim për çdo titull që zotëron, por vetëm për qëllime të menaxhimit efikas të fondit (siç përshkruhet më sipër).

Huadhënia e titujve Aktualisht nuk përdoret nga fondet Sipas këtyre transaksioneve, një fond u jep hua aktiveve (të tilla si obligacione dhe aksione) huamarrësve të kualifikuar, qoftë për një periudhë të caktuar ose të kthyeshme sipas kërkesës. Në këmbim, huamarrësi paguan një tarifë huaje plus çdo të ardhur nga titujt, dhe vendos kolateral që përmbush standardet e përshkruara në prospekt.

Një fond i autorizuar për përdorimin e huadhënies së titujve e përdor këtë instrument në mënyrë të vazhdueshme dhe pavarësisht kushteve specifike të tregut që mund të shfaqen, dhe ka si objektivi gjenerimin e të ardhurave shtesë. Përqindja e aktiveve të huazuara duhet të mbetet pranë nivelit të parashikuar të paraqitur në "Përshkrimet e fondit".

Ai kufizon huadhënien e titujve në 90% të një aktivi të caktuar, dhe jep hua vetëm kur merr garanci nga një institucion financiar me vlerësim të lartë ose garanci në mjete monetare ose në tituj të emetuar nga qeveritë e OECD-së, si dhe kur huaja është për më tepër se 30 ditë.

Transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes dhe marrëveshjeve të anasjella të riblerjes Në kuadër të këtyre transaksioneve, një fond blen ose shet tituj të një kundërpalë, kundrejt pagesës, dhe ka të drejtën ose detyrimin të rishesë ose të riblejë (përkatesisht) titujt në një datë të mëvonshme dhe me një çmim specifik (dhe zakonisht më të lartë).

Një fond i autorizuar për përdorimin e transaksioneve të marrëveshjeve të riblerjes dhe marrëveshjeve të anasjella të riblerjes i përdor ato në mënyrë të vazhdueshme dhe pavarësisht kushteve specifike të tregut që mund të shfaqen, dhe ka si objektivi gjenerimin e të ardhurave shtesë. Për momentin, fondet nuk do të bëhen pjesë e transaksioneve të riblerjes dhe të riblerjes së anasjellte.

Vetëm aktivet në vijim mund të përdoren për marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes:

- certifikatat afatshkurtra të depozitave bankare ose instrumentet e tregut monetar
- aksionet ose njësitë e SIK-ve të tregut monetar të kategorisë investuese
- obligacionet me likuiditet të përshtatshëm të emetuesve joqeveritarë
- obligacionet e emetuara ose të garantuara nga një vend i OECD-së (duke përfshirë autoritetet publike kombëtare të vendit përkatës) ose nga një institucion multinacional ose sipërmarrje me shtrirje rajonale (duke përfshirë në BE) ose globale
- kuotat e përfshira në një indeks kryesor dhe të tregtuara në një treg të rregulluar të BE-së ose në një bursë të një vendi të OECD-së

Ku publikohet përdorimi dhe tarifat

Përdorimi aktual Aspektet në vijim janë publikuar në "Fund Descriptions" për çdo fond që i përdor aktualisht:

- për këmbimet swaps totale të kthimit, kontratat për diferencën dhe derivativët e ngjashëm: ekspozimi maksimal dhe i pritshëm, i llogaritur duke përdorur metodën e angazhimit dhe i shprehur si përqindje e vlerës neto të aktiveve
- për transaksionet e marrëveshjeve të riblerjes dhe marrëveshjeve të anasjella të riblerjes: kufijtë maksimalë dhe të parashikuar janë shprehur si përqindje e vlerës neto të aktiveve
- për huadhënien e titujve: kufijtë maksimalë dhe të parashikuar janë shprehur si përqindje e vlerës neto të aktiveve

Aspektet në vijim janë publikuar në raportet financiare:

- përdorimi i të gjitha instrumenteve dhe teknikave të përdorura për menaxhimin efikas të fondit
- në lidhje me këtë përdorim, të ardhurat e marra, si dhe tarifat dhe kostot operacionale të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të pësuar nga çdo fond
- cili është paguar për kostot dhe tarifat e mësipërme dhe marrëdhënia që mund të ketë marrësi me filialet e Grupit Intesa Sanpaolo ose me depozitarin
- informacion mbi natyrën, përdorimin, ripërdorimin dhe ruajtjen e kolateralit

- kundërpalët që ka përdorur FCP-ja gjatë periudhës së mbuluar nga raporti, duke përfshirë kundërpalët kryesore për kolateralin

Tarifat e paguara për agjentin huadhënës nuk janë përfshirë në tarifimet e vazhdueshme sepse zbriten përpara se t'i paguhen FCP-së.

Përdorimi i ardhshëm Një fond mund të rrisë, në çdo kohë dhe deri në vlerën maksimale të përcaktuar, përdorimin e çdo derivativi ose teknike, përdorimi i parashikuar dhe maksimal i së cilave është paraqitur specifikisht në "Fund Descriptions". Kjo përfshin fondet, përdorimi aktual i prituri i të cilave është zero. Përshkrimi i fondit do të përditësohet në versionin pasues të prospektit.

Nëse aktualisht nuk ka parashikime për përdorimin në "Fund Descriptions" ose në këtë seksion "How the Funds Use Instruments and Techniques":

- për swap-et e kthimit total, kontratat për diferencat dhe derivativët e ngjashëm, si dhe për transaksionet e riblerjes dhe riblerjes së anasjelltë: përshkrimi i fondit në prospekt duhet të përditësohet për të qenë në përputhje me paragrafin e mësipërm "Përdorimi aktual", përpara se fondi të nisë përdorimin e këtyre derivativëve
- për huadhënien e titujve: përshkrimi i fondit në prospekt duhet të përditësohet në përputhje me "Përdorimin aktual" më sipër, përpara se fondi të fillojë të jap hua titujt

Kundërpalët e derivativëve dhe teknikat

Shoqëria e menaxhimit duhet të miratojë kundërpalët përpara se ato të mund të shërbejnë si të tilla për FCP-në. Krahas kërkesave të përcaktuara në rreshtat 10 dhe 11 në tabelën "Kompetencat dhe kufizimet e përgjithshme të investimit", një kundërpalë do të vlerësohet në raport me kriteret në vijim:

- statusi rregullator
- mbrojtja e ofruar nga legjislacioni kombëtar
- proceset operacionale
- analiza e aftësisë paguese, duke përfshirë shqyrtimin e marzheve të disponueshme të kredisë ose vlerësimeve të jashtme të kreditit; për CDS-të dhe swap-et e lëvizjes së çmimit, kundërpalë duhet të jetë një institucion financiar i kategorisë së parë.
- shkalla e përvojës dhe specializimi në llojin e veçantë të derivativit ose teknikës përkatëse

Statusi ligjor dhe vendi i origjinës ose vendndodhja nuk konsiderohen drejtpërdrejt si kritere përzgjedhjeje.

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë prospekt, asnjë kundërpalë e një derivativi të fondit nuk mund të shërbejë si një menaxher i investimeve të një fondi apo të ketë të drejtën e miratimit ose kontroll mbi përbërjen apo menaxhimin e investimeve ose transaksioneve të një fondi, apo mbi aktivet që janë në themel të një derivativi. Kundërpalët e afiljuara lejohen me kushtin që transaksionet të realizohen në kushtet normale të konkurrencës (sipas parimit "at arm's length").

Agjenti huadhënës do të vlerësojë rregullisht aftësinë dhe gatishmërinë e çdo huamarrësi titujsh për të përmbushur detyrimet e tij dhe FCP ka të drejtën të përjashtojë çdo huamarrës ose të ndërpresë çfarëdolloj huaje në çdo moment. Nivelet përgjithësisht të ulëta të rrezikut të kundërpalës dhe rrezikut të tregut, të lidhura me huadhënien e titujve, zbuten edhe më tej nga mbrojtja që mundëson agjenti huadhënës ndaj paaftësisë paguese të kundërpalës dhe nga marrja e kolateralit.

Politikat e kolateralit

Këto politika zbatohen për aktivet e marra nga kundërpalët në lidhje me transaksionet e huadhënies së titujve, transaksionet e riblerjes së anasjelltë dhe derivativëve OTC.

Kolaterali i pranueshëm Të gjithë titujt e pranuar si kolateral duhet të jenë të cilësishë së lartë. Llojet kryesore specifike janë paraqitur në tabelën në fund të këtij seksioni.

Kolaterali jo në mjete monetare duhet të tregtohet në një treg të rregulluar ose në një platformë shumëpalëshe tregtimi, me çmime transparente dhe duhet të jetë në gjendje të shitet me shpejtësi me një çmim të përafërt me atë të vlerësimit para shitjes. Për të garantuar se kolaterali është mjaftueshëm i pavarur nga kundërpalë, si për sa i përket rrezikut të kreditit ashtu dhe për sa i përket rrezikut të korrelacionit të investimit, kolaterali i lëshuar nga kundërpalë ose grupi i saj nuk pranohet. Kolaterali nuk parashikohet të shfaqë një korrelacion të lartë me performancën e kundërpalës. Ekspozimi i kundërpalës ndaj instrumenteve të borxhit monitorohet në raport me limitet e kreditit. Fondi duhet të jetë në gjendje të ekzekutojë të gjithë kolateralin në çdo kohë dhe pa iu referuar ose pa marrë miratim nga kundërpalë.

Kolaterali i marrë nga një kundërpalë në çdo transaksion mund të përdoret për të kompensuar ekspozimin e përgjithshëm ndaj asaj kundërpalë.

Për të shmangur administrimin e vlerave të vogla të kolateralit, FCP-ja mund të vendosë një vlerë minimale kolaterali (për vlera më të vogla nuk do të kërkojë kolateral) ose një kufi (për vlerat kumulative mbi të nuk do të kërkojë kolateral shtesë).

Për sa u përket fondeve që marrin kolateral për të paktën 30% të aktiveve të tyre, rreziku që lidhet me likuiditetin vlerësohet përmes provave të rregullta të rezistencës, të cilat supozojnë kushte likuiditeti normale dhe të jashtëzakonshme.

Diversifikimi I gjithë kolaterali i mbajtur nga FCP-ja duhet të jetë i diversifikuar sipas vendit, tregut dhe emetuesit, dhe ekspozimi ndaj një emetuesi të caktuar nuk duhet të tejkalojë 20% të aktiveve neto të një fondi. Nëse përcaktohet në përshkrimin e fondit, një fond mund të kolateralizohet plotësisht nga tituj të ndryshëm të transferueshëm dhe instrumente të tregut monetar ose mund të garantohet nga një shtet anëtar, nga një ose disa prej autoriteteve të tij vendore, nga një vend i tretë, ose nga një organ publik ndërkombëtar ku bën pjesë një ose disa shtete anëtare. Në këtë rast, fondi duhet të marrë kolateral nga të paktën 6 emetime të ndryshme, dhe asnjë emetim nuk duhet të tejkalojë 30% të totalit të aktiveve neto të fondit.

Ripërdorimi dhe riinvestimi i kolateralit (aktualisht nuk realizohet nga asnjë fond) Kolaterali në mjete monetare do të depozitohet ose do të investohet në obligacione qeveritare me cilësi të lartë, në transaksione të riblerjes së anasjelltë ose në fonde afatshkurtra të tregut monetar (siç përcaktohet në Udhëzimet për një përkufizim të përbashkët të fondeve evropiane të tregut monetar), të cilat përllogarisin një vlerë ditore neto të aktiveve dhe kanë vlerësim AAA ose të barasvlershëm. Të gjitha investimet duhet të përmbushin kërkesat për diversifikimin të paraqitura më sipër.

Nëse një fond investon kolateral nga huadhënia e titujve në transaksionet e riblerjes së anasjelltë, kufizimet që zbatohen për huadhënien e titujve do të shtrihen edhe te transaksionet e riblerjes së anasjelltë.

Kolaterali jo në mjete monetare nuk do të shitet, riinvestohet ose vendoset si garanci.

Kujdestaria e kolateralit Kolaterali (si dhe titujt e tjerë që mund të mbahen nën kujdestari), pronësia e të cilit i është transferuar një fondi, do të mbahet nga depozitari ose nga një nënkujdestar. Për sa i përket llojeve të tjera të marrëveshjeve të kolateralit, si p.sh. marrëveshja e garancisë, kolaterali mund të mbahet nga një kujdestar palë e tretë, i cili është objekt i mbikëqyrjes së kujdesshme dhe nuk ka lidhje me ofruesin e kolateralit.

Vlerësimi dhe zbritjet (haircuts) I gjithë kolaterali është i regjistruar me vlerën e tregut (vlerësohet çdo ditë duke përdorur çmimet e disponueshme të tregut), duke marrë në konsideratë zbritjet e aplikueshme (një zbritje e vlerës së kolateralit që ka si synim mbrojtjen nga çdo reduktim i vlerës ose likuiditetit të kolateralit). Një fond mund të kërkojë kolateral shtesë (marzhi i ndryshimit) nga kundërpalë për të garantuar se vlera e kolateralit është të paktën e barabartë me ekspozimin e kundërpalës përkatëse.

Normat e zbritjes, të cilat aplikohen aktualisht nga fondet, janë paraqitur më poshtë. Normat marrin në konsideratë faktorët që kanë gjasa të ndikojnë në luhatshmërinë dhe rrezikun e humbjes (si p.sh. cilësia e kreditit, maturimi dhe likuiditeti), si dhe rezultatet e testeve të rezistencës që mund të kryhen herë pas here. Shoqëria e menaxhimit mund t'i modifikojë këto norma në çdo moment, pa njoftim paraprak, por çdo ndryshim duhet të përfshihet në një version të përditësuar të prospektit.

Gjatë kohëzgjatjes së kontratës, vlera e kolateralit të marrë duhet të jetë të paktën e barabartë me 102% të vlerësimit në nivel global të titujve të përfshirë në këto transaksione ose teknika.

Lejohen si kolateral	Zbritja
Mjetet monetare	0% - 8%
Obligacionet e qeverive të OECD-së	2% - 20%
Obligacionet e korporatave	2% - 20%
Titujt e kapitalit*	8% - 10%

* *Pranohen ose tregtohen në një treg të rregulluar të një shteti anëtar të BE-së ose në një bursë të një shteti anëtar të OECD-së, në Hong-Kong ose Singapor, si dhe janë pjesë e një indeksi kryesor.*

Zbritjet e mjeteve monetare varen nga monedha. Zakonisht, nuk aplikohet asnjë zbritje kur monedha është e njëjtë me monedhën bazë të fondit. Zbritjet e obligacioneve varen nga maturimi.

Të ardhurat që i paguhen фондеве

Në përgjithësi, çdo e ardhur nga përdorimi i derivativëve dhe teknikave do t'i paguhet fondit përkatës, në veçanti:

- nga transaksionet e riblerjes dhe riblerjes së anasjelltë, si dhe nga swap-et e kthimit total: të gjitha të ardhurat bruto (kostot e menaxhimit të kolateralit që përfshihen në tarifën vjetore të funksionimit dhe administrimit);
- nga huadhënia e titujve: fondet që japin hua tituj do t'i paguajnë një tarifë të arsyeshme agjentit huadhënës për shërbimet e tij dhe për garancinë se do t'u japë фондеве një vlerë të barasvlershme me maksimumi 15% të të ardhurave bruto të gjeneruara nga çdo huadhënie e titujve të tyre dhe se do të mbajë të paktën 85% të këtyre të ardhurave.

Investimi në фонде

Kategoritë e kuotave

Brenda çdo fondi, FCP mund të krijojë dhe të emetojë kategori kuotash. Të gjitha kategoritë e kuotave brenda një fondi investojnë bashkërisht në të njëjtin portofol titujsh, por mund të dallojnë nga tarifat, kërkesat e kualifikimit të investitorëve dhe karakteristika të tjera, për t'u përshtatur nevojave të investitorëve të ndryshëm. Investitorëve do t'u kërkohej të dokumentojnë kualifikueshmërinë e tyre për të investuar në një kategori të caktuar kuotash, si p.sh përmes një dëshmie të investitorit institucional ose statusit të personit joamerikan, përpara se të bëjnë një investim fillestar.

Çdo kategori njësie identifikohet nga një nga etiketat e kategorisë së njësisë bazë (të përshkruara në tabelën më poshtë) dhe më pas nga çdo etiketë shtesë e aplikueshme (të përshkruara në vijim). Për shembull, "RD2" do të tregonte njësitë e kategorisë R që synojnë të shpërndajnë të ardhurat e grumbulluara dhe janë të shprehura në dollarë amerikanë. Brenda një kategorie të caktuar të një fondi, të gjitha kuotat kanë të tjera të barabarta pronësi. Një fond mund të emetojë çdo kategori bazë kuotash me karakteristikat e mëposhtme:

Karakteristikat e kategorisë bazë të kuotave Shih shënimet më poshtë

Kategoria bazë	Të disponueshme për	Investimi fillestar minimal për fond	Mbjajtja minimale në FCP	Tarifat maksimale	
				Hyrje	Dalje
R	Të gjithë investitorët	500 Euro	-	1,50%	-
Z	Investitorët institucionale	3 milionë euro	3 milionë euro	-	-

SHËNIME

Investitorët institucionale Investitorët sipas kuptimit të nenit 174 të ligjit të vitit 2010, si p.sh institucionet e kreditit dhe profesionistë të tjerë financiarë që investojnë në emër të tyre ose të investitorëve të tjerë (qoftë individë mbi bazën e një marrëveshjeje diskrecionare menaxhimi ose institucionale), si dhe shoqëritë e sigurimit, fondet e pensionit ose SIK të tjera (sipërmarrje të investimeve kolektive).

Personat juridikë Disa shembuj të tyre janë shoqëritë me një ortak të vetëm, ortakëritë (duke përfshirë shoqëritë komandite dhe ato kolektive), shoqëritë aksionare, shoqëritë private me përgjegjësi të kufizuar, shoqëritë e përbashkëta të sigurimit, institucionet, fondacionet, shoqatat dhe kongregacionet fetare.

Politika e shpërndarjes

Kuotat e akumulimit Këto kuota mbartin të gjitha të ardhurat neto nga investimi në çmimin e kuotës dhe përgjithësisht nuk shpërndajnë dividendë, ndonëse bordi mund të shpallë një dividend aksion.

Kuotat e shpërndarjes Këto kuota kanë për qëllim (por nuk garantojnë) kryerjen e shpërndarjeve periodike të mbajtësit e kuotave. Shpërndarjet, nëse ka të tilla, shpallen të paktën një herë në vit dhe paguhen brenda 10 ditëve pune pas shpalljes. Me shpalljen e një dividendi, nga NAV-ja e kategorisë përkatëse të kuotave zbritet shuma e dividendit.

Shpërndarjet paguhen vetëm për kuota të cilat zotëroheshin në datën e shpalljes (data në të cilën shpallen dividendët). Vini re se për çdo kategori kuotash që paguan shpërndarje përpara fundit të një viti kalendarik, ekziston rreziku që një pjesë e shpërndarjes të jetë kthim nga investimi juaj që mund të tatohet si fitim. Një kthim i lartë nga shpërndarja nuk nënkupton domosdoshmërisht një kthim total të lartë apo në vlerë pozitive.

Vlera minimale fillestare dhe e zotëruar Për monedhat e ndryshme nga euro, këto shuma aplikohen në një vlerë të barasvlershme me vlerën në euro. Për investimet fillestare, barasvlershmëria matet në kohën e investimit, ndaj ajo mund të ndryshojë me kohën.

Tarifat maksimale Këto zbriten nga investimi juaj ose nga të ardhurat tuaja nga riblerja, dhe u paguhen agjentëve të shitjeve dhe ndërmjetësve të autorizuar. Tarifat e treguara janë ato maksimale. Për të gjetur tarifën reale për një transaksion, kontaktoni konsulentin tuaj financiar ose agjentin e transferimit (shih "Management and Business Operations"). Tarifat që llogariten si përqindje e investimit zbriten nga investimi për të nxjerrë shumën neto të investuar (shembull: për një investim prej 100 euro dhe një tarifë hyrëse 4,00%, shuma neto e investuar është 96 euro). Aktualisht, nuk aplikohen tarifa të këmbimit valutor mbi asnjë kategori kuotash.

Emërtimet shtesë

Pas emërtimit bazë të kategorisë së kuotave, shtohen prapashtesa të cilat tregojnë karakteristikat e caktuara.

D Tregon që kuotat janë kuota shpërndarëse. Nëse shkronja "D" nuk shfaqet pas shkronjës së kategorisë bazë, kuotat janë kuota grumbullimi. (Shih "Politika e shpërndarjes" më poshtë.)

Kodet e monedhave Çdo kategori kuotash që nuk është e shprehur në monedhën bazë të fondit mbart një kod shifror për monedhën në të cilën është shprehur. Nëse nuk shfaqet asnjë kod shifror, monedha e kategorisë së kuotave është e njëjtë me monedhën bazë të fondit.

Emri i monedhës	Kodi standard	Kodi i kategorisë së kuotave
Dollar australian	AUD	4
Renminbi kinez (offshore)	CNH	3
Paundi i Britanisë së Madhe (sterlinë)	GBP	6
Forinti hungarez	HUF	9
Jeni japonez	JPY	5
Zlota polake	PLN	8
Franga zvicerane	CHF	7
Dollari amerikan	USD	2

Shpërndarjet e kapitalit minimizojnë potencialin tuaj për rritje të investimit dhe nëse vazhdojnë në kohë mund ta reduktojnë vlerën e investimit tuaj në zero.

Mbi pagesat e papretenduar të dividendëve nuk paguhet interes, dhe këto pagesa i rikthehen fondit pas 5 vitesh. Asnjë fond nuk do të kryejë një pagesë dividendësh nëse aktivet e FCP-së janë nën kapitalin minimal të kërkuar ose nëse pagesa e dividendit do të çonte në këtë rezultat.

Frekuenca dhe natyra e parashikuar e dividendëve për kategoritë e listuara kur ato kanë D si prapashtesë është si më poshtë:

Kategoria bazë	Programi i parashikuar	Baza e dividendit
R	Deklaron dividendë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik.	Të ardhurat neto nga investimi.

Kategoria bazë	Programi i parashikuar	Baza e dividendit
Z	Deklaron dividendët pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik.	Të paktën 80% e të ardhurave neto nga investimi.

Shpërndarjet e të ardhurave neto nga investimi përfshijnë dividendin neto dhe interesin e marrë nga investimet e fondeve dhe llogaritë bankare, minus tarifat e menaxhimit dhe ato administrative, interesin e paguar, taksat dhe tarifat e tjera. Ato mund të përfshijnë gjithashtu të gjitha ose një pjesë të fitimeve neto të realizuara ose të parealizuara të fondit, nga periudha aktuale ose nga periudha të mëparshme. Në raportet financiare jepet një detajim i origjinës së çdo shpërndarjeje.

Kategoritë e disponueshme

Informacioni i mësipërm përshkruan të gjitha kategoritë bazë të kuotave që ekzistojnë aktualisht dhe prapashtesat e tyre. Në praktikë, jo të gjitha kategoritë bazë të kuotave dhe konfigurimet e kategorive bazë janë të disponueshme në të gjitha fondet. Disa kategori kuotash (dhe fonde) që janë të disponueshme në juridiksione të caktuara mund të mos jenë të disponueshme në juridiksione të tjera. Për informacionin më të fundit lidhur me kategoritë e kuotave të disponueshme, shkoni te eurizoncapital.com ose kërkoni një listë falas nga shoqëria menaxhuese.

Emetimi dhe pronësia

Format në të cilat emetohen kuotat Ne emetojmë kuota kryesisht në formë të regjistruar. Me këto kuota, emri i pronarit regjistrohet në regjistrin e mbajtësve të kuotave të FCP dhe pronari merr një konfirmim të nënshkrimit. Pronësia mund të transferohet vetëm me anë të njoftimit të agjentit të transferimit ose me anë të një ndryshimi të pronësisë. Formularët për këtë qëllim jepen nga FCP dhe nga agjenti i transferimit.

Ne nuk emetojmë kuota të prurësit ose vërtetime që dokumentojnë pronësinë e kuotave të regjistruara.

Investimi përmes një personi të emëruar kundrejt investimit të drejtpërdrejtë me FCP-në Nëse ju investoni përmes një subjekti që mban kuotat tuaja nën emrin e tij (një llogari të emëruar), ky subjekt regjistrohet si pronar në regjistrin e mbajtësve të kuotave të FCP-së dhe, për qëllimet e FCP-së, ai konsiderohet titullar i të gjitha të drejtave të pronësisë, duke përfshirë të drejtat e votës. Nëse nuk parashikohet ndryshe nga legjislacioni vendas, çdo investitor që zotëron kuota në një llogari të emëruar me një agjent shpërndarës ka të drejtën të pretendojë, në çdo kohë, pronësi të drejtpërdrejtë mbi kuotat e nënshkruara përmes të emëruarit. I emëruari mban regjistrat e tij dhe i jep çdo investitori të cilit ai shërben informacione në lidhje me kuotat e zotëruara dhe transaksionet me kuotat e fondeve që lidhen me atë investitor.

Politika të tjera

Kuotat emetohen në një të njëmijtën e kuotës (3 shifra pas presjes dhjetore). Kuotat jo të plota marrin pjesën e tyre proporcionale nga të gjithë dividendët, rinvestimet dhe të ardhurat nga likuidimi, por nuk zotërojnë të drejta vote.

Kuotat nuk kanë të drejta preferenciale ose të parablerjes. Nuk është e detyrueshme që fondet t'u akordojnë mbajtësve ekzistues të kuotave të drejta apo kushte të veçanta për nënshkrimin e kuotave të reja. Të gjitha kuotat duhet të shlyhen plotësisht.

Tarifat dhe kostot e fondeve

Në përgjithësi, normat e tarifave paraqiten në "Fund Descriptions". Tarifat e vogla dhe shpenzimet që zbriten drejtpërdrejt nga aktivet e fondeve përshkruhen këtu, së bashku me informacione të mëtejshme lidhur me tarifat dhe kostot e paraqitura diku tjetër.

Tarifa e menaxhimit

Kjo tarifë përshkruhet për çdo fond në "Fund Descriptions" dhe i paguhet shoqërisë së menaxhimit si subjekti kryesor me përgjegjësinë e menaxhimit të biznesit, menaxhimit të investimeve, marketingut dhe shitjeve të FCP-së. Kjo tarifë nuk i kalon normat e përshkruara për çdo fond në "Përshkrimet e Fondit" dhe llogaritet dhe paguhet çdo muaj me vonesë.

Nga kjo tarifë, shoqëria e menaxhimit u paguan menaxherëve të investimit tarifën e menaxhimit të investimit. Ajo mund të paguajë edhe ofruet e tjerë të shërbimeve, siç është administratori, depozitari, regjistruesi, agjenti i transferimit dhe agjenti pagues.

Tarifa e administrimit

Kjo tarifë përshkruhet për çdo fond në "Fund Descriptions" dhe i paguhet shoqërisë së menaxhimit si subjekti kryesor që ka përgjegjësi për aktivitetet operacionale, ligjore, kontabël dhe ato të pajtueshmërisë së FCP-së.

Nga kjo tarifë, shoqëria e menaxhimit paguan shërbimet e ofruara nga administratori, depozitari, regjistruesi, agjenti i transferimit dhe agjenti pagues. Kjo tarifë nuk tejkalon 0,25% në vit të vlerës mesatare neto të aktiveve të fondit. Çdo ndryshim në këtë tarifë do të pasqyrohet në raportet financiare. Kjo tarifë akumulohet çdo ditë dhe paguhet në fund të çdo muaji.

Zbërthimi i shpenzimeve

FCP-ja i paguan shpenzimet e saj të menaxhimit, shpërndarjes dhe ato administrative nga aktivet e mbajtësve të kuotave. Më poshtë tregohen disa shembuj të këtyre shpenzimeve.

Shpenzimet e përfshira në tarifat e përshkruara fill më lart:

- shpenzimet e shoqërisë së menaxhimit
- tarifat e kujdestarisë, tarifat e depozitarit dhe tarifat e ruajtjes
- tarifat e transferimit, të regjistruarit dhe të agjentit pagues
- kompensimi për shpërndarësit ose platformat për shërbimet e tyre në lidhje me marketimin dhe shpërndarjen e kuotave të fondeve
- shërbimet e administrimit, të kontabilitetit të fondeve dhe ato domiciliare
- shpenzimet ligjore për këshillim për llogari të FCP
- tarifat e auditimit
- tarifat e vazhdueshme të regjistrimit
- tarifat që kanë të bëjnë me renditjen e kuotave të fondeve në një bursë (sipas rastit)
- kostot e dokumentacionit, të tilla si përgatitja, shtypja, përkthimi dhe shpërndarja e prospektit, dokumentet kyçe të informacionit dhe raportet financiare
- kostot e themelimit (të cilat mund të amortizohen brenda një periudhe maksimale prej 5 vitesh pas datës së themelimit të një fondi)
- kostot që lidhen me grumbullimin, raportimin dhe publikimin e nevojshëm të të dhënave në lidhje me FCP-në, investimet e saj dhe mbajtësit e kuotave
- kostot e publikimit të të dhënave për performancën e fondit
- tarifat e licencimit të indekseve financiare
- tarifat për operimin e kategorive të mbrojtura të kuotave

Shpenzimet që nuk përfshihen në tarifat e përshkruara fill më lart:

- tatimet, taksat dhe kostot e transaksioneve që lidhen me blerjen dhe shitjen e aktiveve të fondit
- tarifat dhe komisionet e brokerimit
- interesi mbi huamarrjen dhe tarifat bankare të shkaktuara gjatë negociatave për huamarrje
- shpenzimet e proceseve gjyqësore ose të reklamimit të taksave
- të gjitha shpenzimet e jashtëzakonshme ose tarifa të tjera të paparashikuara

- *taxe d'abonnement* (taksa e abonimit), shikoni faqen 24

Të gjitha shpenzimet që paguhen nga aktivet e mbajtësit të kuotave pasqyrohen në llogaritjet e NAV-së, dhe shumat faktike të paguara dokumentohen në raportet vjetore të FCP-së.

Shpenzimet e vazhdueshme do të zbriten fillimisht nga të ardhurat korrente, më pas nga fitimet kapitale të realizuara, dhe në fund nga kapitali.

Çdo fond dhe kategori paguan të gjitha kostot që ai pëson drejtpërdrejt, si dhe pjesën e tij proporcionale (bazuar në vlerën neto të aktiveve) të kostove që nuk i atribuohen një fondi apo një kategorie specifike. Për çdo kategori kuotash monedha e së cilës është e ndryshme nga monedha bazë e fondit, të gjitha kostot që lidhen me ruajtjen e monedhës së kategorisë së veçantë të kuotave (si p.sh. mbrojtja nga luhajtjet e kursit të këmbimit dhe kostot e këmbimit valutor) do t'i faturohen vetëm kategorisë përkatëse të kuotave për aq sa kjo është e mundur.

Shpenzimet llogariten çdo ditë pune për çdo fond dhe çdo kategori dhe paguhen në fund të çdo muaji.

Blerja, shkëmbimi dhe shitja e kuotave

Opsionet për paraqitjen e kërkesave për investim

- Nëse jeni duke investuar përmes një konsulenti financiar apo një ndërmjetësi tjetër: kontaktoni ndërmjetësin.
- Përmes një platforme elektronike të paracaktuar.
- Me anë të një faksi drejtuar agjentit regjistruar: 00 352 24 52 91 45.
- Me anë të një letre drejtuar shpërndarësit të autorizuar.
- Me anë të një letre drejtuar agjentit të transferimit në adresën:
- State Street Bank International GmbH
Luxembourg Branch
49, Avenue J.F. Kennedy
L-1855 Luksemburg

Informacioni që aplikohet për të gjitha transaksionet përveç transferimeve

Paraqitja e kërkesave Ju mund të paraqisni kërkesa për blerjen, shkëmbimin ose shitjen (riblerjen) e kuotave në çdo kohë, duke përdorur opsionet e treguara më lart.

Kur paraqisni një kërkesë, ju duhet të përfshini të gjithë informacionin e nevojshëm identifikues, duke përfshirë numrin e llogarisë dhe emrin dhe adresën e mbajtësit të llogarisë, saktësisht siç ato shfaqen në llogari. Kërkesa juaj duhet të cilësojë fondin, kategorinë e kuotave, monedhën referencë dhe shumën dhe llojin e transaksionit (blerje, shkëmbim, shitje). Për blerjet, shumën e transaksionit duhet të shprehet në një monedhë të caktuar. Për shkëmbimet ose shitjet, ju mund ta shprehni shumën e transaksionit ose në monedhë ose në kuota. Nëse zotëroni vërtetime të kuotave, duhet t'i jepni ato në mënyrë që kërkesa juaj për shkëmbim ose shitje të përpunohet.

Pasi ta keni paraqitur një kërkesë, ju mund ta tërhiqni atë vetëm nëse ka një pezullim të transaksioneve në kuotat e fondit përkatës.

Asnjë kërkesë nuk do të pranohet ose përpunohet në mënyra që bien ndesh me këtë prospekt.

Orët e cut-off dhe programi i përpunimit Këto cilësohen për çdo fond në "Fund Descriptions". Përveçse gjatë pezullimeve të transaksioneve të kuotave, kërkesat që janë marrë dhe pranuar nga agjenti i transferimit brenda orës së cut-off-it në një ditë të caktuar pune (T) do të përpunohen zakonisht në ditën pasardhëse të punës (T+1), në NAV-në e llogaritit në orën e cut-off-it në ditën kur urdhri është pranuar (T). Nëse një ose më shumë nga ditët pasardhëse nuk janë ditë pune, NAV-ja do të përcaktohet në ditën e parë pasardhëse të punës, duke përdorur të njëjtat çmime referencë të tregut si në rastin kur NAV-ja do të ishte përcaktuar në T+1.

Urdhret që vijnë pas orës së cut-off-it në një ditë të caktuar pune do të pranohen në orën pasardhëse të cut-off-it.

Vini re se NAV-ja me të cilën përpunohet një kërkesë nuk mund të dihet në kohën e paraqitjes së një kërkesë.

Një njoftim konfirmimi do t'i dërgohet me postë ose me faks mbajtësit të regjistruar të kuotave ose agjentit të tij brenda 2 javëve pas përpunimit të kërkesës.

Shih "Përshkrimet e fondit" për programet e shlyerjes.

Çmimet Çmimi i kuotave përcaktohet me NAV-në për kategorinë përkatëse të kuotave. Të gjitha kërkesat për blerje, shkëmbim ose shitje të kuotave përpunohen me atë çmim, të përshtatur në bazë të ndryshimeve. Çdo NAV llogaritet me monedhën bazë të fondit dhe më pas konvertohet, me kurset aktuale të tregut, në çdo monedhë në të cilën shprehet kategoria e kuotave. Përveçse për periudhat fillestare të ofrimit, gjatë të cilave çmimi është çmimi fillestar i ofertës, çmimi i kuotës për një transaksion do të jetë NAV-ja e llogaritit për ditën në të cilën kërkesa për transaksionin është përpunuar.

Monedhat Ne pranojmë dhe kryejmë pagesa vetëm në monedhën bazë të kategorisë përkatëse të kuotave. Shoqëria e menaxhimit mund të bjerë dakord që të pranojë kërkesa në monedha për të cilat nevojitet konvertim, dhe në këtë rast konvertimi do të bëhet me kurset bankare të zakonshme, përpara pranimit të kërkesës.

Tarifat Çdo blerje, shkëmbim ose shitje mund të përfshijë tarifa. Për tarifën maksimale që ngarkohen nga çdo kategori bazë kuotash, shihni përshkrimin e fondit përkatës dhe tabelën "Karakteristikat e kategorisë bazë të kuotave". Për të gjetur tarifën reale që përfshihen në një transaksion, kontaktoni ndërmjetësin tuaj ose agjentin e transferimit. Palët e tjera të përfshira në transaksion, si për shembull banka, ndërmjetësi ose agjenti pagesues, mund të faturojnë tarifën e tyre. Disa transaksione mund të gjenerojnë detyrime tatimore. Ju jeni përgjegjës për të gjitha kostot dhe taksat që lidhen me çdo kërkesë që paraqisni.

Vonesat ose moskryerja e pagesave për mbajtësit e kuotave Pagesa e një dividendi ose e të ardhurave nga shitja për një mbajtës të kuotave mund të kryhet me vonesë për arsye të likuiditetit të fondit dhe mund të vonohet, të zvogëlohet ose të mbahet për shkak të kërkesave të rregullave të këmbimit valutor, rregullave të tjera të vendosura nga juridiksioni i origjinës i mbajtësit të kuotave, ose për arsye të tjera të jashtme. Në këto raste ne nuk mund të marrim përsipër asnjë përgjegjësi dhe nuk paguajmë interes për shumat e mbajtura.

Investimi përmes planeve të rregullta të investimit Nëse jeni duke investuar përmes një plani të rregullt investimi të ofruar nga një shpërndarës, platformë ose ndërmjetës tjetër që është miratuar nga ne, ju duhet të ndiqni kushtet e përgjithshme të përcaktuara nga plani, krahas të gjitha kushteve të tjera përkatëse që përfshihen në këtë prospekt. Ofruesi juaj i planit të investimit duhet t'ju informojë mbi kushtet e tij.

Ndryshimet në informacionin e llogarisë Ju duhet të na njoftoni menjëherë për çdo ndryshim të informacionit personal ose bankar, veçanërisht kur bëhet fjalë për informacione që mund të ndikojnë te kualifikueshmëria për një kategori kuotash. Ne do të kërkojmë prova të njafatueshme të vërtetësisë për çdo kërkesë për ndryshim të llogarisë bankare që lidhet me investimin e fondit tuaj.

Blerja e kuotave Shih gjithashtu "Informacioni që aplikohet për të gjitha transaksionet përveç transferimeve" më lart.

Për të bërë një investim fillestar, paraqisni një formular të plotësuar aplikimi dhe të gjithë dokumentacionin e hapjes së llogarisë (p.sh. të gjithë informacionin e kërkuar tatimor dhe atë kundër pastrimit të parave) duke përdorur një prej opsioneve të përshkruara më lart. Sigurohuni që të jepni të gjitha dokumentet e kërkuara të identifikimit së bashku me formularin tuaj të aplikimit, si dhe informacionin e llogarisë bankare dhe udhëzimet për transfertat bankare, për të shmangur vonesat në marrjen e të ardhurave kur dëshironi të shisni kuota.

Pasi llogaria të jetë hapur, ju mund të paraqisni urdhra të tjerë siç tregohen në kutinë në faqen e mëparshme. Të gjithë titujt në një llogari duhet të jenë në të njëjtën monedhë (monedha e

përcaktuar e kuotave të para të blera), gjë që do të thotë se për mbajtjen e investimeve në disa monedha nevojiten disa llogari. Ruajini me kujdes të gjithë numrat e llogarisë, pasi ata konsiderohen si prova kryesore e identitetit të mbajtësit të kuotave.

Të gjitha kërkesat për blerje duhet të shoqërohen ose me pagesën e plotë përpara afatit të shlyerjes të specifikuar në "Fund Descriptions", ose me një garanci të dokumentuar e të përvokueshme që konsiderohet e pranueshme nga shpërndarësi ose nga shoqëria e menaxhimit, dhe që siguron se pagesa e plotë do të merret përpara afatit. Nëse nuk marrim pagesën e plotë për kuotat tuaja brenda kohës së përcaktuar për shlyerjen ne mund t'i shesim (riblejmë) ato, të anulojmë emetimin e tyre dhe t'jua kthejmë pagesën duke zbritur prej saj humbjet nga investimi dhe kostot e pësuarat për anulimin e atyre kuotave.

Vini re se disa ndërmjetës mund të kenë kërkesat e tyre personale për hapjen e llogarive dhe pagesën e blerjeve.

Për përpunim optimal të investimeve, dërgojini paratë nëpërmjet transferit të bankare (pa asnjë tarifë bankare) në monedhën e kuotave që dëshironi të blini.

Shkëmbimi i kuotave *Shih gjithashtu "Informacioni që aplikohet për të gjitha transaksionet përveç transferimeve" më lart.*

Ju mund të shkëmbeni (ndërroni) kuotat e një fondi me kuota të së njëjtës kategorie në një fond tjetër në FCP. Gjithashtu, ju mund t'i shkëmbeni kuotat edhe me kuota të kategorive të tjera, qoftë brenda të njëjtit fond apo në një fond tjetër; në këtë rast, ju duhet të specifikoni kategorinë e dëshiruar të kuotave në kërkesën tuaj.

Të gjitha shkëmbimet u nënshtrohen kushteve të mëposhtme:

- ju duhet të përmbushni të gjitha kërkesat e kualifikueshmërisë dhe kërkesat e investimit fillestar minimal për kategorinë e kuotave me të cilën dëshironi të bëni shkëmbimin
- në rast të shkëmbimit të parave me kuota me tarifë nënshkrimi më të lartë se ajo që keni paguar, do t'ju faturohet diferenca
- nëse është e mundur, ne do ta bëjmë shkëmbimin pa konvertim të monedhës; në të kundërt, çdo konvertim i nevojshëm i monedhës do të përpunohet në ditën kur kryhet shkëmbimi, në kursin përkatës të asaj dite
- shkëmbimi nuk duhet të shkelë kufizimet e shprehura në këtë prospekt (duke përfshirë ato të shprehura në "Fund Descriptions")

Do t'ju vëmë në dijeni në rast se një shkëmbim i kërkuar prej jush nuk lejohet nga ky prospekt.

Ne i përpunojmë të gjitha shkëmbimet e kuotave në bazë të parimit të barazisë së vlerës, duke përdorur NAV-të e dy investimeve (dhe, sipas rasti, kurset e këmbimit valutor) që janë në fuqi në kohën kur ne përpunojmë shkëmbimin. Nëse ka dallim në orët e cut-off-it, aplikohet ora më e hershme. Duke qenë se shkëmbimet mund të përpunohen vetëm në ditët kur të dyja fondet përpunojnë transaksione me kuota, kërkesa për shkëmbim duhet të bëhet në një ditë të tillë.

Duke qenë se shkëmbimi konsiderohet se konsiston në dy transaksione të veçanta (njëkohësisht riblerje dhe nënshkrim), ai mund të sjellë pasoja tatimore apo të një natyre tjetër. Komponentët e blerjes dhe shitjes në një shkëmbim u nënshtrohen të gjitha kushteve të çdo transaksioni përkatës.

Shitja e kuotave *Shihni gjithashtu "Informacioni që aplikohet për të gjitha transaksionet përveç transferimeve" më lart.*

Vini re se të gjitha të ardhurat nga riblerja do të paguhen vetëm pasi të jetë marrë i gjithë dokumentacioni i investitorit, duke përfshirë çdo dokumentacion të tillë të kërkuar më parë që nuk ishte dhënë siç duhet.

Ne ja paguajmë të ardhurat nga riblerja vetëm mbajtësit/mbajtësve të kuotave të identifikuar në regjistrin e mbajtësve të kuotave të FCP-së, me anë të një transferi bankare në të dhënat e llogarisë bankare që kemi të regjistruara. Në rast se mungon ndonjë informacion i nevojshëm, kërkesa juaj do të mbahet pezull deri sa ky informacion të merret dhe të mund të verifikohet. Të gjitha pagesat kundrejt jush bëhen me shpenzimet tuaja dhe nën përgjegjësinë tuaj.

Të ardhurat nga shitja paguhen në monedhën e llogarisë suaj. Për të bërë konvertimin e të ardhurave tuaja në një monedhë tjetër, kontaktoni ndërmjetësin tuaj ose agjentin e transferimit përpara se të bëni kërkesën tuaj.

Transferimi i kuotave

Si alternativë ndaj shkëmbimit ose shitjes, ju mund të transferoni pronësinë e kuotave tuaja te një investitor tjetër. Megjithatë, vini re se të gjitha kërkesat e kualifikueshmërisë si pronar për kuotat tuaja aplikohen edhe për pronarin e ri (për shembull, kuotat institucionale nuk mund t'u transferohen investitorëve jointucionalë) dhe nëse kryhet një transferim të një pronar i pakualifikueshëm, bordi do ta shpallë transferimin të pavlefshëm, do të kërkojë një transferim të ri te një pronar i kualifikueshëm ose do të bëjë riblerjen e detyrueshme të kuotave.

Si e llogarisim NAV-në

Afati dhe formula

Përveç rasteve kur tregohet ndryshe në "Përshkrimet e fondeve", ne llogarisim NAV-in për çdo kategori kuote të çdo fondi në baza ditore, sipas kalendarit të ditëve të përpunimit të disponueshëm në eurizoncapital.com dhe sipas kërkesës në shoqërinë administruese. Çdo NAV llogaritet me monedhën bazë të fondit dhe me monedhën e çdo kategorie përkatëse kuotash. Për shkak të dallimeve, si për shembull dallimeve në tarifa dhe në politikat e shpërndarjes, kategori të ndryshme kuotash në një fond të caktuar mund të kenë çmime të ndryshme.

Të gjitha NAV-të vendosja e çmimit të të cilave përfshin konvertimin në monedhë tjetër të një NAV-je bazë llogariten me të njëjtin kurs këmbimi si ai që përdoret për llogaritjen e NAV-së. NAV-të rrumbullakosen në shumën më të afërt të prerjes së vogël të përdorur gjerësisht.

Për të llogaritur NAV-në për çdo kategori kuotash të një fondi, ne përdorim këtë formulë të përgjithshme:

$$\frac{\text{(aktivet - pasivet)}}{\text{numri i kuotave në qarkullim}} = \text{NAV}$$

Dispozitat e duhura do të bëhen për të llogaritur kostot, detyrimet dhe tarifët që i atribuohen secilit fond dhe kategori, si dhe të ardhurat e grumbulluara nga investimet.

Për informacion të plotë mbi metodat tona të llogaritjes së NAV-së, shihni rregulloret e menaxhimit.

Vlerësimet e aktiveve

Në përgjithësi, ne e përcaktojmë vlerën e aktiveve të çdo fondi si më poshtë. Vini re se për çdo lloj titulli, ne mund të përdorim metodat e vlerës së drejtë në vend të metodës së shprehur këtu (shihni përshkrimin pas pikave).

- **Mjetet monetare në arkë ose në bankë, kambialet, dëftesat dhe llogaritë e arkëtueshme, shpenzimet e parapaguara, dividendët në cash dhe interesat e shpallura ose të akumuluar por ende të paarkëtuara.** Vlerësohen në vlerën e plotë, mund të pësojnë ndryshime në varësi të zbritjeve ose primeve që ne mund të aplikojmë bazuar në vlerësimet tona lidhur me rrethanat që e bëjnë pagesën e plotë të pagjasë.
- **Borxhet afatshkurtra dhe aktivet likuide.** Vlerësohen përgjithësisht në vlerën nominale plus interesin ose koston e amortizuar, dhe mund të pësojnë korrigjime nëse rishikimet e rregullta zbulojnë ndonjë mospërputhje thelbësore me kuotimet e tregut.

- **Instrumentet e tregut të parasë, borxhi afatshkurtër dhe aktivet likuide.** Vlerësohen përgjithësisht në vlerën nominale plus interesin ose koston e amortizuar, dhe mund të pësojnë korrigjime nëse rishikimet e rregullta zbulojnë ndonjë mospërputhje thelbësore me kuotimet e tregut.
- **Titujt e transferueshëm që tregtohen në një bursë zyrtare ose në një treg tjetër të rregulluar.** Vlerësohen me çmimin më të fundit të mbylles të kuotuar në tregun ku tregtohen kryesisht.
- **Futuret dhe opsionet e renditura.** Vlerësohen me çmimin e shlyerjes në mbyllje.
- **Derivatvët mbi banak dhe derivativët e tjerë të palistuar.** Vlerësohen në vlerën neto të thyerjes, mbi një bazë që aplikohet në mënyrë konstante për çdo lloj kontrate, duke përdorur modele të brendshme që marrin në konsideratë faktorë të tillë si vlerën e titullit bazë, normat e interesit, kthimet nga dividendi dhe luhatshmërinë e parashikuar.
- **Aksionet ose kuotat e SIKTT-ve ose SIK-ve.** Vlerësohen në NAV-në më të fundit të raportuar nga SIKTT/SIK.
- **Swap-et e mosshlyerjes së kredisë dhe kontratat për diferencat.** Vlerësohen në vlerën e tregut, duke iu referuar kurbës përkatëse të normës.
- **Të gjitha swap-et e tjera.** Vlerësohen duke përdorur diferencën midis flukseve në hyrje dhe në dalje.
- **Monedhat.** Vlerësohen në vlerën mesatare të çmimeve më të fundit të kërkesës dhe ofertës për valutat (aplikohet për monedhat e mbajtura si aktive, për pozicionet mbrojtëse dhe në rastin e këmbimit të vlerave të titujve të shprehur në monedha të tjera në monedhën bazë të fondit).
- **Titujt dhe aktivet e tjera të palistuar.** Vlerësohen në vlerën e drejtë (shihni më poshtë).

Të gjitha metodologjitë e vlerësimit (duke përfshirë vlerën e drejtë) përcaktohen nga shoqëria e menaxhimit dhe përdorin parime të auditueshme vlerësimi. Për çdo aktiv, shoqëria administruuese mund të caktojë një metodë të ndryshme vlerësimi nëse beson se kjo metodë mund të rezultojë në një vlerësim më të drejtë.

Vlera e drejtë Ne mund të vlerësojmë çdo aktiv me vlerën e drejtë (një vlerësim i kujdesshëm i vlerës së tij afatshkurtër të likuidimit) kur besojmë se një nga sa vijon është e vërtetë:

- nuk është e mundur të bëhet një llogaritje e saktë apo e besueshme duke përdorur metodën e zakonshme
- ekzistojnë kushte të pazakonta tregu
- çmimet më të fundit të disponueshme nuk pasqyrojnë më vlerat e sakta
- vlerat nga burimet dhe metodat e zakonshme nuk janë të përditësuara ose të sakta, ose janë të padisponueshme

Çdo vlerësim i fondit përmes përdorimit të metodave legjitime mund të dallojë nga çmimet e kuotuar ose të publikuara ose mund të ketë dallime thelbësore nga çmimi real i shitjes që fondi ka faktikisht aftësinë të arrijë.

Për më tepër informacion mbi metodat tona të vlerësimit të aktiveve, shihni rregulloret e menaxhimit.

Swing pricing

Në ditët e punës kur numri neto i kuotave të blera ose të riblera të një fondi tejkalon 2% të aktiveve totale neto të fondit, shoqëria e menaxhimit mund t'i vlerësojë aktivet e atij fondi me çmimin e ofertës ose të kërkesës, përkatësisht. Ky rregullim pasqyron një vlerësim të kostove të përgjithshme të bëra në blerjen dhe shitjen e investimeve për të përmbushur blerjet ose shitjet e kuotave (duke kuptuar që një fond përgjithësisht mban likuiditet të mjaftueshëm ditore për të trajtuar flukset e zakonshme të parasë me pak ose aspak ndikim në operacionet e zakonshme të investimeve). Swing pricing synon të minimizojë ndikimin e këtyre kostove mbi mbajtësit e kuotave që nuk janë duke i tregtuar kuotat e tyre në atë moment. Swing pricing mund të ndikojë deri diku në amplifikimin e luhatshmërisë.

Taksat

Informacioni i mëposhtëm është i përmbledhur dhe jepet thjesht si referencë e përgjithshme. Investitorët duhet të konsultohen me konsulentët e tyre tatimorë.

Taksat që paguhen nga aktivet e fondit

FCP i nënshtrohet *tax d'abonnement* (taksë abonimi) të Luksemburgut me tarifat e mëposhtme:

- Kategoria R: 0,05%.
- Kategoria Z: 0,01%.

Kjo taksë llogaritet dhe paguhet çdo tre muaj, në vlerën neto të agreguar të aktiveve të kuotave në qarkullim të FCP-së në fund të tremujorit. Çdo aktiv që vjen nga një UCI tjetër i Luksemburgut për të cilin është paguar tashmë *taxe d'abonnement* nuk i nënshtrohet një *taxe d'abonnement* të mëtejshme.

Aktualisht FCP-ja nuk është objekt i taksës së pullës, tatimit në burim, taksës bashkiake për bizneset, tatimin mbi vlerën neto ose pasurinë ose tatimit mbi të ardhurat, fitimin ose fitimet kapitale.

Nëse ndonjë shtet në të cilin një fond investon aplikon tatim në burim mbi të ardhurat ose fitimet e gjeneruara në atë shtet, ky tatim do të zbritet përpara se fondi të marrë të ardhurat ose fitimet e tij. Disa prej këtyre taksave mund të jenë të rikuperueshme. Fondit mund t'i duhet të paguajë edhe taksa të tjera mbi investimet e tij. Efekti i taksave do të përfshihet si faktor në llogaritjet e performancës së fondit. Shihni gjithashtu "Rreziqet tatimore" në seksionin "Përshkrimet e rrezikut".

Edhe pse informacioni tatimor i mësipërm është i saktë brenda dijenisë së të bordit, është e mundur që një autoritet tatimor t'i ndryshojë taksat ekzistuese ose të vendosë taksa të reja (duke përfshirë ato retroaktive) ose që autoritetet tatimore të Luksemburgut të vendosin, për shembull, që çdo kategori e identifikuar aktualisht si kategori që i nënshtrohet *taxe d'abonnement* në shkallën 0,01% të riklasifikohet si kategori që i nënshtrohet shkallës 0,05%. Rasti i dytë mund të ndodhë për një kategori kuotash institucionale të një fondi për çdo periudhë gjatë së cilës është konstatuar mbajtja e kuotave institucionale nga një investitor që nuk e ka të drejtën e mbajtjes së këtyre kuotave.

Taksat që ju keni përgjegjësinë të paguani

Taksat në shtetin tuaj ose në rezidencën tuaj tatimore

Rezidentët tatimorë të Luksemburgut u nënshtrohen përgjithësisht taksave të Luksemburgut, të tilla si ato të përmendura më lart të cilat nuk zbatohen për FCP-në. Mbajtësit e kuotave në juridiksione të tjera në përgjithësi nuk i nënshtrohen taksave të Luksemburgut (me disa përjashtime, të tilla si tatimi mbi dhuratat për aktet e dhuratave të noterizuara nga Luksemburgu). Megjithatë, një investim në një fond mund të ketë implikime tatimore në këto juridiksione.

Marrëveshjet tatimore ndërkombëtare Disa marrëveshje tatimore ndërkombëtare kërkojnë që FCP-ja të raportojë çdo vit informacione të caktuara në lidhje me mbajtësit e kuotave të fondeve pranë autoriteteve tatimore të Luksemburgut, dhe që këto autoritete t'ia përcjellin automatikisht këtë informacion shteteve të tjera, si vijon:

- **Direktiva për Bashkëpunimin Administrativ (DAC) dhe Standardi i Përbashkët i Raportimit (CRS)** Mbledhur: informacioni i llogarisë financiare, si pagesat e interesit dhe dividendëve, fitimet kapitale dhe bilancet e llogarisë. U përcillet: vendeve të origjinës të mbajtësve të kuotave që ndodhen në BE (DAC) ose në mbi 50 vendet e OECD-së dhe vende të tjera që kanë rënë dakord mbi standardet CRS.
- **Ligji amerikan për përputhshmërinë tatimore të llogarive të huaja (US Foreign Account Tax Compliance Act - FATCA)** Mbledhet: informacioni mbi zotërimin e drejtpërdrejtë dhe jo të drejtpërdrejtë të llogarive ose subjekteve joamerikane nga persona të caktuar amerikanë. I përcillet: Shërbimit Amerikan të Brendshëm të të Ardhurave (US Internal Revenue Service - IRS).

Marrëveshjet e ardhshme ose zgjerimet e marrëveshjeve ekzistuese mund të shtojnë numrin e vendeve të cilave u komunikohet informacioni i mbajtësve të kuotave. Çdo mbajtës kuotash që nuk përmbush kërkesat e FCP-së për informacion ose dokumentacion mund t'u nënshtrohet sanksioneve nga juridiksioni i vendbanimit të tij dhe mund të mbajë përgjegjësi për çdo sanksion të vendosur mbi FCP-në që i atribuohet mosdhënies së dokumentacionit nga mbajtësi i kuotave. Megjithatë, mbajtësit e kuotave duhet të jenë të vetëdijshëm se një shkelje e tillë nga ana e një mbajtësi tjetër kuotash mund të reduktojë vlerën e investimeve të të gjithë mbajtësve të tjerë të kuotave, dhe se nuk ka gjasa që FCP-ja të jetë në gjendje t'i rikuperojë shumatat e këtyre humbjeve.

Sipas FATCA, aplikohet një tatim në burim prej 30% mbi të ardhurat me origjinë amerikane që paguhen për apo në përfitim të një personi amerikan nga një burim i huaj. Sipas një marrëveshjeje tatimore midis Luksemburgut dhe SHBA-së, ky tatim në burim aplikohet për të gjitha të ardhurat me origjinë nga SHBA-ja, dividendët ose fitimet bruto nga shitjet e aktiveve që i paguhen mbajtësve të kuotave që konsiderohen si investitorë amerikanë. Mbajtësit e kuotave që nuk japin të gjithë informacionin e lidhur me FATCA ose për të cilët dyshojmë se nuk janë investitorë amerikanë mund t'i nënshtrohen këtij tatimi në burim mbi një pjesë ose të gjitha pagesat e riblerjes ose të dividendëve të kryera në lidhje me çdo fond. Në mënyrë të ngjashme, ne mund ta aplikojmë tatimin në burim mbi investimet e bëra përmes çdo ndërmjetësi për të cilin nuk jemi plotësisht të bindur se është në përputhje me FATCA.

Edhe pse shoqëria e menaxhimit mund të bëjë përpjekje në mirëbesim për të garantuar pajtueshmëri me të gjitha detyrimet e zbatueshme të legjislacionit tatimor, FCP-ja nuk mund të garantojë se ajo do të përjashtohet nga kërkesat për të paguar tatim në burim apo se ajo do të japë të gjithë informacionin e nevojshëm për mbajtësit e kuotave për të përmbushur detyrimet e tyre të raportimit tatimor.

Masat për të parandaluar sjelljet e papërshtatshme dhe të paligjshme

Pastrimi i parave, terrorizmi dhe mashtrimi

Për të qenë në përputhje me ligjet, rregulloret, qarkoret dhe akte të tjera të Luksemburgut që kanë si objekt parandalimin e krimit dhe të terrorizmit, duke përfshirë pastrimin e parave, të gjithë investitorët duhet të sigurojnë dokumentacionin që provon identitetin e tyre (qoftë përpara hapjes së një llogarie ose në një moment të mëvonshëm).

Në përgjithësi, për investitorët që investojnë përmes profesionistëve financiarë në një shtet që respekton konventat e Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF), ky dokumentacion do të konsiderohet se është dhënë nga profesionisti i tyre financiar. Në raste të tjera, ne kërkojmë zakonisht llojet e mëposhtme të dokumenteve të identifikimit:

- për personat fizikë: një kartë identiteti ose pasaportë të certifikuar nga një autoritet publik (p.sh nga një noter, oficer policie ose ambasador) në shtetin e tij apo të saj të banimit
- për korporatat dhe subjekte të tjera që investojnë në emër të tyre: një kopje të certifikuar të aktit të themelimit ose një dokument tjetër statutor, plus, për pronarët e subjektit ose përfituesit e tjerë ekonomikë, dokumentin e identifikimit të përshkruar më lart për personat fizikë
- për ndërmjetësit financiarë: një kopje të certifikuar të aktit të themelimit të subjektit ose një dokument tjetër statutor, plus vërtetimi se pronari i llogarisë ka marrë dokumentacionin e nevojshëm për të gjithë investitorët fundorë

Ne na kërkohet gjithashtu të verifikojmë legjitimitetin e transfertave të parave që na vijnë nga institucione financiare të cilat nuk u nënshtrohen standardeve të verifikimit të Luksemburgut ose standardeve të barasvlershme me to.

Për çdo investitor, ne mund të kërkojmë dokumente shtesë në çdo kohë nëse e gjejmë të nevojshme, si dhe mund të vonojmë ose të mohojmë hapjen e llogarisë suaj dhe çdo kërkesë përkatëse për transaksione (me përjashtim të

shkëmbimeve dhe riblerjeve) derisa të kemi marrë, dhe të kemi gjykuar si të përshtatshëm, të gjithë dokumentacionin e kërkuar. Ne mund gjithashtu t'u bëjmë kërkesa të ngjashme ndërmjetësve financiarë. Ne nuk do të mbajmë asnjë përgjegjësi për kostot, humbjet ose humbjet e interesave apo të mundësive për investim që rezultojnë.

Sinkronizimi i tregut dhe tregtimi i tepërt

Fondet synohen përgjithësisht si investime afatgjata dhe jo si mjete për tregtim të shpeshtë apo për sinkronizim të tregut.

Këto lloje tregtimi nuk janë të pranueshme pasi mund të cenojnë menaxhimin e fondeve dhe të ngrenë shpenzimet e fondeve në dëm të mbajtësve të kuotave. Ne nuk lejojmë në mënyrë të vetëdijshme asnjë transaksion për sinkronizimin e tregut (ndonëse nuk mund të premtojmë se do të arrijmë t'i identifikojmë apo parandalojmë të gjitha këto transaksione) dhe mund të marrim masa të ndryshme për të mbrojtur interesat e mbajtësve të kuotave, duke përfshirë monitorimin dhe refuzimin, pezullimin ose anulimin e çdo kërkesë që besojmë se përfaqëson tregtim të tepërt apo se mund të jetë e lidhur me një investitor, grup investitorësh ose model tregtimi që ka të bëjë me sinkronizimin e tregut. Gjithashtu, ne mund ta bllokujmë llogarinë tuaj për blerjet ose shkëmbimet e ardhshme (por jo për riblerjet), derisa të kemi marrë prova që i gjejmë të pranueshme se në vazhdim nuk do të ndodhë asnjë sinkronizim i tregut apo tregtim i tepërt.

Me llogaritë e mbajtura nga ndërmjetësit, gjatë vlerësimit, FCP-ja merr në konsideratë vëllimet dhe shpeshtësitë lidhur me çdo ndërmjetës, si dhe normat e tregut, tendencat historike dhe nivelet e aktiveve të ndërmjetësit. Megjithatë, FCP-ja mund të marrë çdo masë që e gjejmë të nevojshme, duke përfshirë edhe kërkesën që ndërmjetësi t'i rishikojë transaksionet e llogarisë së tij, të vendosë bllokime ose kufizime të transaksioneve ose ta ndërpresë marrëdhënien me ndërmjetësin.

Tregtimi i vonuar

Ne marrim masa për të garantuar që çdo kërkesë për të blerë, shkëmbyer ose shitur kuota e cila është marrë pas orarit të cut-off-it për një NAV të caktuar të mos përpunohet me atë NAV.

Privatësia e informacionit personal

Natyra dhe përdorimi i të dhënave personale Të dhënat personale për investitorët kërkohen për qëllime të ndryshme, të tilla si përpunimi i kërkesave, kryerja e shërbimeve të mbajtësve të kuotave, mbrojtja nga aksesi i paautorizuar i llogarisë dhe për t'i mundësuar FCP-së të pajtohet me ligje dhe rregullore të ndryshme, duke përfshirë ligjet tregtare, ligjet kundër pastrimit të parave, FATCA dhe CRS.

Të dhënat personale përfshijnë, për shembull, emrin tuaj, adresën, numrin e llogarisë bankare, sasinë dhe vlerën e kuotave të mbajtura, si dhe emrin dhe adresën e përfaqësuesit/përfaqësuesve tuaj individualë dhe pronarit përfitues (nëse ai nuk është mbajtësi i kuotave). Të dhënat personale përfshijnë të dhënat që na jepen në çdo kohë nga ju apo në emrin tuaj.

Për më tepër informacion mbi përpunimin e të dhënave personale, shihni formularin e aplikimit për hapjen e llogarisë.

Të drejtat që ne ruajmë

Brenda kufijve të ligjit dhe të rregulloreve të menaxhimit, ne ruajmë të drejtën për të kryer në çdo kohë secilin nga veprimet e mëposhtme:

- **Për të refuzuar ose anuluar çdo aplikim për të hapur një llogari ose çdo kërkesë për të nënshkruar kuota, për çfarëdolloj arsyeje.** Ne mund ta refuzojmë të gjithë shumën ose një pjesë të saj. Në rast se një kërkesë për të nënshkruar kuota refuzohet, paratë do të kthehen nën përgjegjësinë e blerësit brenda 7 ditëve pune, pa asnjë interes dhe minus të gjitha shpenzimet rastësore.

- **Modifikoni, kufizoni ose përfundoni privilegjin e shkëmbimit, në** çdo kohë, me njoftim 60 ditësh për mbajtësit e kuotave.
- **Për të deklaruar dividendë të tjerë** ose për të ndryshuar (në mënyrë të përkohshme ose të përhershme) metodën e përdorur për llogaritjen e dividendëve.
- **Për t'u kërkuar mbajtësve të kuotave të provojnë pronësinë përfituese të kuotave ose kualifikueshmërinë për t'i zotëruar këto kuota, ose për ta detyruar një mbajtës kuotash të pakualifikuar për të hequr dorë nga pronësia.** Nëse shoqëria e menaxhimit ka bindjen se kuotat janë plotësisht ose pjesërisht nën zotërimin e një investitori i cili është ose duket se ka gjasa të bëhet i pakualifikueshëm për zotërimin e këtyre kuotave, ne mund të njoftojmë mbajtësin e kuotave lidhur me qëllimin tonë për t'i riblerë kuotat. Nëse nuk marrim dokumentacion të mjaftueshëm që provon kualifikueshmërinë, ne mund t'i riblerjmë kuotat pa pëlqimin e pronarit 10 ditë pas përcjelljes së njoftimit. Gjithashtu, ne mund t'i ndalojmë investitorët të blejmë kuota nëse kemi bindjen se kjo është në interes të mbajtësve ekzistues të kuotave. Ne mund t'i marrim këto hapa për të garantuar pajtueshmërinë e FCP-së me ligjin dhe rregulloret, për të shmangur pasojat financiare negative për FCP-në (si për shembull tarifën tatimore) ose për çdo arsye tjetër. FCP-ja nuk do të mbajë përgjegjësi për asnjë fitim ose humbje që lidhet me këto riblerje.
- **Për të pezulluar përkohësisht llogaritjen e NAV-ve ose të transaksioneve me kuotat e një fondi** në rastin e një prej rrethanave të mëposhtme, dhe kur një pezullimi do të ishte në pajtim me interesat e mbajtësve të kuotave:
 - bursat ose tregjet kryesore të lidhura me një pjesë të konsiderueshme të investimeve të fondit janë të mbyllura në një kohë kur ato duhet të ishin normalisht të hapura, ose tregtimi në to është kufizuar apo pezulluar
 - ka ndodhur një shkëputje e sistemeve të komunikimit ose një situatë tjetër (që nuk është shkaktuar nga shoqëria e menaxhimit dhe nuk është nën kontrollin e saj) që e ka bërë të pamundur vlerësimin e aktiveve të fondit në mënyrë të sigurt dhe në kohën e duhur
 - ekziston një gjendje emergjence ose krize kombëtare (që nuk është shkaktuar nga shoqëria e menaxhimit dhe nuk është nën kontrollin e saj) që e bën të pamundur vlerësimin ose likuidimin e aktiveve, ose që i jep shkas të arsyeshëm pezullimit të transaksioneve me kuotat e fondit
 - fondi nuk arrin të ripërvetësojë paratë e nevojshme për të paguar fitimet nga riblerja, ose nuk arrin të likuidojë aktivet ose të shkëmbejë paratë e nevojshme për operacionet ose riblerjet me çmimin ose kursin e këmbimit që bordi e konsideron si normal
 - fondi ose FCP-ja po likuidohet ose bashkohet

Një pezullim mund të zbatohet mbi çdo kategori kuotash dhe fond, ose mbi të gjitha ato, si dhe mbi çdo lloj kërkesë (blerje, shkëmbim, shitje).

Të gjitha kërkesat përpunimi i të cilave është vonuar për shkak të një pezullimi të transaksioneve do të mbahen në pritje dhe do të ekzekutohen me NAV-në e radhës që do të llogaritet.
- **Për të zbatuar procedura të veçanta gjatë periudhave të pikut në kërkesat për blerje, shkëmbim ose shitje.** Nëse në një ditë pune një fond merr dhe pranon kërkesa për blerje, shkëmbim ose shitje, vlera neto e të cilave tejkalon 10% të aktiveve totale neto të fondit, shoqëria e menaxhimit mund ta kufizojë pagesën e riblerjeve në 10%. Në këtë rast, kërkesat për riblerje përpunohen në mënyrë përpjesëtimore. Pjesa e papërpunuar e çdo kërkesë do të mbahet në pritje (përpara kërkesave të marra dhe të pranuar në një datë të mëvonshme) dhe do të ekzekutohet me NAV-në e radhës që do të llogaritet, duke iu nënshtruar të njëjtit kufizim, përveç faktit se vonesa nuk do të jetë në asnjë rast më e gjatë se 3 ditë pune.
- **Mbyllni një fond ose kategori kuote për investime të mëtejshme,** përkohësisht ose pafundësisht, pa paralajmërim, kur shoqëria administruuese beson se është në interesin më të mirë të mbajtësve të kuotave (si p.sh. kur një fond ka arritur madhësinë ku rritja e mëtejshme duket se ka gjasa të jetë e dëmshme për performancën). Mbyllja mund të aplikohet vetëm për investitorët e rinj ose edhe për investimet e ardhshme nga mbajtësit ekzistues të kuotave.
- **Për të pranuar tituj si pagesë për kuotat, ose për t'i shlyer pagesat e riblerjes me tituj (pagesa në natyrë).** Nëse dëshironi të kërkonti një nënshkrim ose riblerje në natyrë, ju duhet të merrni miratimin paraprak të shoqërisë së menaxhimit. Përgjithësisht, ju duhet të paguani të gjitha kostot që lidhen me transaksionet në natyrë (vlerësimin e titujve, tarifën e brokerimit, raportet e kërkuara të audituesve etj.). Të gjithë titujt e pranuar si pagesë në natyrë për një nënshkrim kuotash duhet të jenë në përputhje me politikën e investimeve të fondit, dhe pranimi i këtyre titujve nuk duhet të cenojë pajtueshmërinë e fondit me ligjin e vitit 2010.

Nëse merrni miratim për një riblerje në natyrë, ne do të përpiqemi t'ju ofrojmë tituj të përzgjedhur që ngjasojnë shumë ose përputhen plotësisht me përbërjen e përgjithshme të zotërimeve të fondit në kohën e përpunimit të transaksionit.

Bordi mund të kërkojë që ju të pranoni tituj në vend të mjeteve monetare në përmbytjen e plotë apo të pjesëshme të një kërkesë riblerjeje. Nëse bini dakord me këtë, FCP-ja mund të sigurojë një raport të pavarur vlerësimi nga audituesi i saj dhe dokumente të tjera.
- **Zvogëloni ose hiqni çdo tarifë shtetje të deklaruar, ose shumë minimale investimi, për çdo fond, investitor ose kërkesë,** veçanërisht për investitorët që angazhohen të investojnë një shumë të caktuar me kalimin e kohës, për sa kohë që është në përputhje me trajtimin e barabartë e mbajtësve të kuotave. Gjithashtu, ne mund t'u lejojmë shpërndarësve të përcaktojnë kërkesa të ndryshme minimale për investime.
- **Për të reduktuar ose anuluar plotësisht ose pjesërisht tarifën që merr shoqëria e menaxhimit** me qëllim reduktimin e ndikimit mbi performancën. Këto anulime mund të aplikohen për çdo fond ose kategori fondesh, për çdo periudhë kohe dhe në çdo shkallë, sipas përcaktimit nga shoqëria e menaxhimit.
- **Për të llogaritur një NAV të re dhe për t'i ripërpunuar transaksionet me atë NAV.** Nëse ka ndodhur një ndryshim thelbësor në çmimet e tregut që ndikojnë në një pjesë e konsiderueshme e investimeve të fondit, ne kemi mundësinë që, për qëllime të mbrojtjes së interesave të mbajtësve të kuotave dhe të FCP-së, të anulojmë vlerësimin e parë dhe të llogarisim një të dytë, i cili do të aplikohet më pas për të gjitha transaksionet me kuotat e fondit për atë ditë. Të gjitha transaksionet që ishin përpunuar më parë me NAV-në e vjetër do të ripërpunohen me NAV-në e re.

Njoftimet dhe publikimet

Tabela në vijim tregon materialet përkatëse (në versionin e tyre më të fundit), të cilat vihen në dispozicion përmes kanaleve përkatëse. Zërat në 6 rreshtat e parë, zakonisht, vihen në dispozicion përmes konsulentëve financiarë.

Informacioni/dokumenti	Dërguar	Media	Online	Në seli
KIID-të, broshura, raportet financiare			●	●
Njoftimet për mbajtësit e kuotave mbi ndryshimet thelbësore	●		●	●
Njoftimet për mbajtësit e kuotave mbi likuidimin e FCP-së	●	●	●	●
Njoftime të tjera për mbajtësit e kuotave			●	●
NAV-të (çmimet e kuotave), si dhe fillimi dhe përfundimi i pezullimit të përpunimit të transaksioneve të kuotave			●	●
Njoftimet mbi dividendin			●	●
Deklaratat/konfirmimet	●			
Rregulloret e menaxhimit			●	●
Marrëveshjet bazë (marrëveshjet me menaxherin e investimeve, depozitarin, administratorin dhe me ofrues të tjerë kryesorë të shërbimeve)				●
Informacioni mbi votimin e mëparshëm të aksioneve të portofolit, stimujt (financiarë dhe jofinanciarë) të disponueshëm për shoqërinë e menaxhimit, lista e të emëruarve/ agjentëve aktualë shpërndarës, si dhe një përshkrim i detyrave aktuale të depozitarit dhe konflikteve përkatëse të interesit				●
Politikat bazë (konfliktet e interesit, ekzekutimi më i mirë, shpërblimi, votimi, trajtimi i ankesave, indekset referencë etj.), si dhe një listë e nënkujdestarëve aktualë			●	●

SHPJEGIMI

Dërguar Dërguar tek të gjithë mbajtësit e kuotave të regjistruar drejtpërdrejt në listën e mbajtësve të kuotave të FCP-së, në adresën e regjistruar (kopje fizike, elektronike ose një lidhje e dërguar me email).

Media Publikuar, sipas kërkesave të ligjit ose sipas përcaktimeve të bordit, në gazeta ose në media të tjera në Luksemburg dhe në vende të tjera ku janë të disponueshme kuotat, ose në platforma elektronike, si p.sh. Bloomberg, ku publikohen NAV-të ditore, si dhe në "Recueil Electronique des Sociétés et Associations" (Përmbledhja elektronike e shoqërive dhe shoqatave).

Online Postuar online në eurizoncapital.com.

Në seli Vihen në dispozicion falas, pas marrjes së një kërkesë nga selitë e regjistruara të shoqërisë së menaxhimit, si dhe vihen në dispozicion për inspektim në këto seli. Shumë artikuj vihen gjithashtu në dispozicion pas marrjes së një kërkesë nga administratori, depozitari dhe shpërndarësit vendorë. Rregulloret e menaxhimit vihen gjithashtu në dispozicion falas, pas marrjes së një kërkesë nga zyrat e Regjistrimit Tregtar të Luksemburgut dhe për t'u inspektuar në zyrat e tyre.

Njoftimet për mbajtësit e kuotave përfshijnë njoftime mbi ndryshimet e prospektit, bashkimet ose mbylljet e fondeve ose të kategorive të kuotave (së bashku me arsyetimin për vendimin), fillimin dhe përfundimin e pezullimeve të përpunimit të kuotave, si dhe mbi të gjitha dokumentet e tjera për të cilat nevojitet një njoftim.

Deklaratat dhe konfirmimet dërgohen në rastet kur ka transaksione në llogarinë tuaj. Dokumentet e tjera dërgohen pas publikimit të tyre.

Raportet vjetore të audituara publikohen brenda katër muajve nga përfundimi i vitit financiar. Raportet gjashtëmujore të paaudituar publikohen brenda dy muajve nga përfundimi i periudhës që mbulojnë.

Informacioni mbi performancën në të shkuarën, sipas kategorisë së kuotave dhe të fondit, shfaqet në KID-in e zbatueshëm dhe në eurizoncapital.com.

Menaxhimi dhe operacionet e biznesit

FCP-ja

Emri dhe selia e regjistruar

Eurizon Manager Selection Fund
28, Bd. de Kockelscheuer
L-1821, Luksemburg

Struktura ligjore Skemë investimi pa afat e organizuar në formën e një fonds commun de placement (FCP)

Juridiksioni ligjor Luksemburg

Themeluar në 6 prill 2006 (si Sanpaolo Manager Selection Fund)

Kohëzgjatja E pacaktuar

Rregulloret e menaxhimit Botuar për herë të parë në Mémorial, Recueil Spécial des Sociétés et Associations më 18 prill 2006; amendamentet e fundit të publikuara në Recueil Electronique des Sociétés et Associations më 1 korrik 2022

Autoriteti rregullator

Commission de Surveillance du Secteur Financier
283, route d'Arlon, L-1150 Luxembourg

numri i regjistrimit RCS K690

Viti financiar 1 janar deri më 31 dhjetor.

Kapitali Shuma e aktiveve neto të të gjitha fondeve

Kapitali minimal (sipas legjislacionit të Luksemburgut)

1.250.000 euro ose shuma e barasvlershme në një monedhë tjetër (duhet të arrihet brenda 6 muajve pas datës së autorizimit)

Vlera nominale e kuotave Nuk ka

Monedha e kapitalit të kuotave dhe e raportimit Euro

Kualifikimi si SIKTT FCP-ja kualifikohet si Sipërmarrje për Investime Kolektive në Tituj të Transferueshëm (SIKTT) sipas Pjesës 1 të Ligjit të vitit 2010.

Pavarësia financiare e fondeve FCP-ja funksionon si një "fond ombrellë" për krijimin dhe operimin e fondeve. Aktivët dhe pasivët e çdo fondi janë të veçuara nga ato të fondeve të tjera; nuk ka përgjegjësi të ndërsjellë dhe kreditori i një fondi nuk ka të drejta mbi aktivët e një fondi tjetër.

Bashkëmenaxhimi i aktiveve Për të minimizuar kostot, fondet mund të përziejnë aktive të caktuara me ato të fondeve të tjera dhe t'i menaxhojnë ato si një grup i vetëm. Në këtë rast, aktivët e çdo fondi do të mbeten të veçuara për sa i përket kontabilitetit dhe pronësisë, dhe alokimi i të ardhurave, fitimeve kapitale dhe kostove bëhet për çdo fond në mënyrë proporcionale. Të drejtat dhe detyrimet e mbajtësve të kuotave do të mbeten të pandryshuara dhe nuk parashikohet asnjë ndikim tatimor thelbësor.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve Mosmarrëveshjet që lindin midis mbajtësve të kuotave, shoqërisë së menaxhimit dhe depozitarit do të zgjidhen në përputhje me legjislacionin e Luksemburgut dhe do t'i nënshtrohen juridiksionit të Gjykatës së Rrethit të Luksemburgut. Megjithatë, në rastin e mosmarrëveshjeve që përfshijnë investitorë të cilët janë banorë të shteteve të tjera, ose transaksione me kuota që kryhen në vende të tjera, shoqëria e menaxhimit ose depozitari mund të vendosë që ai/ajo vetë dhe FCP-ja t'i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave ose legjislacionit të këtyre vendeve.

Aftësia e një mbajtësi të kuotave për të paraqitur një pretendim ndaj FCP-së skadon 5 vite pas ngjarjes mbi të cilën bazohet pretendimi (30 vite në rastin e pretendimeve që kanë të bëjnë me të drejtën për të përfituar të ardhurat nga një likuidim).

Shoqëria e menaxhimit

Shoqëria e menaxhimit dhe promovuesi

Eurizon Capital S.A.
28, Bd. de Kockelscheuer
L-1821 Luxembourg

Faqja e internetit eurizoncapital.com

Struktura ligjore Société anonyme

Juridiksioni ligjor Luksemburg

Data e themelimit 27 korrik 1988 (si Sanpaolo Gestion Internationale S.A.)

Autoriteti rregullator

Commission de Surveillance du Secteur Financier
283, route d'Arlon, L-1150 Luxembourg

Numri i regjistrimit RCS B 28536

Autorizimet Menaxhimi diskrecional i instrumenteve financiare dhe fondeve të investimeve sipas ligjit të vitit 2010; menaxher i fondit të investimeve alternative sipas ligjit të Luksemburgut të 12 korrikut 2013

Kapitali 7,974,600 euro (shlyer plotësisht)

Fonde të tjera të menaxhuara Shihni eurizoncapital.com

Bordi Drejtues

Daniel Gros Kryetar

Drejtor i Pavarur, Belgjikë

Saverio Perissinotto Zëvendës Kryetar

CEO dhe Drejtor i Përgjithshëm, Eurizon Capital SGR S.p.A., Itali

Marco Bus Administrator

Zyrtar Drejtues, Eurizon Capital S.A., Luksemburg

Jérôme Debortolis

